



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“MINISTRINË E DREJTËSISË”

RAPORT PËRFUNDIMTAR
“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E
MINISTRISË SË DREJTËSISË”

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1 Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.....	3
I.2 KONKLuzion I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	8
II. HYRJE	10
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	10
2. Identifikimi i çështjes:	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: 11	11
4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:	11
5. Kriteret e vlerësimit:	12
6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	13
7. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	13
III.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14
III.2 Përshkrim i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14
1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT	14
2. MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE.....	38
3. MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE MBI ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE	43
4. MBI AUDITIMIN E LLOGARIVE VJETORE.....	48
5. MBI PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE.....	94
6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT DHE AUDITIT TË BRENDSHËM	117
7. PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT.....	130
III. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	134
A. MASA ORGANIZATIVE.....	134
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.....	141
IV. ANEKSE	143



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Gjetje	Referenca	Rëndësia	Rekomandimi
Nga auditimi rezulton se në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të MD janë listuar në mënyrë të përgjithshme detyrat e Drejtuesve dhe specialistëve dhe më tej vetëm përshkrimet e Drejtorive, por pa detajime të përshkrimeve konkrete të punës të përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve, sipas drejtorive ku bëjnë pjesë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e DAP, nr. 01, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”; Nenin 9 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar.	Pika III.2.2	E mesme	Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marra masa për ngritjen e grupit të punës përkatës për përmirësimin e Rregullosës së Brendshme të funksionimit, duke e plotësuar atë me rregulla dhe përshkrime të hollësishme mbi detyrat, përgjegjësitë dhe rolet në administrimin e veprimtarisë së përditshme për përgjegjësit e sektorëve dhe specialistëve.
Nga auditimi mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar konstatohet se, referuar llogarisë përkatëse në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime nga buxheti i aparatit për vendime gjyqësore, në një vlerë prej 45,613,569 lekë të cilat përfshijnë paga, kontribute dhe tarifa përmbarimi dhe konkretisht për vitin 2020, në total 22,982,329 lekë nga të cilat 971,665 janë tarifa përmbarimi; për vitin 2021 në total 1,869,390 lekë nga të cilat 52,446 lekë tarifa përmbarimi dhe për vitin 2022, në total 20,761,850 lekë nga të cilat 78,000 lekë tarifa përmbarimi. Nga auditimi rezulton se deri në vitin 2019, sektori i financës ka operuar me pagesat ndaj gjyq fituesve vetëm në pagën neto, duke mos derdhur kontribute për sigurime për gjyq fituesit pothuajse që në vitin 2011. Pas konstatimit të këtij fakti, sektori i financës ka kryer përlllogaritjen dhe ka filluar kryerjen e pagesave për kontributet e pa shlyera ndaj këtyre gjyq fituesve, ku pjesa më e madhe e pagesave janë kryer në vitin 2020 dhe konkretisht rreth 3,731,037 lekë. Për sa më lart, krahas pagesave të 11 gjyq fituesve për periudhën objekt auditimi, mos kryerja e pagesave të plota në vlerën bruto për periudhat e mëparshme, ka bërë që kosto e këtyre pagesave të rëndojë buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën objekt auditimi.	Pika III.2.2	E lartë	Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse disiplinore të marrin masa që në të ardhmen vendimet për shkarkimet nga puna të jenë të argumentuara saktë, në mënyrë të dokumentuar dhe të justifikuar, si dhe të garantohet ndjekia e të gjitha hapave të nevojshme të njoftimit apo vlerësimit të arësyes së largimit, në mënyrë që të shmangen efektet financiare negative në buxhet. Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse, të marrin masa për vlerësimin dhe sistemimin e gjyqëfituesve në listë pritje, në pozicionet vakante të cilat MD i ka në një nivel të lartë aktualisht, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, duke qenë se kjo mundësi parashikohet nga aktet ligjore përkatëse mbi shërbimin civil.
Për periudhën objekt auditimi, një peshë të konsiderueshme në zërin “Shpenzime operative”	Pika III.2.3	E mesme	Sektori përgjegjës për përkthimet zyrtare të marrë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>e zë “Shërbimi i përkthimeve zyrtare”, për të cilin rezulton se MD ka shpenzuar në total për të tre vitet vlerën prej 104,267,661 lekë dhe përkatësisht 43% të shpenzimeve operative të vitit 2020, 21% të shpenzimeve të vitit 2021 dhe 46% të shpenzimeve të vitit 2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura për marrjen në dorëzim të përkthimeve të kryera, vihet re se në të gjitha rastet, MD shprehet se materialet i jepen përkthyesve zyrtarë të jashtëm për shkak të pamundësisë aktuale të realizimit të përkthimit nga Sektori i Përkthimit Zyrtar, ose për shkak të materialit voluminoz në fjalë. Nga auditimi rezulton se ky arsytim përdoret edhe në rastet e përkthimit të materialeve me përmbajtje nga 1 deri në 3 faqe, për të cilat jepet një afat kohor deri në 7 ditë, periudhë e cila është e mjaftueshme për tu përballuar nga Sektori i Përkthimit Zyrtar në MD, sektor i cili përbëhet nga 1 përgjegjës dhe 5 specialistë. Gjithashtu konstatohet se brenda një viti nuk bëhet një shpërndarje e drejtë mes përkthyesve zyrtarë të autorizuar. Nga sa më lart, rezulton se për shërbimin e përkthimeve, MD nuk operon sipas një rregulloreje apo udhëzimi të brendshëm të miratuar, sipas të cilit të bëhen transparente mënyra e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve, mënyra e dokumentimit të ngarkesave në punë të sektorit të përkthimeve pranë MD, për shkak të të cilës ky sektor e ka të pamundur të realizojë qoftë edhe përkthimet prej 1 apo 2 faqesh, etj. Me Urdhër nr. 162, datë 09.06.2020 të Ministrit të MD, është miratuar lista e përkthyesve të autorizuar për përkthimin zyrtar për vitin 2020 dhe me Urdhër nr. 421, datë 15.12.2020 është miratuar kjo listë për vitin 2021. Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 nuk është miratuar kjo listë, duke bërë që të vijohet automatikisht me përkthyesit e vitit të mëparshëm. Veprimet e mësipërme bien ndesh me Udhëzimin nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar.</p>			<p>masa për plotësimin e mëtejshëm të Udhëzimit nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, ose për hartimin e një rregullore të funksionimit të këtij shërbimi, duke pasqyruar qartë dhe në mënyrë transparente mënyrën e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve., si dhe të vijojë me miratimin e listës së përkthyesve zyrtar deri në momentin e vënies në funksion të plotë të regjistrit kombëtar të përkthyesve.</p> <p>Duke marrë shkak nga volumi tepër i lartë i përkthimeve zyrtare në MD, si dhe vlera tepër e lartë e fondeve që zë në buxhet ky shërbim, sektori përkatës për përkthimet zyrtare dhe titullari i MD të marrin masa për studimin dhe analizimin nga pikëpamja financiare, të mundësisë së shtimit sipas nevojës të numrit të punonjësve në strukturën e sektorit të përkthimeve, në mënyrë që të shmangen sa më tepër të jetë e mundur shpenzimet e larta për këtë shërbim, por edhe risqet e shpërndarjes së materialeve konfidenciale jashtë institucionit.</p>
<p>a) Nga auditimi rezultoi se regjistrimi i zërave të aktiveve në Ministrinë së Drejtësisë është kryer me çmimin e blerjes, dhe periudha e hyrjes së tyre i përket viteve shumë më parë. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për</p>	<p>Pika III.2.4</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga ana e institucionit të merren masa për kryerjen e procesit të rivlersimit të aseteve, me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>kryerjen e rivlersimit të aseteve me qëllim sjelljen e tyre në vlerën e drejtë në kontabilitet.</p> <p>b) Nga auditimi rezultoi se MD disponon certifikatë pronësie vetëm për Godinën e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa për godinën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe godinën e Kolegji të Posaçëm të Apelit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të MD-së në zbatim të VKM, nr. 518, datë 20.9.2017 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Ligji nr. 84/2016”, i ndryshuar me VKM-në nr. 767, datë 20.12.2017 dhe VKM-në nr. 230, datë 26.04.2018, kanë filluar procedurat për hartimin e planit të rilevimit dhe planimetrive të zyrave, por aktualisht nuk disponohet certifikata e pronësisë.</p> <p>c) Nga auditimi rezultoi se për periudhën e auditimit MD në llogaritjen e amortizimit për kategorinë e aktiveve “Inventar ekonomik” ka operuar me metodën e amortizimit mbi vlerën e mbetur, në kundërshtim me paragrafin nr. 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.</p>			<p>vlerën aktuale të tregut për aktivin.</p> <p>Nga ana e institucionit, të merren masa për përmbjlljen e procedurave dhe paisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e rregjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, me qëllim formalizimin e marrdhënies së MD dhe objekteve në pronësi dhe rrjedhimisht pasqyrimin e vlerave përkatëse të trojeve në funksion tyre në llogarinë 210.</p> <p>Nga ana e institucionit, për kategoritë e aktiveve a) kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave për aktivet e kategorisë, të procedohet me përlllogaritjen e amortizimit në mënyrë individuale sipas sipas paragrafit nr. 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.</p>
<p>Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin “Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë” zhvilluar më datë 16.12.2020, nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë me ofertë më të mirë bazuar në Çmim dhe Propozim teknik. Kriteret e Vlerësimit teknik me vlerësim me Pikë (i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10], (ii) Metodologjia e Propozuar [20-30], (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-60]. Ndërkohë, sipas kriterëve kualifikuese të veçanta të Kapacitetit teknik, kërkohet që Operatori ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht stafin kryesor: Drejtues Projekti me Eksperiencë Pune <i>mbi 15 vite</i>. Drejtuesi i</p>	Pika III.2.5	E lartë	<p>Ministria e Drejtësisë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vlerësimit duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>Projektit pranohet të jetë edhe njeri nga, Projektues Arkitekt ose Projektues Konstruktor. Projektues Arkitekt (2 persona), ekspertë me përvojë pune <i>mbi 10 vite</i>. Projektues Konstruktor (1 person), ekspert me përvojë pune <i>mbi 10 vite</i>. Projektues Mekanik (1 person), ekspert me përvojë pune <i>mbi 10 vite</i>. Projektues Elektrik (2 persona), ekspertë me përvojë pune <i>mbi 10 vite</i>. Projektues Gjeodet (1 person), ekspert me përvojë pune <i>mbi 10 vite</i>. Inxhinier Gjeolog (1 person), ekspert me përvojë pune <i>mbi 5 vite</i>. Inxhinier Hidroteknik (1 person), ekspert me përvojë pune <i>mbi 5 vite</i>. Kërkesa e mësipërme referuar Vendimeve të KPP-së dhe nenit 46, pika 3 të LPP, <i>kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, ku gjykohet qartë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve.</i> Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të Arkitektëve dhe Inxhinierëve, trajton në mënyrë të pabarabartë ose diskriminues Akritektët dhe Inxhinierët që nuk kanë eksperiencë mbi 10 vite. Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë. Gjithashtu referuar edhe vlerësimit me pikë mbi eksperiencat e stafit, punët e ngjashme etj, kërkesa e mësipërme nuk stimulon dhe nxit pjesëmarrjen e OE.</p>			
<p>Nga verifikimi i strukturës së preventivit, pagesës në situacionin përfundimtar, librezave të masace dhe verifikimit në terren u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon: I. Me kërkesën për propozim të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit Pa Prot., datë 07.12.2020, paraqitet</p>	Pika III.2.5	E lartë	Ministria e Drejtësisë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>analizë teknike e zërit të paparashikuar në preventiv me nr. Analize 2.334 “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”. Çmimi i këtij zëri është paraqitur sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Me procesverbalin e negocimit të zërit të ri datë 10.12.2020, mbas konsultimeve të realizuara nga palët u miratua çmimi prej 645 lekë /m² për zërin “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”. Me procesverbalin e palëve të datës 14.12.2020, gjatë verifikimeve në objekt u pa e nevojshme kryerja e disa ndryshimeve të volumeve të zërave të punimeve të paparashikuara në preventivin fillestar. Referuar situacionit përfundimtar në kapitullin e suvatime dhe veshje, konstatohet se fasada e jashtme prej 1,091 m², ka kryer 2 procese pune: a. “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”, me çmim 645 lekë /m², b. “Suvatim me grafiato h > 4m”, me çmim 750 lekë /m². Nga verifikimi i fasadës konstatohet se është realizuar vetëm zëri i “Suvatim me grafiato”, ku lartësia në fakt është mbi 8m. Nga verifikimi në disa pjesë të objektit, konstatohet se është realizuar vetëm mbushja me kollë, rrjeta dhe grafiato e gatshme. Pra nuk u konstatuan procese të suvatimit të jashtëm si kryerja e fashaturave, mbushja dhe realizimi me rerë të larë (ose Fino). Referuar situacionit përfundimtar dhe analizës së çmimit për suvatimin e jashtëm mbi 8 m, në kapitullin e punimeve të skelerisë dhe kallëpi, konstatohet se zëri nr. 2 me nr. Analize 2.431 “Skelë metalike me tubo fasade >12 m” në sasinë prej 1,608 m², me çmimin përkatës prej 90 lekë/m² është zë pune i mbivendosur zërit nr. 2.334 “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”, pasi përfshihet në strukturën e çmimit. Rrjedhimet vlera prej <u>144,720 lekë</u>, e likuiduar në zërin “Skelë metalike me tubo fasade >12 m”, është përfitur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>2. Në kapitullin e punime shtresash, zëri nr. 9, me nr. Analize 2.276 “Shtresë parketi”. Sasia për "shtresë parketi" është paguar në situacion në sasinë 29.8 m², me çmimin prej 6,550 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 29.8 m², në ambientet e katit dytë zyra 8 dhe zyra 9. Nga verifikimi në këto ambinete konstatohet se këto sipërfaqe nuk janë realizuar me shtresë parketi por me shtresë parketi <u>laminat</u>, me çmimin</p>		arkëtimin e vlerës prej 848,388 lekë nga kontraktori OE “I.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.
--	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>përkatës prej 1,650 lekë/m². Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar diferencë cmimi prej 4,900 lekë/ m² (6,550 lekë/m² - 1,650 lekë/m²). Vlera e diferencës e përfituar më tepër rezulton 4,900 lekë/m² x sasinë 29.8 m² = <u>146,020 lekë</u>.</p> <p>3. Kapitulli i punimeve tavani, suvatimi dhe veshje, zëri nr. 1, me nr. Analize 2.3 “Suva solete h-4 m me drejtues, me krah”. Sasia për "Suvatimit të tavanit" është paguar në situacion në sasinë 645 m², me cmimin prej 650 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 645 m², në nga ambientet e katit I deri të katit XI. Nga verifikimi në disa ambinete të MD zyra dhe shesh pushime, konstatohet se nuk janë realizuar suvatime të tavanit, por vetëm tavane të varur me pllaka gipsi 60x60 dhe tavane karton xhes. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin e punimit “Suva solete h-4 m me drejtues, me krah” në vlerën <u>416,250 lekë</u>.</p> <p>Si përfundim, për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 706,990 lekë pa TVSH (416,250 + 146,020 + 144,720) ose 848,388 lekë me TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi “I.” shpk, për zëra të parealizuar.</p>			
--	--	--	--

I.2 KONKLUZION I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të Ministrisë së Drejtësisë (i pakualifikuar)¹

Në audituam pasqyrat financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për periudhën 2020-2022 të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar; Pasqyra e performancës financiare; Pasqyra e flukseve monetare; Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto; Pyetësori dhe shënime shpjeguese dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e financimit, Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivitet e Afatgjata (Kosto Historike); Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlerë Neto); si dhe Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar sipas pasqyrave të datës 31.12.2022 dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi (me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; si dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII, pika 7.4.1: “Opinionin i pakualifikuar : Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.”.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Nga auditimi mbi pasqyrat financiare, sa i takon raportimit financiar të subjektit Ministria e Drejtësisë, bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur u evidentuan në përgjithësi zbatimi i kuadrit të raportimit financiar në fuqi dhe nuk ka raste mospërputhesh materiale për të raportuar. Audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar** mbi pasqyrat financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar” dhe ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, si dhe në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH.

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30- “Kodi i Etikës”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar**.

Opinion mbi përputhshmërinë: (I pa kualifikuar)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave, veprimeve me bankën, etj.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, në tërësi ka rezultuar se aktiviteti i Ministrisë së Drejtësisë, është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregulloret e zbatueshme në fushat e prokurimit publik, nëpunësit civil, menaxhimit financiar e kontrollit, etj. Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar** mbi përputhshmërinë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë²

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje

² Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3: “Opinion i pa modifikuar/ i pa kualifikuar : Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme.”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Perputhshmerisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P-10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit ***i pa kualifikuar***, me përjashtim të një rasti sa i takon zbatimin të kontratës për prokurimin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së MD”, ku kanë rezultuar pagesa për punime të pa kryera në vlerën 848,388 lekë, por që nuk është rast i përhapur.

II. HYRJE

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu detyrat sipas fushës së përgjegjësisë si dhe sistemin e kontrollit të brendshëm të institucionit.

Objektivat e auditimit synojnë:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord.
- Aspektet e *rregullshmërisë* (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe *ligjshmërisë* (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik).
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.
- Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë e tij, institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, dhe mbi këtë bazë, dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet përmbledhja ekzekutive, hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset e raportit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit 249/1 Prot., datë 05.04.2023, i ndryshuar.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MD, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

5. Kriteret e vlerësimit:

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iujemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Standardet e auditimit:**
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
 - Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
 - Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;
 - Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH^{së};
- Ligje:**
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
 - Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
 - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
 - Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
 - Ligj nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil";
- VKM:**
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
 - VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit";
 - VKM dhe Aktet Normative mbi funksionimin dhe organizimin e institucionit.
- Udhëzime:**
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Rregullore:**
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 58, datë 08.04.2022;
 - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar;
 - Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

7. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;
- c. *Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

III.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit Shqipëtar në tërësi. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 249/1 Prot., datë 05.04.2023, i ndryshuar, në institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, nga data 05.04.2023 – 23.06.2023, kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022 Në fokusin e angazhimit janë kryerja nga ana e këtij institucioni e veprimtarive në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në fushën e prokurimit të fondeve publike, zbatimit të kontratave të prokuruar, respektimin e kuadrit ligjor e rregullator në marrëdhënie me nëpunësit civil, respektimin e kuadrit ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj, etj.

III.2 Përshkrim i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

Auditimi u krye për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2022, duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
- Ligji nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar;
- Ligji nr. 115 datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022” i ndryshuar
- Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Udhëzimi nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”;
- VKM nr. 577 datë 22.07.2020 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021–2023”;
- Udhëzimit nr.8, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024"
- VKM nr.190, datë 03.03.2021 "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024"
- Udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025"
- VKM nr.190, datë 03.03.2021 "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024"
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullativë.

Viti 2020

Përgatitja e PBA 2021-2023

Ministria e Drejtësisë në vitin 2020, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për nëntë programe e konkretisht:

1. *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi*
2. *Ndihma Juridike*
3. *Publikimet Zyrtare*
4. *Mjekësia Ligjore*
5. *Sistemi i Burgjeve*
6. *Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor*
7. *Shërbimet për çështjet e birësimeve*
8. *Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave*
9. *Shërbimi i Provës*

Me aktin normativ nr. 17, datë 22.04.2020 “Për Përrjashtimin e Zbatimit të Procedurave dhe Të Afateve për Përgatitjen e Projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm për Vitin 2020” është vendosur që për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk zbatohen. Me shkresën nr 13077/1 prot, datë MFE ka përcjell Udhëzimin e Ministrit nr. 28, dt. 10.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023" si dhe tavanet buxhetore.

Me urdhër të Titullarit të MD nr.266, dt. 30.07.2020, “Mbi ngritjen e komisioneve për hartimin e kërkesave për PBA 2021 – 2023”, është ngritur grupi i punës (GMS) për përgatitjen e PBA 2021 – 2023. Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023”, Ministria e Drejtësisë ka dërguar me shkresën nr. 5337/1 prot., datë 01.09.2020, në MFE kërkesat buxhetore të fazës së dytë për PBA-në 2021 – 2023, formularët e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

propozimit të projekteve të investimeve, kërkesat shtesë të programeve si dhe relacionin mbi hartimin e projekt buxhetit për Institucionet e MD, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1

Në '000 Lekë

	PROGRAMI	PBA	PBA	PBA
		2021	2022	2023
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	651,800	669,600	692,800
2	Ndihma Juridike	82,000	82,500	83,000
3	Publikimet Zyrtare	66,000	56,500	70,500
4	Mjekesia Ligjore	81,000	82,600	82,600
5	Sistemi i Burgjeve	5,770,900	5,990,900	5,887,000
6	Sherbimi i Permbarimit gjyqësor	174,000	167,000	178,000
7	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	15,200	15,200	15,200
8	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	4,275,000	4,275,000	4,310,000
9	Sherbimi i Proves	157,800	157,800	161,300
	Totali	11,273,700	11,497,100	11,480,400
Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik				
1	Pagat	4,118,618	4,118,618	4,122,118
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	708,192	708,182	708,182
3	Mallrat dhe shërbimet	1,685,240	1,823,840	2,000,340
4	Subvencionet			
5	Transferta të brendshme	4,008,000	4,008,000	4,008,000
6	Transferta të jashtme	36,400	36,400	36,400
7	Transferta per familje dhe individe	63,360	63,360	63,360
8	Aktivet e patrupëzuara	112,000	110,000	110,000
9	Aktivet e trupëzuara	541,900	628,700	432,000
	Totali	11,273,710	11,497,100	11,480,400

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti 2020

b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

- Sipas programeve buxhetore, me Ligji nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar; aparatit të Ministrisë dhe nëpërmjet saj institucioneve të varësisë i janë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale 10,846,390 mijë lekë.

Këto fonde janë shpërndarë sipas nëntë programeve buxhetore, referuar ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2

Në '000 Lekë

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
14	Ministria e Drejtësisë	10,082,216	539,174	225,000	764,174	10,846,390



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	430,000	150,300	225,000	375,300	805,300
03310	Ndihma Juridike	76,000	0	0	0	76,000
01120	Publikimet Zyrtare	54,400	5,000	0	5,000	59,400
01130	Mjekesia Ligjore	77,000	10,000	0	10,000	87,000
03440	Sistemi i Burgjeve	5,362,916	370,374	0	370,374	5,733,290
03350	Sherbimi i Permbarimit gjyqësor	154,100	0	0	0	154,100
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	14,500	2,000	0	2,000	16,500
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	3,762,000	1,000	0	1,000	3,763,000
03490	Sherbimi i Proves	151,300	500	0	500	151,800

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2020

- Me shkresën nr.2864/1, datë 14.02.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është miratuar shtesa e fondit të veçantë prej 10,000 mijë lekë.
- Në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 20.03.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, shpenzimet personeli janë pakësuar 42,000 mijë lekë dhe janë shtuar 2,000 mijë lekë shpenzime operative,
- Me Aktin Normativ nr.15 datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar, janë pakësuar shpenzimet personeli me 50,371 mijë lekë, shpenzime operative 6,404 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale me 100,000 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, janë pakësuar shpenzimet personeli me 19,000 mijë lekë, shpenzime operative 16,200 mijë lekë dhe 500,000 mijë lekë nga fondi i kompensimit të ish-pronarëve.
- Me shkresën nr.16900/1, datë 19.10.2020 është shtuar fondi prej 151 mijë lekë për pagesën pas ndërprerjes së funksionit për ish Zëvendësministren.
- Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.926, datë 25.11.2020 janë pakësuar 20,000 mijë lekë shpenzimet e personelit për Programin Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.
- Me Aktin Normativ nr.34, datë 16.12.2020 janë pakësuar 44,162 mijë lekë shpenzime personeli, 60,706 mijë lekë shpenzime operative dhe 1,100,000 mijë lekë nga fondi i kompensimit të ish pronarëve.

Buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2020 për Ministrinë e Drejtësisë, është 8,899,689 mijë lekë. Me ndryshimet buxhetore, situata e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3

Në ‘000 Lekë

	PROGRAMET	Buxheti fillestar 2020	Ndryshimet AN/nr 6,15,13,28,34, Vkm nr.926	Buxheti i rishikuar 2020
	a	b	c	d
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	805,300	-160,883	644,417
2	Ndihma Juridike	76,000	-30,500	45,500
3	Qendra e Botimeve Zyrtare	59,400	-11,035	48,365
4	Instituti I Mjekesise ligjore	87,000	-3,910	83,090
5	Sistemi I Burgjeve	5,733,290	-43,500	5,689,790



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

6	Drejtoria e Përgjithshme e Permbartimit	154,100	-24,500	129,600
7	Sherbimi për Cështjet e Biresimeve	16,500	-5,430	11,070
8	Agjensia e Trajtimit të Pronave	3,763,000	-1,656,604	2,106,396
9	Drejtoria e Përgjithshme e Proves	151,800	-10,330	141,470
	Totali	10,846,390	-1,946,692	8,899,698

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Realizimi buxhetor 2020

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar mbi realizimet buxhetore për vitin 2020 sipas ligjit të buxhetit nr. 88/2019 në tabelën e mëposhtme paraqitet niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2020:

Tabela nr. 4

Në '000 Lekë

	PROGRAMET	Buxheti i rishikuar 2020	Realizimi FAKT	%
	a	b	c	d
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	644,417	596,549	93%
2	Ndihma Juridike	45,500	17,140	38%
3	Qendra e Botimeve Zyrtare	48,365	46,828	97%
4	Instituti I Mjekesise ligjore	83,090	81,739	98%
5	Sistemi I Burgjeve	5,689,790	5,452,148	96%
6	Drejtoria e Përgjithshme e Permbartimit	129,600	127,100	98%
7	Sherbimi për Cështjet e Biresimeve	11,070	10,112	91%
8	Agjensia e Trajtimit të Pronave	2,106,396	2,084,198	99%
9	Drejtoria e Përgjithshme e Proves	141,470	134,684	95%
	Totali	8,899,698	8,550,498	96%

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nuk ka në asnjë program tejkalim të realizimit të fondeve të programuara. Në total realizimi vjetor është 96 % e fondeve të alokuara.

Me realizim të ulët paraqitet programi “Ndihma Juridike” në masën 38 %, ose sipas zërave kryesorë:

- Shpenzime personeli 55 %
- Shpenzime operative 22 %

21	602.2007	Sherbimet bankare	40,000	39,150	98%
22	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes			
23	6022009	Sherbime te pastrim gjelberimit			
24	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve			
25	602.2099	Sherbime te tjera	53,055,454	52,676,147	99%
	602.3	Shpenzime transporti			
26	602.3100	Karburant dhe vaj dhe karburant per ngrohje	2,506,494	2,506,494	100%
27	602.3200	Pjese kembimi, goma dhe bateri			
28	602.3300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	212,729	212,729	100%
29	602.3900	Shpenzime te tjera transporti, larje makinash	331,391	331,391	100%
	602.400	Shpenzime udhetimi			
30	602.410	Udhetim i brendshem	2,478,780	2,478,780	100%
31	602.420	Udhetim jashte shtetit	7,199,024	7,199,024	100%
	602.5000	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme			
32	602.5000	Shpenzime per mirembajtjen e tokave			
33	602.5200	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore			
34	602.5300	mirembajtje ndretese			
35	602.5400	Shpenzime per mirembajtjen e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj.	72,000	72,000	100%
36	602.5500	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave te punes	1,242,000	1,242,000	100%
37	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	1,801,578	1,801,578	100%
38	602.5800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te sitemeve IT	3,308,800	3,308,800	100%
	602.6	Shpenzime per qeramarrje			
39	602.6100	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	385,060		0%
	602.6400	Marrje me qira automjete per aktivite ne perputhje me fushen e veprimtarise se MD			
40	602.6300	Shpenzime per qeramarrje per aparate e mjete transporti	74,115	74,115	100%
41	602.6900	Shpenzime te tjera qeraje			
42	602.7400	Shpenzime per vendime gjyqi	20,761,850	20,761,850	100%
	602.9	Shpenzime te tjera operative			
43	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	3,053,963	2,665,818	87%
44	602.9003	Shpenzime gjyqesore			
45	6029004	shpenzime per siguracion godine	600,000	600,000	100%
46	602.9005	Shpenzime per honorare pagesat per perkthyesit e jashtem	2,144,821	2,144,821	100%
47	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca			
48	6029008	Shpenzime per tatim&taksa te inst. (taksat e pastrimit etj)	49,320	49,320	100%
49	602.9000	Shpenzime per tatime & taksa			
50	602.9099	shpenzime te tjera (fond emergjence ne funksion te ligjit per mbrojtjen civile)	13,000	13,000	100%
51	6029100	Pagesa per tarifa te ndryshme			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Shuma Mallra dhe Sherbime	117,138,000	115,756,391	99%
Detyrime			
Totali Mallra dhe Sherbime			

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr. 1, datë 23.06.2023 me B. Q., I. Sh. dhe G. D..

2. MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr. 249/1 datë 05.04.2023, mbi “Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Ministrinë e Drejtësisë (MD)”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organizative e MD dhe krahasimi me faktin,
- Plani i nevojave për rekrutimin e personelit,
- Pagesa e përfituara nga fondi i veçantë,
- Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil si dhe masat e marra nga institucioni në rastin ku punonjësi i larguar ka marrë një vendim të formës së prerë për pagesën e pagës deri në rikthimin e tij në punë, etj

Baza ligjore mbi të cilin u bazua auditimi:

- Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013 “Mbi nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, Dt 12.07.1995 “Mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 114, datë 04.09.2019 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MD”, i ndryshuar;
- VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”
- VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”
- VKM 929, datë 27.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar
- Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, etj.

Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin

Për periudhën objekt auditimi, Struktura dhe Organika e Ministrisë së Drejtësisë është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 114, datë 04.09.2019 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MD”, i ndryshuar me Urdhër nr. 65, datë 11.05.2020 dhe urdhrin nr. 119, datë 25.09.2020, me 149 punonjës. Ndërkohë, me Urdhër nr. 128, datë 08.11.2021, kjo strukturë është shfuqizuar, duke ristrukturuar Drejtorinë Antikorrupsion, si dhe duke shtuar numrin e punonjësve në 181.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Për funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë është miratuar Rregullorja e Brendshme me Urdhër nr. 545, datë 13.08.2008, i ndryshuar dhe me Urdhër nr. 116, datë 30.03.2022. Nga auditimi i përputhshmërisë së Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e MD-së”, me strukturën organizative të saj, u konstatua se në Rregulloren e Brendshme deri në mars 2022 mungojnë përshkrimet e punës për drejtoritë dhe sektorët në varësi të Drejtorive të përgjithshme, ndërsa në Rregulloren e re miratuar në mars 2022 konstatohet se mungon përshkrimi i punës i sektorëve pjesë e drejtorive. Në rregulloren aktuale në fuqi janë listuar në mënyrë të përgjithshme detyrat e Drejtuesve dhe specialistëve dhe më tej vetëm përshkrimet e Drejtorive, por pa detajime të përshkrimeve konkrete të punës të përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve, sipas drejtorive ku bëjnë pjesë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pikat 14 dhe 15.

Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni. Si rregull, përshkrimi i punës hartohet nga analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Si dhe në kundërshtim me udhëzimin e DAP, nr. 01, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil” .

Procesi i hartimit të përshkrimit të punës në një institucion realizohet duke ndjekur hierarkinë sipas strukturës organizative të institucionit. Fillimisht hartohet përshkrimi i punës për sekretarin e përgjithshëm/titullarin, më pas për drejtorin e përgjithshëm/drejtor i drejtorisë, shefat e sektorit dhe specialistët.

Nga auditimi konstatohet se edhe në Rregulloren e re të miratuar nga ndryshimi i fundit i strukturës, mungojnë detajimet për pozicionet e përgjegjës të sektorit dhe të gjithë specialistëve, në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar.

Për përmbushjen e kompetencave të veta, Ministri i Drejtësisë miraton rregulla të hollësishme për administrimin e përditshëm të veprimtarisë, funksionimin e brendshëm, përshkrimin e punës të punonjësve, rregullin dhe disiplinën në institucion.

Observacionet e subjektit: me shkresën nr.4277, datë 01.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 249/11, datë 01.08.2023, janë dërguar observacione lidhur me konstatimin mbi mos hartimin e plotë të përshkrimeve të punës të sektorëve pjesë të drejtorive. Nga grupi i auditimit vihet re se komentet janë të njëjtat me ato të trajtuara tashmë në projekt raport dhe nuk shoqërohen me fakte apo evidenca të reja të cilat të identifikojnë përshkrimet e punës për sektorët dhe specialistët dhe konkretisht rolin dhe detyrat teknike të detajuara, si dhe marrëdhëniet hierarkike.

Referuar strukturës së miratuar, konstatohet se për vitet 2020-2022 MD do të funksionojë me 149 punonjës deri në nëntor 2021 dhe 181 punonjës në vijim. Konkretisht deri në nëntor 2021, MD ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

funksionuar me 4 Drejtori të Përgjithshme, 11 Drejtori dhe 28 sektorë dhe më tej me 5 Drejtori të Përgjithshme, 14 Drejtori dhe 31 sektorë.

Nga auditimi me përzgjedhje mbi plotësimin e strukturës rezultoi si vijon:

Tabela nr. 23

Emërtimi	2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Shkurt	149	123				
Tetor	149	121				
Mars			149	131		
Shtator			149	127		
Prill					181	140
Nëntor					181	144

Nga të dhënat konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi struktura e MD ka qenë e pa plotësuar dhe konkretisht në shkurt 2020 me 26 punonjës më pak, në tetor 2020 me 28 punonjës më pak, në mars 2021 me 18 punonjës më pak, në shtator 2021 me 22 punonjës më pak, në prill 2022 me 41 punonjës më pak dhe në nëntor 2022 me 37 punonjës më pak.

Në varësi të nevojave për rekrutim në shërbimin civil u konstatua se, MD ka dërguar shkresat përkatëse pranë DAP, konkretisht me shkresë nr. 8365/1, datë 24.12.2019 për vitin 2020 me 26 punonjës, me shkresë nr. 7528/1, datë 18.12.2020 për vitin 2021 me 7 punonjës dhe me shkresë nr. 6598, datë 21.12.2021 për vitin 2022 me 56 punonjës. Nga auditimi rezulton se nevojat për rekrutim janë dërguar në shkelje të afateve të parashikuar nga VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetortë pranimit në shërbimin civil”, pika 7.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo ministrive, brenda muajit nëntor, i dërgon Departamentit të Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranimit për të gjithë sistemin përkatës.

Nga auditimi konkludojmë se MD është në kushte të funksionimit me një përqindje të lartë të vendeve vakante, veçanërisht përgjatë viti 2022 ku vihet re se ka mangësi në rreth 23% të strukturës, duke krijuar vështirësi në punën e përditshme dhe duke rritur riskun operacional që shoqëron veprimtarinë e saj. Ekzistenca e këtyre vendeve vakante duhet të shoqërohet me një bashkëpunim më koherent me DAP.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Pagat e punonjësve në Aparatin e Ministrisë janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar VKM nr. 187, datë 03.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucionit dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, Për vitin 2020, janë miratuar me VKM nr. 47, datë 22.01.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, 12 punonjës me kontratë të përkohshme për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht 8 operatorë, 2 punonjës arkive dhe 2 punonjës informacioni, numër i cili është respektuar.

Për vitin 2021, janë miratuar me VKM nr. 1151, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, 12 punonjës me kontratë të përkohshme për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht 8 operatorë, 2 punonjës arkive dhe 2 punonjës informacioni, numër i cili është respektuar.

Për vitin 2022, janë miratuar me VKM nr. 35, datë 19.01.2022, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, 14 punonjës me kontratë të përkohshme për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht 10 operatorë, 2 punonjës arkive dhe 2 punonjës informacioni, numër i cili është respektuar.

U audituan me zgjedhje listë pagesat e muajve shkurt dhe tetor 2020; mars dhe shtator 2021 dhe prill dhe nëntor 2022. Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave rezultoi se janë hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, nga Drejtori i Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm. Listë pagesat shoqërohen nga listë prezencat në punë nga secila Drejtori, Listë pagesat janë plotësuar me të gjitha elementet e pagës për çdo punonjës duke filluar si nga emërtesa sipas strukturës, paga bazë, ditë pune etj. edhe në rubrikën e “shtesave” apo “ndalesave”. Nga auditimi rezulton se përlllogaritja e pagave është kryer sipas kategorive të përcaktuara në Urdhrat përkatës të Kryeministrit për miratimin e strukturës. Tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ndërsa kontributi i sigurimeve shoqërore është llogaritur në zbatim të Ligjit nr. 10070, datë 05.02.2009 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, si dhe janë kryer ndalesat, të cilat janë derdhur në Degën Rajonale të Tatimeve.

Në tërësi planifikimi dhe përdorimi i fondit të pagave paraqitet si vijon:

Tabela nr. 24

në 000 lekë

Emërtim i	2020			2021			2022		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Fondi i pagave	132,646	131,699	99.2	164,829	142,171	86	168,437	168,125	99.8
Sigurime	22,135	21,498	97	38,905	23,442	60	27,938	27,714	90.2

Zbatimi i vendimeve të gjykatës

Nga auditimi mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar konstatohet se, referuar llogarisë përkatëse në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi janë kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

shpenzime nga buxheti i aparatit për vendime gjyqësore, në një vlerë prej **45,613,569** lekë të cilat përfshijnë paga, kontribute dhe tarifa përmbarimi dhe konkretisht për vitin 2020, në total 22,982,329 lekë nga të cilat 971,665 janë tarifa përmbarimi; për vitin 2021 në total 1,869,390 lekë nga të cilat 52,446 lekë tarifa përmbarimi dhe për vitin 2022, në total 20,761,850 lekë nga të cilat 78,000 lekë tarifa përmbarimi.

Nga auditimi rezulton se deri në vitin 2019, sektori i financës ka operuar me pagesat ndaj gjyq fituesve vetëm në pagën neto, duke mos derdhur kontribute për sigurime për gjyq fituesit pothuajse që në vitin 2011. Pas konstatimit të këtij fakti, sektori i financës ka kryer përlllogaritjen dhe ka filluar kryerjen e pagesave për kontributet e pa shlyera ndaj këtyre gjyq fituesve, ku pjesa më e madhe e pagesave janë kryer në vitin 2020 dhe konkretisht rreth 3,731,037 lekë. Për sa më lart, krahas pagesave të 11 gjyq fituesve për periudhën objekt auditimi, mos kryerja e pagesave të plota në vlerën bruto për periudhat e mëparshme, ka bërë që kosto e këtyre pagesave të rëndojë buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën objekt auditimi, por edhe më tej deri në përfundimin e shlyerjes së detyrimit për kontribute ndaj gjyq fituesve.

Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratë shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, MD ka krijuar bazën e të dhënave si dhe është ngritur Komisioni i Posaçëm “Për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë”. Nga ky Komision janë marrë në shqyrtim të gjitha faktet dhe rrethanat e lindura për ekzekutimin e vendimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna dhe pas vlerësimeve dhe diskutimeve me gjyq fituesit është arritur të zbatohen Vendimet gjyqësore përkatëse dhe janë rikthyer në punë 5 nga 11 gjyq fituesit e cituar më lart.

Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr. 2 me M. Z., E. M. dhe B. Q.

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në hartimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit.

Situata: Nga auditimi rezulton se në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të MD janë listuar në mënyrë të përgjithshme detyrat e Drejtuesve dhe specialistëve dhe më tej vetëm përshkrimet e Drejtorive, por pa detajime të përshkrimeve konkrete të punës të përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve, sipas drejtorive ku bëjnë pjesë.

Kriteri: Udhëzimi i DAP, nr. 01, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”; Neni 9 i Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar.

Shkaku: Mos hartimi i përshkrimeve të detajuara të punës për këto pozicione.

Efekti: Paqartësi në detyrat specifike dhe linjat e raportimit.

Rëndësia: e mesme.

Rekomandimi 1.1: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marra masa për ngritjen e grupit të punës përkatës për përmirësimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit, duke e plotësuar atë me rregulla dhe përshkrime të hollësishme mbi detyrat, përgjegjësitë dhe rolet në administrimin e veprimtarisë së përditshme për përgjegjësit e sektorëve dhe specialistëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Brenda 31.12.2023

Titulli i gjetjes 2: Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar konstatohet se, referuar llogarisë përkatëse në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime nga buxheti i aparatit për vendime gjyqësore, në një vlerë prej **45,613,569** lekë të cilat përfshijnë paga, kontribute dhe tarifa përmbarimi dhe konkretisht për vitin 2020, në total 22,982,329 lekë nga të cilat 971,665 janë tarifa përmbarimi; për vitin 2021 në total 1,869,390 lekë nga të cilat 52,446 lekë tarifa përmbarimi dhe për vitin 2022, në total 20,761,850 lekë nga të cilat 78,000 lekë tarifa përmbarimi. Nga auditimi rezulton se deri në vitin 2019, sektori i financës ka operuar me pagesat ndaj gjyq fituesve vetëm në pagën neto, duke mos derdhur kontribute për sigurime për gjyq fituesit pothuajse që në vitin 2011. Pas konstatimit të këtij fakti, sektori i financës ka kryer përlllogaritjen dhe ka filluar kryerjen e pagesave për kontributet e pa shlyera ndaj këtyre gjyq fituesve, ku pjesa më e madhe e pagesave janë kryer në vitin 2020 dhe konkretisht rreth 3,731,037 lekë. Për sa më lart, krahas pagesave të 11 gjyq fituesve për periudhën objekt auditimi, mos kryerja e pagesave të plota në vlerën bruto për periudhat e mëparshme, ka bërë që kosto e këtyre pagesave të rëndojë buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën objekt auditimi.

Kriteri: Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe Vendimet gjyqësore përkatëse.

Shkaku: Largimi i pa drejtë i punonjësve.

Efekti: Shkaktimi i një efekti financiar negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 45,613,569 lekë.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 2.1: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse disiplinore të marrin masa që në të ardhmen vendimet për shkarkimet nga puna të jenë të argumentuara saktë, në mënyrë të dokumentuar dhe të justifikuar, si dhe të garantohet ndjekia e të gjitha hapave të nevojshme të njoftimit apo vlerësimit të arsyes së largimit, në mënyrë që të shmangen efektet financiare negative në buxhet.

Në vijimësi

Rekomandimi 2.2: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse, të marrin masa për vlerësimin dhe sistemimin e gjyqëfituesve në listë pritje, në pozicionet vakante të cilat MD i ka në një nivel të lartë aktualisht, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, duke qenë se kjo mundësi parashikohet nga aktet ligjore përkatëse mbi shërbimin civil.

Menjëherë

3. MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE MBI ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

Lidhur me dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare, u audituan veprimet institucionit me arkë dhe bankë. Sa i takon veprimeve me arkë, rezulton se ato regjistrohen kronologjikisht në ditarin përkatës, i cili përmban natyrën, datën dhe përmbajtjen e veprimit ekonomik. Megjithatë, veprimet me arkë janë sporadike vetëm në pak raste sa i takon udhëtimeve jashtë vendit për të cilat punonjësit tërheqin vlerën e paradhënies. Veprimet me arkë shoqërohen me dokumentacionin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

përkatës justifikues, procedurat shkresore për kurset e këmbimit dhe në përfundim bëhen derdhjet përkatëse në llogari nga vlerat e mbetura të paradhënieve, apo të kthyerat.

Sa i takon veprimeve me bankë, institucioni kryen kryesisht veprime shpenzime për paga, sigurime, shpenzime për përkthime zyrtare dhe mallra e shërbime sipas buxhetit të disponueshem. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me bankën, u konstatua se, transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësit autorizues dhe zbatues dhe të shoqëruara me dokumentacion justifikues. Transaksionet e kryera për mallra e shërbime janë të parashikuara në regjistrat vjetor përkatës, si dhe të miratuar në buxhetet vjetore.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve nëpërmjet bankës u konstatua:

Për periudhën objekt auditimi, një peshë të konsiderueshme në zërin e shpenzimeve operative zë shërbimi i përkthimeve zyrtare për të cilin rezulton se MD ka shpenzuar në total për të tre vitet vlerën prej 104,267,661 lekë dhe përkatësisht 43% të shpenzimeve të vitit 2020, 21% të shpenzimeve operative të vitit 2021 dhe 46% të shpenzimeve të vitit 2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura për marrjen në dorëzim të përkthimeve të kryera, vihet re se në të gjitha rastet, MD shprehet se materialet i jepen përkthyesve zyrtarë të jashtëm për shkak të pamundësisë aktuale të realizimit të përkthimit nga Sektori i Përkthimit Zyrtar, ose për shkak të materialit voluminoz në fjalë. Nga auditimi rezulton se ky arsyetim përdoret edhe në rastet e materialeve të përkthimit me përmbajtje nga 1 deri në 3 faqe për të cilat jepet një afat kohor deri në 7 ditë periudhë e cila është e mjaftueshme për tu përballuar nga Sektori i Përkthimit Zyrtar në MD, sektor i cili përbëhet nga 1 përgjegjës dhe 5 specialistë. Gjithashtu konstatohet se brenda një viti nuk bëhet një shpërndarje e drejtë mes përkthyesve, pasi shumë nga përkthyesit zyrtarë të miratuar nuk janë angazhuar asnjëherë në përkthimin e materialeve, ndërkohë disa të tjerë evidentohen shumë më shpesh të angazhuar. Nga sa më lart, rezulton se për shërbimin e përkthimeve, MD nuk operon sipas një rregulloreje apo udhëzimi të brendshëm të miratuar, sipas të cilit të bëhen transparente mënyra e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve, mënyra e dokumentimit të ngarkesave në punë të sektorit të përkthimeve pranë MD, për shkak të të cilës ky sektor e ka të pamundur të realizojë qoftë edhe përkthimet prej 1 apo 2 faqesh, etj. Me Urdhër nr. 162, datë 09.06.2020 të Ministrit të MD, është miratuar lista e përkthyesve të autorizuar për përkthimin zyrtar për vitin 2020 dhe me Urdhër nr. 421, datë 15.12.2020 është miratuar kjo listë për vitin 2021. Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 nuk është miratuar kjo listë, duke bërë që të vijohet automatikisht me përkthyesit e vitit të mëparshëm, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërbimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar.

Ministri i Drejtësisë miraton listën vjetore të përkthyesve të jashtëm të Ministrisë së Drejtësisë për vitin pasues kalendarik me tre përkthyes për çdo gjuhë komunikimi të përcaktuar në konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Së fundmi, sa i takon shërbimit të përkthimeve zyrtare, konstatohet se në mungesë të një kuadri ligjor për rregullimin e profesionit të përkthyesit zyrtar, MD ka funksionuar me likuidimin e përkthyesve vetëm nëpërmjet paraqitjes së faturave nga blloqe të thjeshta tatimore dhe në mungesë të kuponit tatimor, pasi shumë prej përkthyesve nuk kanë qenë të regjistruar në organet përkatëse. Me hyrjen në fuqi të ligjit të fiskalizimit dhe Ligjit 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, si dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij përgjatë vitit 2022, përkthyesit zyrtar që nuk kanë qenë subjekte tatimpagues të regjistruar, operonin nëpërmjet dërgimit të faturave tatimore në emër të përkthyesve të tjerë të regjistruar, por jo në çdo rast bashkëlidhur dokumentacionit të likuidimit gjendet dokument verifikues që këta përkthyes janë punonjës pranë subjekteve në emër të të cilëve paraqesin faturat tatimore.

Observacionet e subjektit: Me shkresën nr. 4277/7, datë 01.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 249/11, datë 01.08.2023, janë paraqitur komente mbi konstatimin sa i takon shërbimit të përkthimit zyrtar. Nga grupi i auditimit konstatohet se sqarimet e dhëna janë të njëjtat me ato të trajtuara tashmë në fazën e projekt raportit dhe nuk janë paraqitur fakte apo evidenca të reja mbi observimin e rekomandimit, për këtë arsye qendrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjti dhe mund ti referoheni sqarimit në projekt raport. Po kështu, nisur edhe nga fakti që shpreheni se MD ka nisur të marrë masa për të hartuar një rregullore mbi mënyrën se si do të funksionojë shpërndarja e punës në sektorin e përkthimeve, rekomandimi qendron.

Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në disa raste në vitin 2022, për likuidimin e dietave për shërbimet e kryera brenda vendit, personat udhëtues kanë paraqitur foto të printuar të faturave tatimore, të cilat referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të jenë origjinale dhe gjithashtu në këtë format nuk është i mundur as skanimi i kodit të fiskalizimit, për garantimin e rregullshmërisë së faturës tatimore. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor tatimor dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga auditimi i veprimeve me bankën rezultoi se, në tërësi, sa i takon procedurave të blerjeve nëpërmjet prokurimit me vlerë nën 100.000 lekë, grupet e marrjes në dorëzim të shërbimit apo mallit hartojnë procesverbale tepër formale për marrjen në dorëzim, në të cilat deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika. Në shumë raste, kryesisht për procedurat e blerjeve të dekoreve apo dhuratave për pritje përcjellje, rezulton se nuk hartohen as specifikime të natyrës së dekorit, apo dizenjove të dhuratave të kërkuara, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre. Veprimet e mësipërme kryhen në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Ne çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhëna te nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi me G. D., I. Sh., M. Z., B. Q., V. Xh., F. C., K. K., A. P.

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në menaxhimin e shërbimit të përkthimit zyrtar.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, një peshë të konsiderueshme në zërin e shpenzimeve operative e zë shërbimi i përkthimeve zyrtare për të cilin rezulton se MD ka shpenzuar në total për të tre vitet vlerën prej 104,267,661 lekë dhe përkatësisht 43% të shpenzimeve të vitit 2020, 21% të shpenzimeve të vitit 2021 dhe 46% të shpenzimeve të vitit 2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura për marrjen në dorëzim të përkthimeve të kryera, vihet re se në të gjitha rastet, MD shprehet se materialet i jepen përkthyesve zyrtarë të jashtëm për shkak të pamundësisë aktuale të realizimit të përkthimit nga Sektori i Përkthimit Zyrtar, ose për shkak të materialit voluminoz në fjalë. Nga auditimi rezulton se ky motivacion përdoret edhe në rastet e materialeve me përmbajtje nga 1 deri në 3 faqe për të cilat jepet një afat kohor deri në 7 ditë periudhë e cila është e mjaftueshme për tu përballuar nga Sektori i Përkthimit Zyrtar në MD. Nga sa më lart, rezulton se për shërbimin e përkthimeve, MD nuk operon sipas një rregulloreje apo udhëzimi të brendshëm të miratuar, sipas të cilit të bëhen transparente mënyra e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve, mënyra e dokumentimit të ngarkesave në punë të sektorit të përkthimeve pranë MD, për shkak të të cilës ky sektor e ka të pamundur të realizojë qoftë edhe përkthimet prej 1 apo 2 faqesh, etj. Me Urdhër nr. 162, datë 09.06.2020 të Ministrit të MD, është miratuar lista e përkthyesve të autorizuar për përkthimin zyrtar për vitin 2020 dhe me Urdhër nr. 421, datë 15.12.2020 është miratuar kjo listë për vitin 2021. Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 nuk është miratuar kjo listë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar

Shkaku: Mungesë e një kuadri të plotë rregullator.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 1.1: Sektori përgjegjës për përkthimet zyrtare të marrë masa për plotësimin e mëtejshëm të Udhëzimit nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, ose për hartimin e një rregullore të funksionimit të këtij shërbimi, duke pasqyruar qartë dhe në mënyrë transparente mënyrën e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve, si dhe të vijojë me miratimin e listës së përkthyesve zyrtar deri në momentin e vënies në funksion të plotë të regjistrit kombëtar të përkthyesve

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Rekomandimi 1.2: Duke marrë shkak nga volumi tepër i lartë i përkthimeve zyrtare në MD, si dhe vlera tepër e lartë e fondeve që zë në buxhet ky shërbim, sektori përkatës për përkthimet zyrtare dhe titullari i MD të marrin masa për studimin dhe analizimin nga pikëpamja financiare, të mundësisë së shtimit sipas nevojës të numrit të punonjësve në strukturën e sektorit të përkthimeve, në mënyrë që të shmangen sa më tepër të jetë e mundur shpenzimet e larta për këtë shërbim, por edhe risqet e shpërndarjes së materialeve konfidenciale jashtë institucionit.

Menjëherë

Titulli i gjetjes 2: Realizimi formal i procedurave të prokurimit me vlerë nën 100.000 lekë.

Situata: Nga auditimi i veprimeve me bankën rezultoi se, në tërësi, sa i takon procedurave të blerjeve nëpërmjet prokurimit me vlerë nën 100.000 lekë, grupet e marrjes në dorëzim të shërbimit apo mallit hartojnë procesverbale formale për marrjen në dorëzim, në të cilat deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika. Në shumë raste, kryesisht për procedurat e blerjeve të dekoreve apo dhuratave për pritje përcjellje, rezulton se nuk hartohen as specifikime të natyrës së dekorit, apo dizenjove të dhuratave të kërkuara, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre.

Kriteri: Pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Shkaku: Mangësi në realizimin e procedurave me vlerë nën 100.000 lekë për shkak të vlerës së ulët të fondit.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 2.1: Sektori përgjegjës për prokurimet dhe komisionet e prokurimeve të blerjeve me vlerë të vogël, të marrin masa për garantimin e një procesi sa më transparent të prokurimit të fondeve publike, duke hartuar specifikime konkrete dhe të matshme për objektet që prokurojnë dhe në këtë mënyrë edhe procesi i marrjes në dorëzim të ketë një bazë krahasimi dhe të dokumentohet me detaje se objekti i prokuruar që po pranohet, përputhet me nevojat e AK.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 3: Mos administrimi i dokumentacionit origjinal

Situata: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në mënyrë të përsëritur në vitin 2022, për likuidimin e dietave për shërbimet e kryera brenda vendit, personat udhëtues kanë paraqitur foto të printuar të faturave tatimore, të cilat referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të jenë origjinale dhe gjithashtu në këtë format nuk është i mundur as skanimi i kodit të fiskalizimit, për garantimin e rregullshmërisë së faturës tatimore.

Kriteri: Kuadri ligjor tatimor dhe Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Shkaku: Mos dorëzimi i faturave origjinale nga punonjësit.

Efekti: Pa mundësi verifikimi e rregullsisë së faturës.

Rëndësia: e ulët

Rekomandimi 3.1: Sektori i Financës në MD të marrë masa për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin dhe të mbaje parasysh që dokumenti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

financiar të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, si dhe të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Në këtë kuadër, Sektori i Financës të marrë masa për mos likuidimin e faturave tatimore jo origjinale për të cilat nuk mund të verifikohen elementët e rregullshmërisë.

Në vijimësi

4. MBI AUDITIMIN E LLOGARIVE VJETORE

Për vitet objekt auditimi ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Degës së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Ministrinë e Drejtësisë është bërë në përputhje me ligjin nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me planin kontabël të miratuar për institucionet dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr.46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”, Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”.

Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare

Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1859 prot, datë 30.03.2021, në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave, konfirmuar nga dega e thesarit.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formatit nr.1; Pasqyrën e performancës financiare sipas formatit nr.2; Pasqyrën e flukseve monetare sipas formatit nr.3; Pasqyrën e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto sipas formatit nr.4; Pyetësonin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.5 dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën e Investimeve dhe Burimet e financimit sipas formatit nr.6, Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Afatgjata (Kosto Historike) sipas formatit nr.7/a Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlerë Neto) sipas formatit 7/b; si dhe Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.8. Pasqyra financiare është e firmosura nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues. Bashkangjitur gjendet dhe relacioni shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Pasqyrat financiare viti 2020 .

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2020, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 25

Në Lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi 2020 i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes 2019	Diferenca
A	A K T I V E T	1,769,145,606	1,657,548,384	111,597,222
	I.Aktivet Afat shkurtra	335,271,288	381,703,574	-46,432,286
	1.Mjete monetare dhe ekujalent te tyre	15,843,358	14,821,242	1,022,116
531	Mjete monetare ne Arke			0
512,56	Mjete monetare ne Banke			0
520	Disponibilitete ne Thesar	15,843,358	14,821,242	1,022,116
50	Letra me vlere			0
532	Vlera te tjera			0
54	Akreditiva dhe paradhanie			0
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)			0
	2.Gjendje Inventari qarkullues	11,158,737	7,743,702	-3,415,035
31	Materiale	10,368,983	7,617,612	2,751,371
32	Inventar I imet	789,754	126,090	663,664
	3.Llogari te Arketushme	206,728,688	227,068,170	-20,339,482
411	Kliente e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhanie, deficite, gjoba		4,563	-4,563
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere			
468	Debitore te ndryshem	192,674,370	192,729,430	-55,060
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	14,054,318	34,334,177	-20,279,859
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike			0
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)			
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	101,540,505	132,070,460	-30,529,955
409	Parapagime			0
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin			0
477	Diferenca konvertimi aktive			0
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime			
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	101,540,505	132,070,460	-30,529,955
	II.Aktivet Afat gjata	1,433,874,318	1,275,844,810	158,029,508
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	5,505,074	7,077,561	-1,572,487
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave			
202	Studime dhe kerkime	5,505,074	7,077,561	-1,572,487
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme			
21	2.Aktive Afatgjata materiale	626,108,221	641,576,047	-15,467,826
210	Toka, T,roje, Terene			0
211	Pyje, Plantacione			
212	Ndertesa e Konstruksione	445,324,247	391,707,563	53,616,684
213	Rruge, rrjete, veptra ujore			
214	Instalime teknike, makineri e paisje	13,589,249	14,805,744	-1,216,495



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

215	Mjete Transporti	7,471,798	9,339,748	-1,867,950
216	Rezerva Shteterore			
217	Kafshe pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	159,722,927	225,722,992	-66,000,065
	4.Investime	802,261,023	627,191,202	175,069,821
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	786,007,532	558,739,009	227,268,523
231	Per Aktive Afatgjata materiale	16,253,491	68,452,193	-52,198,702

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Zëri Aktive

Shuma e aktivitet të pasqyrës financiare pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitet të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2020, rezulton se totali i aktivitet me 31.12.2020 paraqitet me vlerën 1,769,145,606 lekë dhe se, “Aktive të Qëndrueshme”, zënë 81 % të vlerës totale të aktivitet ndërsa, Aktivitet Qarkulluese zënë 19% të vlerës totale. Aktivitet e Qëndrueshme në krahasim me vitin 2019, janë shtuar në vlerën 158,029,508 lekë ndërsa, Aktivitet Qarkulluese janë pakësuar në vlerën -46,432,286 lekë

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues”, “Llogarive të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare dhe ekuivalenet të tyre me vlerë 15,843,358 lekë e cila është shtuar nga viti shtuar me 1,022,116 lekë dhe përbëhet nga:
Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerën prej 15,843,358 lekë e cila është shtuar nga viti shtuar me 1,022,116 lekë. Kjo llogari përfaqëson shumën e garancive për punimet në investime, e barabartë me llogarinë pasive 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.
2. Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 11,158,737 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një shtim me 3,415,035 lekë nga viti i shkuar 2020. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën e performancës.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 10,368,983 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 2,751,371lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2020
 - Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 789,754 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 663,664 lekë.
3. Llogari të arkëtueshme me vlerë 206,728,688 lekë e cila përbëhet nga:



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 192,674,370 lekë pakësuar nga viti i kaluar me 55,060 lekë, e cila përbëhet nga detyrime të krijuara për periudhën 1996-2012.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 14,054,318 lekë pakësuar nga viti shkuar me 20,279,859 lekë, kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2020, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 26

Në Lekë

Nr	Emri	Teprica me 31.12.2020						Total Teprica me 31.12.2020
		llog.230+231	llog.600	llog.601	llog.602	llog.605	llog.606	
1	Detyrime te konstatuara dhjetor 2020 te likujduara me buxhetin e 2021				208,922		30,000	238,922
2	Detyrime listpagesa personeli dhjetor 2020							-
a	Paga Neto (llogaria 421)		9,291,886					9,291,886
b	Sigurime shoqërore e shëndetësore, suplementar dhe TAP te muajit dhjetor2020		2,590,207	1,933,303				4,523,510
	Totali	-	11,882,093	1,933,303	208,922	-	30,000	14,054,318

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

4. Të tjera aktive afatshkurtra në vlerën 101,540,505 lekë e cila përbëhet nga:

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 101,540,505 lekë, pakësuar nga viti i kaluar me -30,529,955 lekë, dhe që përfshin shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime dhe investime. Kjo llogari grupohet në katër kategori: detyrime para viti 2000; detyrime të viteve 2009 – 2010; detyrime të viteve 2011 – 2012, në vlerë totale 788,505 lekë, të cilat nuk janë likujduar për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës; dhe detyrime të vitit 2017, vlera prej 71,952,000 lekë nuk është likujduar për shkak se MD është në proces gjyqsor me palën e kontraktuar dhe vlera prej 28,800,000 lekë nuk është likujduar për shkak se për këtë projekt KLSH ka rekomanduar revokimin e kontrates dhe për rrjedhojë edhe të faturës tatimore. Grupi i punës i ngritur për zbatimin e rekomandimeve të KLSH po vijon punën për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të kontratës së lartpërmendur.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 1,433,874,318 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “investime”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 5,505,074 lekë, e cila përbëhet nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 5,505,074 lekë dhe që përbëhet nga TVSH e Projektit Euralius në vlerën 904,114,016 lekë; Projektin i Binjakëzimit “Mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” në shumën 695,230 lekë, projekti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

i të miturve në Mëzes në vlerën 11,266,773 lekë dhe Projekti për rikonstruksionin e ASHSGJ në vlerën 1,339,758 lekë.

2. Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 626,108,221 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 15,467,826 lekë përbëhet nga:

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 445,324,247 lekë. Kjo vlerë është e detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 27

Në Lekë

Llogaria kontabel	EMERTIMI I AKTIVIT	Teprica ne fillim 01.01.2020			Shtesat gjate vitit 2020		Paksimet gjate vitit 2020		Teprica ne Fund 31.12.2020		
		Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
		Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2120101	Vlera e Godines se Ministrise se Drejtises& biblioteka	282,191,018	61,279,215	220,911,803	72,897,842	11,045,590			355,088,860	72,324,805	282,764,055
2120101	Godina e Kolegjit te Posacem te Apelit	132,747,335	13,794,714	118,952,621		5,947,631			132,747,335	19,742,345	113,004,990
2120101	Godina e Gjykates Administrative te Apelit	79,116,113	27,272,973	51,843,140		2,592,157			79,116,113	29,865,130	49,250,983
2120112	Biblioteka (Fondi i librave)	304,220	304,220	0				304,220	304,220	0	304,220
	T O T A L I	494,358,686	102,651,123	391,707,563	72,897,842	19,585,378	0	304,220	567,256,528	121,932,281	445,324,247

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Shtesa në vlerën 72,897,842 përfaqëson investimin e përfunduar për rehabilitimin e arkivës së MD, transferuar nga llogaria 231 në llogarinë 212.

Në përputhje me SKK nr. 5, pika 30 përjashtim nga llogaritja e amortizimit bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

-Llogaria 214 “ Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 13,589,249 lekë dhe krahasuar me vitin paraardhës është pakësuar me vlerën 1,216,495 lekë, e detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 28

Në Lekë

Llogaria kontabel	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
		Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2140170	Kondicionere	5,851,552	2,870,834	2,980,718	120,000	546,641	1,015,180	438,774	4,956,372	2,978,701	1,977,671
2140170	Kondicionere te blere ne vitin 2020				490,668				490,668	0	490,668
2140320	Ashensore	13,491,880	5,726,341	7,765,539		388,277			13,491,880	6,114,618	7,377,262
2140320	Gjeneratorore, pompa uji,nafte,qarkulluese etj	5,143,320	3,234,742	1,908,578		95,429			5,143,320	3,330,171	1,813,149



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

1014001	7115499	Të tjera gjoba	21,303	121,303			121,303	
1014001	7110199	Te tjera Tarifa Administrative dhe Rregullatore nacionale	20,000	55,000			55,000	
1014001	7113099	Te tjera nga shitja e mallrave e sherbimeve		60,000			60,000	
		T O T A L I	41,303	3,117,323	-	-	3,117,323	

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Mbi shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2022. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2022 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2021.

Në pasqyrën e shpenzimeve të periudhës ushtrimore, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 753,805 lekë, të ndara sipas zërave si:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Llogaria (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 168,125,261 lekë ose 49.22 % të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2021.
 - Llogaria (601) “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 27,714,394 lekë ose 8.11 % të totalit të shpenzimeve.
 - Llogaria (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 115,756,397 lekë ose 33.89 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2022.
 - Llogaria (605) “Transferime korrente me jashte” në vlerën 26,492,535 lekë ose 7.76 % të totalit të shpenzimeve.
 - Llogaria (606) “Transferita për buxhete familjare e individët” në vlerën 2,714,630 lekë ose 0.79 % të totalit të shpenzimeve.
 - Llogaria (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 753,805 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 “transferim për ndryshim gjendje inventari” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.
- Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 janë si më poshtë:

Tabela nr. 64

Në Lekë

Nr. Llogarie	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR 2022	VITI I MEPARSHEM 2021	Diferenca
B	SHPENZIMET	341,557,022	269,838,488	71,718,534
600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	168,125,261	142,171,180	25,954,081
6001	Paga, personel I perhershëm	154,627,695	129,631,781	24,995,914
6002	Paga personel I Perkohshëm	13,497,566	12,539,399	958,167
6003	Shperblime			0
6009	Shpenzime te tjera per personelin			0
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	27,714,394	23,441,812	4,272,582
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	24,846,371	21,027,347	3,819,024
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,868,023	2,414,465	453,558
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	115,756,397	75,787,230	39,969,167
602	Mallra dhe sherbime te tjera			0
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	7,398,047	10,164,160	-2,766,113
6021	Materiale dhe sherbime speciale	92,787	12,900	79,887
6022	Sherbime nga te trete	62,865,310	43,704,822	19,160,488
6023	Shpenzime transporti	4,924,192	4,055,179	869,013
6024	Shpenzime udhetimi	9,677,804	4,597,964	5,079,840
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	7,370,589	7,764,744	-394,155
6026	Shpenzime per qeramarrje	78,000	72,600	5,400
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	20,683,850	1,816,944	18,866,906
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0		0
6029	Shpenzime te tjera operative	2,665,818	3,597,917	-932,099
603	IV.SUBVECIONE	0	0	0
	V.TRANSFERIME KORENTE	29,207,165	29,762,048	-554,883
604	1.Transferime korente te brendshme	0	0	0
605	2.Transferime korente me jashte	26,492,535	28,320,994	-1,828,459
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	26,492,535	28,320,994	-1,828,459
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja			0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja			0
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit			0
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	2,714,630	1,441,054	1,273,576
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH			0
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	2,714,630	1,441,054	1,273,576
	VL.SHPENZIME FINANCIARE	0	0	0
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	753,805	-1,323,782	2,077,587
	IX.SHPENZIME TE TJERA	0		0
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	-753,805	1,323,782	-2,077,587

Burimi: MD, përpunoi grupi auditimit

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me thesarin dhe nuk u konstatuan diferenca ndërmjet vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe akt rakordimi me thesarin. Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Tabela nr. 65

Në Lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	340,803,213	340,803,213	0
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	168,125,261	168,125,261	0
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	27,714,394	27,714,394	0
602	Mallra dhe shërbime te tjera	115,756,397	115,756,397	0
605	Transferta korente me jashtë	26,492,535	26,492,535	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	2,714,630	2,714,630	0

Burimi: MD, përpunoi Grupi i Auditimit

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Viti 2022

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2022:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 1** “Pasqyra e pozicionit”

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 1,767,903,132 lekë në vitin 2021;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 2** “Pasqyra e performancës”

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 340,803,217 lekë (341,557,022- 753,805). Pra totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 2), në shumën 340,803,217 lekë;

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr.2, për 753,805 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 3** “Pasqyra e cash floë” kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.4** “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto” kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 1,433,814,950 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.5** “Shënimet shpjeguese”, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave tëparaqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë,etj);
- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
- informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për MD është 0.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/b** “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin për 1,430,649,023 lekë (Kosto Historike 2,318,566,511 lekë – Amortizim i Akumuluar 887,917,488 lekë).

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket këtyre llogarive.

Mbyllja e bilancit për vitin 2020 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar.

Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr. 4, datë 23.06.2023 me I. Sh., G. D. dhe B. Q..

Observacionet e subjektit: Me shkresën nr. 4277/7, datë 01.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 249/11, datë 01.08.2023, subjekti ka paraqitur observacionet mbi akt rakordimet si dhe llogarinë 520, të cilat rezultojnë të jenë të njëjtat me ato të trajtuara tashmë në projekt raport dhe nuk shoqërohen me fakte apo evidenca të reja të cilat të hedhin poshtë rekomandimin. Pë sa më lart grupi i auditimit mbetet i të njëjtit qendrim si ai i sqaruar në projekt raport.

Titulli i gjetjes 1: Mbi llogaritë vjetore të institucionit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, mungonin aktrakordimet për tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, të cilat në përputhje me pikën 50 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, *duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*

Kriteri Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/efekti: Pasqyrim jo i plotë i situatës së njësisë ekonomike.

Shkaku: Mungesë e aktrakordimeve për tepricat e llogarive 520 dhe 466.

Rëndësia: e mesme.

Rekomandimi 1.1: Nga ana e MD të merren masa që pasqyrat financiare të shoqërohen me aktrakordimet për tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në përputhje me Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, duke plotësuar elementet e gjurmës së auditimit mbi zerat e posteve të bilancit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes 2: Mbi parashkrimin e llogarive



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Situata: Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022 Ministria e Drejtësisë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, ka evidentuar detyrime të krijuara nga viti 1996 – 2012, të cilat referuar nenit 203 të Kodit të Punës ose Kreut IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 – vjeçar. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 Ministria e Drejtësisë mbart në llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, detyrime të cilat referuar Kreut IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 – vjeçar. Nga auditimi rezultoi se Ministria e Drejtësisë ka evidentuar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, detyrime të pagueshme të cilat datojnë që nga viti 2000 dhe një pjesë prej tyre, në përputhje me Kreun IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 – vjeçar.

Kriteri: Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/efekti: Kalim i afatit të parashkrimit të drejtat e arketueshme dhe detyrimeve të pagueshme.

Shkaku: Mbartje në kontabilitet e detyrimeve të arkëtueshme dhe pagueshme, të cilat kanë kaluar afatin e parashkrimit.

Rëndësia: e mesme.

Rekomandimi 2.1: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të ri-verifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes 3: Mbi aktivet e Ministrisë së Drejtësisë

Situata: a) Nga auditimi rezultoi se regjistrimi i zërave të aktiveve në Ministrinë së Drejtësisë është kryer me çmimin e blerjes, dhe periudha e hyrjes së tyre i përket viteve shumë më parë. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për kryerjen e rivlersimit të aseteve me qëllim sjelljen e tyre në vlerën e drejtë në kontabilitet.

b) Nga auditimi rezultoi se MD disponon certifikatë pronësie vetëm për Godinën e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa për godinën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe godinën e Kolegji të Posacëm të Apelit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të MD-së në zbatim të VKM, nr. 518, datë 20.9.2017 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posacëm të Apelit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Ligji nr. 84/2016”, i ndryshuar me VKM-në nr. 767, datë 20.12.2017 dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

VKM-në nr. 230, datë 26.04.2018, kanë filluar procedurat për hartimin e planit të rilevimit dhe planimetrive të zyrave, por aktualisht nuk disponohet certifikata e pronësisë.

c) Nga auditimi rezultoi se për periudhën e auditimit MD në llogaritjen e amortizimit për kategorinë e aktiveve “Inventar ekonomik” ka operuar me metodën e amortizimit mbi vlerën e mbetur, në kundërshtim me paragrafin nr. 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

Kriteri: Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”;

Ndikimi/efekti: Pasqyrim jo i saktë i vlerës reale të aktiveve të institucionit. Vështirësi në verifikimin e marrdhënies së institucionit me objektet e rregjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstrukione”. Llogaritje jo e drejtë e amortizimit të kategorisë së aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

Shkaku: Mos kryerja e procesit të rivlersimit të aktiveve; Mungesa e disponimit të titujve të pronësisë; Llogaritja e amortizimit mbi vlerën e mbetur të aktivit.

Rëndësia: e lartë.

Rekomandimi 3.1: Nga ana e institucionit të merren masa për kryerjen e procesit të rivlersimit të aseteve, me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

Rekomandimi 3.2: Nga ana e institucionit, të merren masa për përmbylljen e procedurave dhe paisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e rregjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstrukione”, me qëllim formalizimin e marrdhënies së MD dhe objekteve në pronësi dhe rrjedhimisht pasqyrimin e vlerave përkatëse të trojeve në funksion tyre në llogarinë 210.

Rekomandimi 3.3: Nga ana e institucionit, për kategoritë e aktiveve a) kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave për aktivet e kategorisë, të procedohet me përllogaritjen e amortizimit në mënyrë individuale sipas sipas paragrafit nr. 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes 4: Mbi Llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”.

Situata: : Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 3,415,035 lekë për vitin 2020; në vlerën 1,323,782 lekë për vitin 2021 përfaqëson diferencën absolute mes totalit të operacioneve të të ardhurave me totalin e operacioneve të shpenzimeve. Për këtë llogari nuk janë dhënë sqarime në shënime shpjeguese.

Kriteri: Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Shkaku: Pasqyrim jo i plotë i informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.

Rëndësia: e mesme.

Rekomandimi 4.1: Nga ana e institucionit të merren masa për plotësimin e relacioneve shoqëruese të pasqyrave financiare dhe dhënin e sqarimeve për Llogarinë 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni".

Menjëherë dhe në vijimësi

5. MBI PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE

Auditimi i këtij drejtimi të programit u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

- Dosjet e prokurimit për periudhën 2020-2022.
- Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit publik.
- Praktikat e likuidimit të kryera nga Sektori i Financës.
- Dosjet e zbatimit të kontratave.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime të APP etj.)
- Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.)

Në Ministrinë e Drejtësisë për vitet 2020-2022, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik, funksion si strukturë organike Sektori i Prokurimeve. Sipas periudhës së auditimit, realizimi i procedurave të prokurimit jepet në vijim:

Për vitin 2020, janë realizuar 117 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave të realizuara 58,643,818 lekë me TVSH dhe fond limit 60,657,563 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen më poshtë:

Viti 2020

Tabela nr. 66

			Në lekë	
	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
1	Tender i Hapur	21,325,600	12,861,691	15,434,029
83	Blr.të vogël+nën 100.000 lekë	19,339,035	8,265,306	9,747,879
24	Marrëveshje kuadër/minikontratë	19,107,595	19,100,834	22,921,000
7	Sistem dinamik blerje	669,700	476,402	476,402/ përj. TVSH
1	Shërbim Konsulence	9,583,333	8,214,825	9,857,790
1	Amendim kontrate/shtese	172,300	172,265	206,718
117	Totali	60,657,563	49,091,323	58,643,818

Burimi: MD (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SEP)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Procedurat e prokurimit “marrëveshje kuadër/minikontratë” janë realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) si organ qëndror i blerjeve, në zbatim të VKM nr. 82, datë 14.2.2018 “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” i ndryshuar, ndërsa MD në zbatim të autorizimeve përkatëse lëshuar nga ABP ka lidhur kontratat dhe ndjekur procedurat e zbatimit.

Auditimi i procedurave të prokurimit u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion për auditim dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara (ku vlerën më të lartë e zë procedura tender i hapur (1)) në shumën 15,434,029 lekë me TVSH ose 30% e vlerës së kontratave të lidhura.

Tenderi me objekt **“Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”**, fitues oferta me vlerën më të ulët nga operatorët e mbetur në garë, me të dhënat:

Tabela nr. 67

Procedura e Prokurimit Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.196, Datë 24.06.2020	3.HDT/Njësia e prokurimit Urdhër nr.196, Datë 24.06.2020	4.KVO Urdhër nr.203, datë 02.07.2020:
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T.Hapur”.	M. A.-P/Sekt.Prok. F. V.-Specialist prok. G.L.-ing.ndërtimi	A. M. E. M. N. H.
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 21,325,600 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 12,861,691lekë	7.Diferenca me fondin limit 8,463,909 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 31.07.20202 (ndryshuar festë zyrtare) 03.08.2020	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës (31). "I."SHPK (fitues)

Burimi: Të dhënat AMLF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SEP)

Planifikimi i nevojave për prokurim

Me shkresën nr.8013, datë 03.12.2019 (urgjente) është kërkuar nga Instituti i Ndërtimit të kryhet ekspertiza dhe vlerësimi konstruktiv i godinës së MD, si pasojë e dëmtimeve të krijuara nga goditjet e tërmetit datë 26.11.2019, me qëllim planifikimin e nevojave për prokurim.

Përmes memo nr. 3822 prot., datë 22.06.2020 drejtuar ish Sekretarit të Përgjithshëm z. G. D., kërkohet miratimi për zhvillimin e procedurës së tenderimit me objekt “Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”, pasi nga grupet e kontrollit të Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisë Tiranë janë konstatuar dëmtime nga tërmeti i datës 26.11.2019. Raporti mbi vlerësimin e aftësisë mbajtëse strukturore të objektit ekzistues, projekti konstruktiv si dhe preventivi me vlerë 21,325,600 lekë pa TVSH, janë përcjellë në MD për miratim.

Me shkresën 3823/2, datë 25.6.2020 Ministria i është drejtuar Institutit të Ndërtimit ku kërkon miratimin e projektit të paraqitur nga grupi i ekspertëve përcjellë me shkresën nr. 8013/1, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

03.12.2019. Me shkresën nr. 1453/1, datë 26.06.2020 Instituti i Ndërtimit ka dhënë miratimin e projektit duke vënë në dukje se përgjegjësia për projektin është e autorëve/grupit të projektuesve. Pas miratimit të projektit nga Instituti i Ndërtimit, titullari i AK/ish Sekretari i Përgjithshëm ka dhënë miratimin për fillimin e procedurës së tenderimit.

Nxjerrja e urdhër prokurimit

Në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 60, si dhe Memo nr. 3822 prot., datë 22.06.2020 nga titullari i AK ish Sekretari i Përgjithshëm, është nxjerrë Urdhër Prokurimi nr.196, datë 24.06.2020 për zhvillim e procedurës së prokurimit “Tender i Hapur” me objekt “Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”, me fond limit 21,325,600 lekë, në të cilin është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim

Njësia e prokurimit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka hartuar DT/ kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Vlerësimi i Ofertave

Në hapjen publike të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit (SEP) rezultoi të kenë shpallur interes dhe paraqitur oferta 31 OE. Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ-ligjor rezultoi të jenë renditur 21 OE të kualifikuar. Nga KVO është bërë llogaritja e ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 66, pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku rezultoi se 4 OE nga 21 të kualifikuar kanë paraqitur oferta anomalisht të ulëta. KVO në përputhje me nenin 56 të ligjit u bëri njoftimin në format fizik (shkresë) dhe në format elektronik (në SEP) për të sjellë shpjegime mbi ofertat e tyre, nga të cilët 3OE sollën shpjegime ndërsa operatori “V.” SHPK nuk solli as në format fizik dhe as në format elektronik shpjegime brenda afatit ligjor. Në përfundim KVO vendosi t’i kualifikojë sipas renditjes më poshtë:

Tabela nr. 68

në lekë

I.” SHPK	12,861,691
O.B.K. SHPK&E.SHPK	12,999,900
S. SHPK	13,835,915
N. SHPK	14,067,219
M. SHPK&XH. SHPK	14,478,761.6
B. SHPK	14,935,086.5
K. . SHPK	15,487,629 pas korigjimit
S.. SHPK	15,735,388
B. SHPK	15,956,190 pas korigjimit
F. SHPK	16,642,394
J. SHPK	16,663,466
I. SHPK	16,983,708.7
L.SHPK	17,058,879.4
S.. SHPK	17,342,080
L.SHPK	17,465,122
A.SHPK	17,920,544



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

K. SHPK	18,053,077.5
LL. SHPK	18,959,255
A. .SHPK	19,887,978.46
D.SHPK	20,037,172

Në lidhje me kualifikimin e sipërm, pranë AK janë ankuar OE “I.” SHPK dhe “V.” SHPK me shkresat respektive nr.5261, datë 26.08.20220 (protokoll i MD) dhe 5314, datë 31.08.2020. OE “I.” SHPK ka kërkuar skualifikimin e OE “E.” SHPK me pretendimin se, ky operator nuk ka argumentuar çmimet e vendosura në ofertë në përputhje me nenin 56 të ligjit. Komisioni pas shqyrtimit të ankesës e mori në konsideratë atë dhe vendosi skualifikimin e OE “E.” SHPK. OE “V.” SHPK ka kërkuar kualifikimin e ofertës së saj ajo e cila ishte skualifikuar me pretendimin se, nuk ka paraqitur argument për ofertën e saj vlerësuar si anomalisht e ulët. Kërkesa u mor në shqyrtim nga grupi i caktuar për shqyrtimin e ankesës e cila nuk u mor në konsideratë me argumentin se nuk është paraqitur brenda afatit ligjor.

Lidhja e kontratës

Me OE “I.” SHPK me vlerë oferte më të ulët nga operatorët e mbetur në garë është lidhur kontrata nr. 5261/7, datë 02.10.2020 me vlerë 12,861,691 lekë pa TVSH/15,434,029 lekë me TVSH.

Mbi zbatimin e kontratës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *“Rehabilitimi emergjent i Godinës së Ministrisë së Drejtësisë ”* viti 2020, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 5261/7 prot., datë 02.10.2020, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Drejtësisë dhe operatorit ekonomik “I.” shpk. Vlera e kontratës është 12,861,691 lekë pa TVSH ose 15,434,029 lekë me TVSH. Nga verifikimi i strukturës së preventivit, pagesës në situacionin përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në objekt u konstatua pasaktësi. Me kërkesën për propozim të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit Pa Prot., datë 07.12.2020, paraqitet analizë teknike e zërit të paparashikuar në preventiv me nr. Analize 2.334 *“Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”*. Çmimi i këtij zëri është paraqitur sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*. Me procesverbalin e negocimit të zërit të ri datë 10.12.2020, mbas konsultimeve të realizuara nga palët u miratua çmimi prej 645 lekë/m². Referuar situacionit përfundimtar dhe analizës së çmimit për suvatimin e jashtëm mbi 8 m, konstatohet se në kapitullin e punimeve të skelerisë dhe kallëpi, zëri nr. 2 me nr. Analize 2.431 *“Skelë metalike me tubo fasade >12 m”* në sasinë prej 1,608 m², me çmimin përkatës prej 90 lekë/m² është zë pune i mbivendosur zërit nr. 2.334 *“Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”*, pasi përfshihet në strukturën e çmimit. Rrjedhimit vlera prej 144,720 lekë, e likuiduar në zërin *“Skelë metalike me tubo fasade >12 m’*, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Në kapitullin e punime shtresash, zëri nr. 9, me nr. Analize 2.276 *“Shtresë parketi”*. Sasia për *“shtresë parketi”* është paguar në situacion në sasinë 29.8 m², me çmimin prej 6,550 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 29.8 m², në ambientet e katit dytë zyra 8 dhe zyra 9. Nga verifikimi në këto ambinate konstatohet se këto sipërfaqe nuk janë realizuar me shtresë parketi por me shtresë parketi laminat, me çmimin përkatës prej 1,650 lekë/m². Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar diferencë çmimi prej 4,900 lekë/ m² (6,550 lekë/m² - 1,650 lekë/m²). Vlera e diferencë e përfituar



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

më tepër rezulton $4,900 \text{ lekë/m}^2 \times \text{sasinë } 29.8 \text{ m}^2 = 146,020 \text{ lekë}$. Në kapitullin e punimeve tavani, suvatimi dhe veshje, zëri nr. 1, me nr. Analize 2.3 “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*”. Sasia për “Suvatimit të tavanit” është paguar në situacion në sasinë 645 m^2 , me cmimin prej 650 lekë/m^2 . Në librezën e masave sasia është pasqyruar 645 m^2 , në nga ambientet e katit I deri të katit XI. Nga verifikimi në disa ambinete të MD zyra dhe shesh pushime, konstatohet se nuk janë realizuar suvatime të tavanit, por vetëm tavane të varur me pllaka gipsi 60×60 dhe tavane karton xhes. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin e punimit “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*” në vlerën 416,250 lekë. Si përfundim, për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 706,990 lekë pa TVSH ($416,250 + 146,020 + 144,720$) ose **848,388 lekë me TVSH**, e përfituar nga sipërmarrësi “I.” shpk, për zëra të parealizuar.

Tenderi me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve”, shtesë kontrate (20% e vlerës kontratës fillestare), me fond limit 172,265 lekë pa TVSH.

Kontrata nr.3849, datë 07.05.2019 e lidhur nga MD me OE “A.” SHPK për riparim dhe mirëmbajtje automjeteve ka përfunduar në datë 31.12.2019 dhe në zbatim të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 76, pika 4, ka lidhur pas përfundimit të afatit të kontratës së fundit, kontratë shtesë me të njëjtin kontraktues, deri sa të kryheshin procedurat e prokurimit. Argumentimi i bërë nga AK është bazuar në vonesën deri me datë 28.01.2020 nga Ministria e Brendshme/Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara të dërgimit të autorizimit për lidhje kontrate për realizimin e shërbimit të riparimit të automjeteve të MD nga ABP. Meqënëse këto mjete duhet të jenë në gadishmëri, deri në dërgimin e autorizimit nga ABP bëhet shtesa e kontratës. Gjithashtu fondi limit për shtesë kontrate është parashikuar dhe në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2020 në vlerën 172,300 lekë pa TVSH sikurse përcakton VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 76, pika 4.

Pasi është bërë argumentimi i fondit limit dhe argumentuar arsyet për lidhjen e shtesës së kontratës ka dalë Urdhër Prokurimi nr. 43, datë 04.02.2020 për lidhje kontrate shtesë, për të cilën është likuiduar operatori në fund të kryerjes së shërbimit.

AK/MD ka përdorur si procedurë të thjeshtuar “*sistemin dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar*”, (gjithsej 7 procedura) përdorimi i të cilit për këtë vit është i kufizuar për shkak të situatës COVID 19, ku vlera e përlogaritur e fondit limit është 669,700 lekë pa TVSH dhe vlera e kontratave të realizuara është 476,402 lekë pa TVSH (përfshirë nga TVSH në bazë të ligjit).

Për vitin 2020, nga auditimi në mënyrë të plotë i procedurave me “*sistemin dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” të trajtuara me të dhënat më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

☞ Në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik, titullari i Autoritetit Kontraktor/MD ka ngritur Komisionin e sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar me Urdhërin nr.2, datë 07.01.2020 bazuar në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar.

☒ Në të gjitha rastet e audituara është shpallur fitues operatori ekonomik me vlerën më të ulët të ofertuar.

☒ Praktikave të procedurave të audituara kanë bashkëngjitur, konfirmimin e ministrit për pjesëmarrje në event/takim në ato raste kur kërkohet ky miratim, autorizimin për shërbim jashtë vendit të stafit shoqëruar të ministrit referuar ftesës për zhvillimin e eventit/takimit me axhenden përkatëse. Pas miratimit nga ish Sekretari i Përgjithshëm i kërkesës së Drejtorisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për miratim shpenzime për blerje biletë udhëtimi, si dhe miratimit të procedurës së prokurimit në zbatim të Udhëzimit të APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar është bërë testimi i tregut dhe llogaritja e fondit limit nga Komisioni dhe pastaj ka dalë Urdhër Prokurimi nga titullari i AK dhe është bërë publikimi i ftesës për ofertë. Komisioni ka bërë në sistem shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të OE që kanë shfaqur interes në publikimin zyrtar.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Bari –Tiranë (copë 3)”

Urdhër Prokurimi nr.288, datë 28.08.2020, data e tenderit 28.08.2020, fond limit 207,156 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “A.” me vlerë 149,000 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 5 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Romë (Itali) –Tiranë (copë 3)”

Urdhër Prokurimi nr.38, datë 30.01.2020, data e tenderit 30.01.2020, fond limit 76,742 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “A.” me vlerë 63,000 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 6 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Romë (Itali) –Tiranë (copë 1)”

Urdhër Prokurimi nr.3, datë 07.01.2020, data e tenderit 07.01.2020, fond limit 56,834 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “O.” me vlerë 47,000 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 6 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Romë (Itali) –Tiranë (copë 1)”

Urdhër Prokurimi nr.329, datë 05.10.2020, data e tenderit 06.10.2020, fond limit 70,853 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “K.” me vlerë 65,755 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 4 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Romë (Itali) –Tiranë (copë 1)”

Urdhër Prokurimi nr.312, datë 21.09.2020, data e tenderit 21.09.2020, fond limit 37,494 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “K.” me vlerë 25,233 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 7 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Berlin –Tiranë (copë 1)”

Urdhër Prokurimi nr.35, datë 27.01.2020, data e tenderit 27.01.2020, fond limit 42,846 lekë pa TVSH, kualifikuar në vend të parë oferta OE “A.” me vlerë 33,500 lekë pa TVSH, vlera më e ulët, pjesëmarrës në tender 7 OE. Operatori fitues nuk është paraqitur për të lidhur kontratën brenda afatit dhe në këto kushte është vijuar me operatorin e radhës i cili dhe ky nuk është paraqitur për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

lidhjen e kontratës. OE në vijim janë tërhequr me pretendimin e ndryshimit të çmimit. Ndodhur në këto kushte, procedura është anuluar dhe njoftuar në sistem.

Komisioni me memo datë 28.01.2020 i është drejtuar ish Sekretarit të Përgjithshëm për rihvillimin e procedurës por duke argumentuar dhe ndryshimin e fondit limit me arsyetimin e lëvizjes së çmimeve duke e përllogaritur në vlerën 159,758 lekë pa TVSH dhe data e zhvillimit të tenderit është 28.01.2020. Nga klasifikimi i ofertave ku janë pjesëmarrës 4 OE, fituese shpallet oferta e OE “K. T.” me vlerë 112.179 lekë pa TVSH. Likujduar OE në vlerën 76,235 lekë pa TVSH për shkak të anulimit të pjesëmarrjes në takim duke iu rimbursuar znj. F. C./zv.ministër vlera e taksave aeroportuale në shumën 293.57eur. ose 35,854 lekë referuar kursit të këmbit në atë datë.

Për procedurën e prokurimit në objekt: **“Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë”**, viti 2020, konstatohet:

Tabela nr. 69 A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë ”,			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Shërbim konsulence” REF-72259-09-18-2020 Urdhri nr 308 datë 16.09.2020	2 Njësia e Prokurimit M. A. F. V. G.L.	3.1 Komisioni i Vlerësimit Ofertave 317/1 prot. Datë 28.09.2020 E. M., A. S., M. P., Gj. Xh. A. K.	
4. Fondi Limit (pa tvsh) Sipas VKM 354 datë 11.05.2016, neni 29 e llogaritur: Min 8,214,285 pa TVSH Max 9,583,333 pa TVSH	5. Oferta fituese (pa tvsh) 8,214,825 lekë BOE “D.” shpk & “N.” shpk		
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 22.10.2020	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9.1 Operoret Ekonomike Faza I a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE	9.2 Operoret Ekonomike Faza II a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
7/2 Kohezgjatja e kontrates, 3 muaj ditë			

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me memon nr. 5202/2 prot., datë 16.09.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, përllogaritet vlera maksimale dhe minimale të shërbimit për objektin “Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë”. Përllogaritet bazohen në VKM 354 datë 11.05.2016 “Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” neni 29, 24 dhe 25 “Grupet tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale III”. Me urdhërin e prokurimit nr. 308 datë 16.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ngrihet njësi e prokurimit i përbërë nga M. A. (Përgjegjse sektori i prokurimeve), F.V.(Specialist prokurimeve) dhe G. L. (Inxh ndërtimi). Me rralacionin datë 18.09.2020, të specialistit të fushës Inxh. G. L., janë përcaktuar kërkesat kualifikuese teknike, për licensat profesionale, stafin kryesor dhe mbështetës. Me procesverbalin e datës 18.09.2020, miratohen nga anëtarët e njësisë së prokurimit kriteret e përgjithshme dhe të vecanta kualifikuese. *Mbi vlerësimin e ofertave Faza II.* Me procesverbalin e datës 16.12.2020 të Fazës 2 “Paraqitja e Propozimeve”. Me shkresën nr. 6902/6 prot., datë 16.12.2020, njoftohet klasifikimi i ofertave dhe me nr. 6902/7 prot., datë 16.12.2020 miratohet raporti përmbledhës nga titullari. Formulari i njoftimit të fituesit është realizuar me nr. 6902/8 prot., datë 16.12.2020 dhe kontrata e shërbimit realizohet me nr. 8030 prot., datë 29.12.2020.

Për vitin 2020, auditimi i procedurave të prokurimit “**blerje me vlerë të vogël**”, u bazua në vlerësimin e riskut duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara.

Nga auditimi i këtyre procedurave trajtuar me të dhënat si më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

☞ Fitues shpallet oferta me vlerën më të ulët paraqitur nga operatorët e ekonomikë.

☞ Në shumicën e rasteve të audituara (6) u konstatua tërheqje e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues me vlerën më të ulët e për pasojë kontrata është lidhur me operatorin e renditur pas tij, konform legjislacionit për prokurimin publik.

☞ Procedura e prokurimit fillon me argumentimin e blerjes/shërbimit të kërkuar nga Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila i referohet në çdo rast akt konstatimit përkatës mbi gjëndjen fizike për të kryer shërbimin apo nevojën për blerje, përmes memos drejtuar ish Sekretari i Përgjithshëm dhe miratuar prej tij.

☞ Komisioni i blerjeve i ngritur me Urdhër nr.1, datë 07.01.2020 të titullarit, argumenton llogaritjen e fondit limit bazuar në testimin e tregut/si/dhe/apo çmimet e unifikuara të dërguara nga ABP.

☞ Operatorët ekonomikë fitues në çdo rast kanë paraqitur dokumentacionin fizik pranë AK i cili pasi është verifikuar nga Komisioni me dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve (SEP) është bërë pjesë e dosjes së prokurimit.

☞ Me urdhër të titullarit AK në çdo rast është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

“Blerje karrige rrotulluese për rang drejtuesi” (copë 16).

Urdhër Prokurimi nr.367, datë 06.11.2020, fond limit 600,000 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 31 OE, fituese oferta OE “E.” me vlerë 288,000 lekë pa TVSH e cila nuk është paraqitur për lidhjen e kontratës dhe AK ka kërkuar të lidhë kontratën me operatorët e tjerë sipas renditjes së bërë në sistem. Operatorët e renditur deri në vend të nëntë janë tërhequr nga lidhja e kontratës duke shprehur arsye të ndryshme. OE “M.” i renditur në vend të dhjetë me vlerë oferte 556,480 lekë pa TVSH/667,776 me TVSH ka shprehur interesin për realizimin e kontratës i cili pas furnizimit me mallin e kërkuar është likuiduar në zbatim të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

“Riparim mirëmbajtje sistemi ngrohje ftohje dhe ventilimi”.

Urdhër Prokurimi nr.67, datë 19.02.2020, fond limit 792,530 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 7 OE, fituese oferta OE “K.” me vlerë më të ulët të ofertuar 480,000 lekë pa TVSH/576,000 lekë me TVSH. Me Urdhërin nr.79, datë 26.02.2020 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. OE është likujduar në zbatim të kontratës.

“Shërbim riparim automjete”.

Urdhër Prokurimi nr.183, datë 16.06.2020, fond limit 800,000 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 12 OE, fituese oferta OE “S.” me vlerë ofertuar 683,400 lekë pa TVSH/820,080 lekë me TVSH. OE “A.” klasifikuar në vend të parë me vlerë më të ulët ofertës 640,000 lekë pa TVSH është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “nuk mund t’i qëndrojë korrekt afateve të caktuara”.

Me Urdhërin nr.185 datë 19.06.2020 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje kondicionerë”.

Urdhër Prokurimi nr.382, datë 12.11.2020, fond limit 454,167 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 32 OE. OE klasifikuar në vend të parë “A.” me vlerë 295,000 pa TVSH

është tërhequr nga lidhja e kontratës me argumentin se “shpenzimet tekalojnë përlllogaritjet tona për këtë ofertë”.Komisioni ka kaluar sipas renditjes tek operatori i radhës për lidhje kontrate, nga ku deri te operatori i renditur në vend të dhjetë janë tërhequr nga lidhja e kontratës me argumente të ndryshme. Lidhja e kontratës është bërë me OE “A.” me vlerë 408,890 lekë pa TVSH/490,668 me TVSH, që ka shprehur interesin për realizimin e kontratës dhe është likujduar në zbatim të kontratës Me Urdhërin nr.429/1, datë 12.06.2020 është ngritur grupi i punës . për marrjen në dorëzim të mallit.

“Materiale pastrimi”.

Urdhër Prokurimi nr.160, datë 05.06.2020, fond limit 270,000 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 28 OE. Nga klasifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve (SEP) rezulton se janë klasifikuar në vend të parë 2 oferta me vlerë të njëjtë OE “T.” dhe “J.” me vlerë të ofertuar 175,000 lekë pa TVSH. Në këto kushte në zbatim të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018, Komisioni ka dërguar mesazh operatorëve për hedhje shorti të cilët nuk u paraqitën në datën dhe orën e përcaktuar. Komisioni vijoi me hedhje shorti nga ku në fund të procesit rezultoi se renditet në vend të parë OE “T.”, i cili është ftuar për lidhjen e kontratës. Operatori ka njoftuar për tërheqjen nga lidhja e kontratës. Rezulton gjithashtu se të gjithë operatorët e renditur më pas deri në vend të dhjetë janë tërhequr. Në këto kushte procedura është anuluar, duke u njoftuar operatorët. Pas miratimit nga titullari i AK për rizhvillimin e procedurës së tenderimit është publikuar ftesa për ofertë dhe rizhvilluar procedura me datë 29.06.2020.Në këtë procedurë morën pjesë 27 OE, nga të cilët operatorët e renditur nga vendi parë (me vlerë oferte 215,000 lekë pa TVSH e OE A..”) deri në të vend të katërt u tërhoqën nga lidhja e kontratës.OE i renditur në vend të pestë “H.” me vlerë oferte 260,000 lekë pa TVSH/312,000 me TVSH ka shfaqur interesin për lidhje kontrate me të cilin dhe është lidhur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Me Urdhërin nr.429/1, datë 12.06.2020 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës (marrjen në dorëzim të mallit). Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Materiale pastrimi”.

Urdhër Prokurimi nr.54 datë 13.02.2020, fond limit 367,100lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 30 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “N.” renditur në vend të parë me vlerë oferte 244,000 lekë pa TVSH është tërhequr nga lidhja e kontratës dhe OE i renditur në vend të dytë “H.” me vlerë 287,000 lekë pa TVSH/344,400 lekë me TVSH ka shfaqur interesin për lidhjen e kontratës. Me Urdhërin nr.429, datë 21.01.2020 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës (marrjen në dorëzim të mallit). Likujduar OE në zbatim të kontratës.

Vitit 2021

Për vitin 2021, janë realizuar 125 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave të realizuara 97,717,735 lekë me TVSH dhe fond limit 84,606,284 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen më poshtë:

Tabela nr. 70

Në lekë

Numri proced.	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
1	Tender i Hapur	60,000,000	58,995,000	70,794,000
95	Blr.të vogël+nen 100.000 lekë	7,883,899	6,471,507	7,525,531
18	Marrëveshje kuadër/minikontratë	14,946,992	14,881,405	17,857,686
11	Sistem dinamik blerje	1,775,393	1,504,518	1,540,518/ përj. TVSH
125	Totali	84,606,284	81,888,430	97,717,735

Burimi: MD (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SEP)

Procedurat e prokurimit “marrëveshje kuadër/minikontratë” janë realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) si organ qëndror i blerjeve, në zbatim të VKM nr. 82, datë 14.2.2018 “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” i ndryshuar, ndërsa MD në zbatim të autorizimeve përkatëse lëshuar nga ABP ka lidhur kontratat dhe ndjekur procedurat e zbatimit.

Auditimi i procedurave të prokurimit u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara (ku vlerën më të lartë e zë procedura tender i hapur (1) me vlerë kontrate të lidhur 70,794,000 lekë me TVSH ose rreth 70% të vlerës së kontratave të lidhura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Tenderi me objekt **“Sistem i qëndëruar i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe brenda vendit”**, me fond limit 60,000,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate 70,794,000 lekë me TVSH.

Procedura e tenderimit dhe lidhja e kontratës është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Me shkresën nr.77 Prot., datë 07.01.2021 (protokolluar në MD nr.119, datë 08.01.2021) AK/AKSHI ka përcjellë kontratën nr.53, datë 06.01.2021 me object “Sistem i qëndëruar i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe brenda vendit”, lidhur në cilësinë e porositesit për llogari të Ministrisë së Drejtësisë me OE të shpallur fitues “B.” SHPK. Vlera e kontratës është 70,794,000 lekë me TVSH, e cila përfshin vlerën e implementimit prej 64,458,000 lekë me TVSH dhe vlerën e mirëmbajtjes prej 6,336,000 lekë me TVSH. Afati i kontratës është 3 muaj (për implementimin) nga momenti lidhjes së kontratës dhe afati për mirëmbajtje është 24 muaj nga momenti i lidhjes së kontratës.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nga ana e MD:

Referuar nenit 10, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

“në përfundim të çdo lëvrimit shërbimi/pune, por jo më vonë se 3 ditë nga data e çdo lëvrimit, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe përfituesit të shërbimit (përcaktuar në nenin 3.2.KVK) do të kryejnë pranimin e shërbimeve/punëve të kryera dhe të dorëzuara nga Kontraktuesi”, është marrë në dorëzim nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.16, datë 12.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t në përbërje të cilat janë 2 specialistë IT pranë aparatit të MD, me Akt-Marrjen në dorëzim nr.1094/5 (protokoll i AKSHI-t), datë 02.03.2021, këto pajisje:

-“server Fujitsu Rx2530m5” copë 2(dy), në vlerën 1,600,000 lekë pa TVSH,

-“storage Fujitsu ETERNUS DX200S5”, copë 1(një) në vlerën 2,700,000 lekë pa TVSH,

në total në vlerën 5,160,000 lekë me TVSH, të cilat i janë likujduar Operatorit Ekonomik me Urdhër Shpenzimin nr.321, datë 20.04.2021.

Pas implementimit të sistemit (3 muaj), nga grupi i punës/AKSHI me Akt-marrje në dorëzim nr.2124/1, datë 06.04.2021 është marrë në dorëzim dhe verifikuar me dokumentacionin përkatës sipas kushteve të ofertës teknike, kryerja e shërbimit që përfshin “ngritjen e sistemit” copë 1(një), në vlerën 28,900,000 lekë pa TVSH, “importimi i të dhënave” copë 2(dy), në vlerën 20,000,000 lekë pa TVSH dhe “trajnime” 5(pesë) ditë, në vlerën 515,000 lekë pa TVSH, gjithsej 59,298,000 lekë me TVSH.

Trainimi i stafit për përdorimin e sistemit është kryer kundrejt pjesëmarrjes të të trainuarve nga MD të konfirmuar me procesverbalet respective datë 30.03.2021, 02.04.2021, 01.04.2021 dhe datë 05.04.2021, me qëllim përdorimin efektiv të sistemit.

Shërbimi i mirëmbajtjes 24 muaj nga lidhja e kontratës (06.01.2021) është kryer kundrejt monitorimit të bërë nga grupi i punës me përfaqësues të AKSHI-t për llogari dhe pranë MD si dhe nga përfaqësues të OE “B.” SHPK. Për çdo cikël shërbimesh dhe mirëmbajtje janë mbajtur procesverbale dhe raportet e mirëmbajtjes sipas periudhave respektive duke filluar që nga data 22.06.2021 dhe deri me datë 11.05.2023 (të audituar deri në këtë fazë) të cilat llogariten në vlerën 5,016,000 lekë me TVSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Për vitin 2021, AK/MD ka përdorur si procedurë të thjeshtuar “*sistemin dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar*”, (gjithsej 11 procedura), ku vlera e përlllogaritur e fondit limit është 1,775,393 lekë pa TVSH dhe vlera e kontratave të realizuara është 1,540,518 lekë pa TVSH (përfshirë nga TVSH në bazë të ligjit).

Në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik, titullari i Autoritetit Kontraktor/MD, ka ngritur Komisionin e sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar me Urdhërin nr.352, datë 27.05.2021 dhe nr. 632, datë 12.11.2021 bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar.

Nga auditimi i procedurave me të dhënat si më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik, me përjashtim të 1(një) rasti në tenderin me objekt “Blerje bileta avioni Tiranë-Neë York–Tiranë (copë 3)” i cili nuk është fenomen i përhapur që të përbëjë shmangie nga procedurat e prokurimit dhe të ndikojë në rezultatin final, ku është vendosur një kriter i cili minimizon pjesëmarrjen e operatorëve në tender.

☞ Në të gjitha rastet e audituara është shpallur fitues operatori ekonomik me vlerën më të ulët të ofertuar.

☞ Në shumicën e rasteve vihet re tërheqje e OE të klasifikuar në vend të pare, në fazën e lidhjes së kontratës, e për pasojë kontrata është lidhur me operatorin e renditur pas tij, konform legjilacionit për prokurimin publik.

☞ Praktikata e procedurave të audituara kanë bashkëngjitur, autorizimin për shërbim jashtë vendit të stafit shoqëruës të ministrit referuar ftesës për zhvillimin e eventit/takimit me axhenden përkatëse. Pas miratimit nga ish Sekretari i Përgjithshëm i kërkesës së Drejtorisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për miratim shpenzime për blerje biletë udhëtimi, si dhe miratimit të procedurës së prokurimit në zbatim të Udhëzimit të APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar është bërë testimi i tregut dhe llogaritja e fondit limit nga Komisioni, duke nxjerrë më pas Urdhër Prokurimit nga titullari AK dhe publikimin e Ftesës për ofertë. Komisioni ka bërë në sistem shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të OE që kanë shfaqur interes në publikimin zyrtar duke lidhur kontratë me OE fitues. Bashkëngjitur praktikës mungon konfirmimi i ministrit për pjesëmarrje në event/takim në ato raste kur kërkohet ky miratim.

“Blerje bileta avioni Tiranë- New York–Tiranë (copë 3)”

Urdhër Prokurimi nr.353, datë 27.05.2021, data e tenderit 27.05.2021, fond limit 512,668 lekë pa TVSH, fituese oferta OE “O.” me vlerë 474,700 lekë pa TVSH. Oferta e OE “L.I” klasifikuar në vend të parë me vlerë më të ulët 358,401 lekë pa TVSH është tërhequr nga lidhja e kontratës duke vazhduar procedura me operatorin e renditur në vend të dytë. Pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

“Blerje bileta avioni Tiranë- Londër–Tiranë (copë 4)”

Urdhër Prokurimi nr.412, datë 21.07.2021, data e tenderit 22.07.2021, fond limit 519,779-lekë pa TVSH, 2-operatorët pjesëmarrës u tërhoqën nga lidhja e kontratës dhe tenderi është anuluar duke kërkuar miratimin për rizhvim të tenderit.

Në tenderin e rizhvuilluar morën pjesë 5 OE dhe në vend të parë është klasifikuar oferta OE “L.” me vlerë më të ulët 440,000 lekë pa TVSH Pjesëmarrës në tender 5 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Lubjanë–Tiranë (copë 2)”

Urdhër Prokurimi nr.650, datë 26.11.2021, data e tenderit 26.11.2021, fond limit 194,060-lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë oferta e OE “K.” me vlerë 91,012 lekë pa TVSH e cila është tërhequr nga lidhja e kontratës. Procedura ka vazhduar duke ftuar për lidhje kontrate OE renditur në vend të dytë “S” me vlerë oferte 145,750 lekë. Pjesëmarrës në tender 5 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Venecia–Tiranë (copë 3)”

Urdhër Prokurimi nr.665, datë 07.12.2021, data e tenderit 07.12.2021, fond limit 163,274-lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë oferta e OE “S.” me vlerë 49,446 lekë pa TVSH e cila është tërhequr nga lidhja e kontratës. Procedura ka vazhduar duke ftuar për lidhje kontrate OE renditur në vend të dytë “D.” me vlerë oferte 139,113 lekë pa TVSH. Pjesëmarrës në tender 4 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

Për vitin 2021, auditimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, u bazua në vlerësimin e riskut duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara.

Nga auditimi i këtyre procedurave trajtuar me të dhënat si më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

☞ Fitues shpallet oferta me vlerën më të ulët paraqitur nga operatorët ekonomikë.

☞ Në shumicën e rasteve të audituara u konstatua tërheqje në fazën e lidhjes së kontratës nga operatorët ekonomikë të klasifikuar dhe shpallur fitues e për pasojë kontrata është lidhur me operatorin e renditur pas tij, konform legjilacionit për prokurimin publik.

☞ Procedura e prokurimit fillon pas argumentimit të blerjes/shërbimit të kërkuar nga Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila i referohet në çdo rast akt konstatimit përkatës mbi gjëndjen fizike për të kryer shërbimin apo nevojën për blerje, përmes memos drejtuar ish Sekretari i Përgjithshëm dhe miratuar prej tij.

☞ Komisioni i blerjeve i ngritur me urdhër të titullarit argumenton llogaritjen e fondit limit bazuar në testimin e tregut/si/dhe/apo çmimet e unifikuara të dërguara nga ABP.

☞ Operatorët ekonomikë fitues në çdo rast kanë paraqitur dokumentacionin fizik pranë AK i cili pasi është verifikuar nga Komisioni me dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve (SEP) është bërë pjesë e dosjes së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Me urdhër të titullarit AK në çdo rast është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

“Blerje tonera për fotokopje dhe printera”.

Urdhër Prokurimi nr.55 datë 25.02.2021, fond limit 783,982-lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 26 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “I.” renditur në vend të parë me vlerë oferte më të ulët 179,000 lekë pa TVSH është tërhequr nga lidhja e kontratës deri tek OE renditur në vend të katërt. OE i renditur në vend të pestë “I.” me vlerë 455,000 lekë pa TVSH/546,000 lekë me TVSH ka shfaqur interesin për lidhjen e kontratës. Me Urdhërin Nr.9, datë 07.02.2021 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës (marrjen në dorëzim të mallit). Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Shërbim mirëmbajtje ashensori”.

Urdhër Prokurimi nr.62 datë 09.02.2021, fond limit 447,500-lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 7 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “K.” është renditur në vend të parë me vlerë oferte më të ulët 320,000 lekë pa TVSH/384,000 lekë me TVSH me të cilin është lidhur kontrata. Me Urdhërin nr.83, datë 19.02.2021 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Riparim mirëmbajtje sistemi ngrohje-ftohje dhe ventilimi”.

Urdhër Prokurimi nr.85 datë 22.02.2021, fond limit 598,650-lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 10 OE. Me OE “K.” renditur në vend të tretë me vlerë oferte 460 lekë pa TVSH/552,000 lekë me TVSH me të cilin është lidhur kontrata. Me Urdhërin nr.132, datë 09.03.2021 të ish titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Likujduar OE në zbatim të kontratës.

Viti 2022

Për vitin 2022, janë realizuar 134 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave të realizuara 94,633,966 lekë me TVSH dhe fond limit 85,042,677 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen më poshtë:

Tabela nr. 71

Numri proced.	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Në lekë	
			Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
2	Tender i Hapur	57,125,012	53,898,681	64,678,417
99	Blr. me vlerë të vogël+blr. 100.000 lekë	10,562,451	8,936,233	10,396,546
14	Marrëveshje kuadër/minikontratë	14,340,401	14,232,946	17,079,535
19	Sistem dinamik blerje	3,014,813	2,479,467	2,479,467/ përj. TVSH
134	Totali	85,042,677	79,547,327	94,633,966

Burimi: MD (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SEP)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Procedurat e prokurimit “marrëveshje kuadër/minikontratë” janë realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) si organ qendror i blerjeve, në zbatim të VKM nr. 82, datë 14.2.2018 “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” i ndryshuar dhe VKM nr. 393, datë 09.06.2022 “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, ndërsa në MD në zbatim të autorizimeve përkatëse lëshuar nga ABP janë lidhur kontratat dhe ndjekur procedurat e zbatimit.

Auditimi i procedurave të prokurimit u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara (ku vlerën më të lartë e zë procedura tender i hapur (2) me vlerë kontrate të lidhur 64,678,417 lekë me TVSH ose rreth 70% të vlerës së kontratave të lidhura.

Tenderi me objekt **“Sistemi elektronik i menaxhimit të denoncimeve mbi rekordet korruptive”**, me fond limit 45,104,980 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate 50,878,417 lekë me TVSH.

Nisur nga nevoja e ngritjes së një sistemi me shtrirje në nivel qendror dhe rajonal mbi denoncimet që vinë në mënyrë shkresore apo dhe në rrugë elektronike (e-mail), ku mungesa e një sistemi të tillë krijon konfunzion në trajtimin e tyre në kohë, nga AKSHI është realizuar procedura e tenderimit me objekt “Sistemi elektronik i menaxhimit të denoncimeve mbi rekordet korruptive” si dhe lidhja e kontratës.

Kontrata nr.29 Prot., datë 09.09.2022 është dërguar në MD me qëllim zbatimin e saj. Referuar kontratës porosites është AKSHI, ofrues shërbimi BOE “i. & I.” dhe përfitues i shërbimit Ministria e Drejtësisë. Vlera e kontratës është 71,229,793 lekë me TVSH nga ku vlera e implementimit është 50,878,417.20 lekë me TVSH me afat 9 muaj nga lidhja e kontratës dhe vlera e mirëmbajtjes është 20,351,376 lekë me TVSH, me afat 24 muaj nga lidhja e kontratës.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nga ana e MD:

Me Urdhër nr.29/1, datë 14.09.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t znj.M. K. është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr.29 Prot., datë 09.09.2022.

Referuar kushteve të veçanta të kontratës (KVK), neni 8 “kushtet e pagesës”, është përcaktuar se “pagesa për fazën e implementimit do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të çdo fature tatimore përkatëse..” dhe në nenin 10 “pranimi i shërbimeve” është përcaktuar se “..në rastin e lëvrimit të mallrave, ditën e dorëzimit Kontraktuesi dorëzon tek ndjekësit e kontratës “Akt dorëzimit” faturën tatimore të mallrave si dhe dokumentacionin shoqërues...” dhe 10.2 “Pranimi i softëare do të kryhet nëpërmjet testeve të pranimit. Përfundimet e testeve të pranimit do të dokumentohen në formë të shkruar dhe do të nënshkruhen nga përfaqësuesi i AK dhe Kontraktuesi...”.

Në zbatim të detyrimit të sipërm kontraktor nga AKSHI me Aktmarrje në dorëzim datë 27.12.2022 janë marrë në dorëzim nga grupi i punës pajisjet “server” copë 2 (dy) në vlerën 3,395,040 lekë me TVSH e cila është likuajuar nga MD me Udhër –Shpenzimin nr. 1589, datë 28.12.2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjithashtu me Aktmarrje në dorëzim datë 28.12.2022 është marrë në dorëzim nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.29/1, datë 14.09.2022 zhvillimi i sistemit me vlerë 42,140,857.20 lekë me TVSH kundrejt testeve të bëra dhe raportit përfundimtar të mbajtur sipas detyruimeve kontraktore, i cili është likujduar me Urdhër –Shpenzimin nr.1583, datë 28.12.2022. Zbatimi i kësaj kontratë është në proces pasi pas implementimit fillon procesi i trainimit 2 ditë për përdorimin e sistemit si dhe shërbimi i mirëmbajtjes me afat 24 muaj nga lidhja e kontratës deri në likuidimin e plotë të vlerës.

Tenderi me objekt **“Furnizim dhe vendosje sistem ngrohje ftohje çiller, për godinën e MD”**, me të dhënat:

Tabela nr. 72

Furnizim dhe vendosje sistem ngrohje ftohje çiller, për godinën e MD		
1.Urdhër Prokurimit: nr.270, datë 14.06.2022	3. Grupi për specif.tek. dhe llog.f.limit Urdhër nr.238, Datë 27.05.202	4.KVO Urdhër nr.271, datë 14.06.2022:
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T.Hapur”.	A. K.-Spec.Ing. mekanik F. V.-Specialist prok. O.B. - Specialist prok.	E. M. E. M. G. L.
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 12,020,032 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 11,500,000	7.Diferenca me fondin limit 520,032 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 04.07.2022	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës (4). "G." (fitues)

Burimi: Të dhënat AMLF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SEP)

Planifikimi i nevojave për prokurim-Me Memo nr.2920, datë 20.05.2022 të Sektorit të Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm kërkesa për realizimin e prokurimit “Furnizim dhe vendosje sistem ngrohje ftohje çiller, për godinën e MD”, parashikuar dhe në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik me vlerë 12,500,000 lekë pa TVSH.

Llogaritja e fondit limit-Me Urdhërin nr.28, datë 27.05.2022 e titullarit të AK është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike. Me memo nr. 2920/4, datë 13.06.2022 dërguar Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK është përcjellë llogaritja e fondit limit sipas vlerave të dala pasqyruar në procesverbalin datë 09.06.2022. Llogaritja e fondit është bazuar në testimin e tregut duke ju dërguar ftesë 14 OE për të paraqitur ofertat e tyre në përgjigje të së cilës vetëm 3 OE paraqitën ofertat. Bazuar në çmimin mesatar referuar 3 ofertave fondi limit është përlllogaritur në vlerën 12.020,032 lekë pa TVSH. Gjithashtu janë hartuar specifikimet teknike nga specialisti i fushës trajtuar në relacionin teknik datë 03.06.2022.

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, nga titullari i AK/Sekretari i Përgjithshëm, është nxjerrë Urdhër Prokurimi nr.270, datë 14.06.2022 për zhvillim e procedurës së prokurimit “Tender



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

i Hapur” me objekt “Furnizim dhe vendosje sistem ngrohje ftohje ciller, për godinën e MD”, me fond limit 12,020,032 lekë pa TVSH, në të cilin është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim

Njësia e prokurimit në përputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 76, ka llogaritur fondin limit dhe hartuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Vlerësimi i Ofertave-KVO e ngritur me Urdhërin nr. 271, datë 14.06.2022 me datë 04.07.2022 ka bërë hapjen publike të ofertave në SPE.

Nga auditimi në SPE dhe dosje fizike të tenderit:

Kanë shpallur interes për pjesëmarrje në tender 4 OE me oferta si më poshtë:

-K., me vlerë 11,899,832 lekë pa TVSH

-G., me vlerë 11,500,000 lekë pa TVSH

-A., me vlerë 11,059,500 lekë pa TVSH

-L. S., që nuk ka ngrakuar ofertë në system (pa ofertë).

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave rezultojnë se OE “A.” me vlerën më të ulët është skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve (mungon autorizim prodhuesi dhe katalogu i pajisjeve është i papërkthyer dhe noterizuar. Gjithashtu dhe OE të tjerë janë skualifikuar për mospërmbushje të detyrimeve duke u shpallur në këtë mënyrë fitues oferta e “G.” me vlerë 11,500,000 lekë pa TVSH renditur në vend të dytë.

Lidhja e kontratës-Me OE fitues “G.”, me vlerë oferte është lidhur kontrata nr. 3431/10, datë 22.08.2022 me vlerë 13,800,000 lekë me TVSH. Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ka dalë Urdhëri nr.398, datë 22.08.2022 nga titullari i AK për ngritjen e grupit të punës. Me procesverbalin datë 28.12.2022 është marrë në dorëzim instalimi i pajisjeve duke kryer testet e nevojshme për vënien në punë dhe likujduar operatori për shërbimin e kryer. Gjithashtu me shkresën nr.238, datë 13.01.2023 është dërguar pranë APP Raporti përmbledhës i zbatimit të kontratës si dhe formulari i raportimit për zbatimin e kontratës.

Për vitin 2022, nga auditimi në mënyrë të plotë i procedurave me “**sistemin dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar**” të trajtuara me të dhënat më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

☞ Në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik, titullari i Autoritetit Kontraktor/MD, ka ngritur Komisionin e sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar me Urdhërin nr.13, datë 17.01.2022 bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimit të APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar dhe Udhëzimit të APP nr.3, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

☞ Në të gjitha rastet e audituara është shpallur fitues operatori ekonomik me vlerën më të ulët të ofertuar.

☞ Praktikata e procedurave të audituara kanë bashkëngjitur, konfirmimin e ministrit për pjesëmarrje në event/takim në ato raste kur kërkohet ky miratim, autorizimin për shërbim jashtë vendit të stafit shoqëruar të ministrit referuar ftesës për zhvillimin e eventit/takimit me axhenden përkatëse. Pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i kërkesës së Drejtorisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për miratim shpenzime për blerje biletë udhëtimi, si dhe miratimit të procedurës së prokurimit në zbatim të Udhëzimit të APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar është bërë testimi i tregut dhe llogaritja e fondit limit nga Komisioni dhe më pas është nxjerrë Urdhër Prokurimi nga titullari i AK dhe bërë publikimi i ftesës për ofertë. Komisioni ka bërë në sistem shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të OE që kanë shfaqur interes në publikimin zyrtar.

“Blerje bileta avioni Tiranë-Washington D.C.-Tiranë (copë 2)”

Urdhër Prokurimi nr.568, datë 19.10.2022, data e tenderit 19.10.2022, fond limit 424,962 lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë oferta e OE “O.” me vlerë 220,100 lekë pa TVSH i cili është tërhequr nga lidhja e ofertës duke vazhduar procedura me operatorin e radhës. Kontrata është lidhur me OE “A.” me vlerë 349,500 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 3 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Bruksel-Tiranë (copë 5)”

Urdhër Prokurimi nr.568, datë 19.10.2022, data e tenderit 14.09.2022, fond limit 190,605 lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë dhe shpallur fitues oferta e OE “O.” me vlerë 181,000 lekë pa TVSH me vlerën më të ulët, pjesëmarrës në tender 4 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës. “Blerje bileta avioni Tiranë- Vienë-Tiranë dhe Frankfurt-Vienë (copë 2)”

Urdhër Prokurimi nr.202, datë 11.05.2022, data e tenderit 11.05.2022, fond limit 203,636 lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë dhe shpallur fitues oferta e OE “A.” me vlerë 167,995 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 1 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Paris-Tiranë (copë 2)”

Urdhër Prokurimi nr.173, datë 29.04.2022, data e tenderit 29.04.2022, fond limit 177,025 lekë pa TVSH, klasifikuar në vend të parë dhe shpallur fitues oferta e OE “D.” me vlerë 134,860 lekë pa TVSH me vlerën më të ulët, pjesëmarrës në tender 2 OE, likujduar OE në zbatim të kontratës.

Për vitin 2022, auditimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, u bazua në vlerësimin e riskut duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara.

Nga auditimi i këtyre procedurave trajtuar me të dhënat si më poshtë, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

☞ Fitues shpallet oferta me vlerën më të ulët të operatorëve ekonomikë të klasifikuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

☞ Në shumicën e rasteve të audituara u konstatua tërheqje në dazën e lidhjes së kontratës nga operatorët ekonomikë të shpallur fitues e për pasojë kontrata është lidhur me operatorin e renditur pas tij, konform legjilascionit për prokurimin publik.

☞ Procedura e prokurimit fillon pas argumentimit të blerjes/shërbimit të kërkuar nga Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila i referohet në çdo rast akt konstatimit përkatës mbi gjëndjen fizike për të kryer shërbimin apo nevojën për blerje, përmes memos drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe miratuar prej tij.

☞ Komisioni i blerjeve i ngritur me urdhër të titullarit argumenton llogaritjen e fondit limit bazuar në testimin e tregut/si/dhe/apo çmimet e unifikuara të dërguara nga ABP.

☞ Operatorët ekonomikë fitues në çdo rast kanë paraqitur dokumentacionin fizik pranë AK i cili pasi është verifikuar nga Komisioni me dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve (SEP) është bërë pjesë e dosjes së prokurimit.

☞ Me urdhër të titullarit AK në çdo rast është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

“Riparim mirëmbajtje Sistemi ngrohje-ftohje ventilimi”.

Urdhër Prokurimi nr.366 datë 18.02.2022, fond limit 499,610lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 6 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “X.” renditur në vend të parë me vlerë oferte më të ulët 422,300 lekë pa TVSH është tërhequr nga lidhja e kontratës po kështu dhe operatori i renditur pas tij. OE i renditur në vend të pestë “K.” me vlerë 490,000 lekë pa TVSH/588,000 lekë me TVSH ka shfaqur interesin për lidhjen e kontratës. Me Urdhërin nr.3770/5, datë 01.08.2022 të titullarit të AK është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës (marrjen në dorëzim të shërbimit). Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Siguracion Godine”.

Urdhër Prokurimi nr.612 datë 21.11.2022, fond limit 610,694lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 2 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “I.” me vlerë oferte 600,000 lekë me TVSH është klasifikuar në vend të parë me të cilin është lidhur kontrata. Me procesverbalin datë 23.11.2022 është marrë në dorëzim shërbimi nga grupi i punës. Likujduar OE në zbatim të kontratës.

“Rikompozim ambienti zyre dhe përshtatje salla e mbledhjeve”.

Urdhër Prokurimi nr.73 datë 18.02.2022, fond limit 593,318lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 17 OE. Nga klasifikimi në SEP rezulton se OE “A.” me vlerë oferte 347,000 lekë pa TVSH është klasifikuar në vend të parë, i cili në fazën e lidhjes së kontratës është tërhequr duke kaluar tek operatori i renditur në vend të dytë “4 .” me vlerë oferte 348,000 lekë pa TVSH/417,600 lekë me TVSH me të cilin është lidhur kontrata. Me Urdhërin nr.112, datë 29.03.2022 të titullarit të AK është emëruar mbikqyrësi i punimeve dhe me Urdhërin nr. 113, datë 29.03.2022 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Likujduar OE në zbatim të kontratës.

Konkluzion:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2020-2022 i cili u bazua në vlerësimin e riskut duke përzgjedhur si kampion dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

nga numri total i procedurave të realizuara, nuk u konstatua asgjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik përveç sa më poshtë, që nuk përbën fenomen të përhapur që të sjellë shmangie nga procedurat e prokurimit dhe ndikojë në rezultatin final:

☞ Për vitin 2020, në procedurat blerje me vlerë të vogël për grup artikujt “materiale pastrimi” AK nuk ka prokuruar tërë mallin njëherësh por në mënyrë periodike sipas nevojave dhe kërkesës, pasi kapaciteti i magazinës është i vogël dhe nuk mundëson ruajtjen e mallit për një vit, por në asnjë rast nuk është kaluar kufiri monetar prej 800,000 lekë referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 40, pika 1.

☞ Për vitin 2021, në 1(një) rast në tenderin me object “Blerje bileta avioni Tiranë-Neë York–Tiranë (copë 3)” AK ka mbajtur standard të dyfishtë në vendosjen e kriterëve e cila minimizon pjesëmarrjen e operatorëve në tender, por që nuk është fenomen i përhapur që të përbëjë shmangie nga procedurat e prokurimit dhe ndikojë në rezultatin final.

☞ Për vitin 2020-2021, në procedurat e prokurimit “sistem dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar” u konstatua vonesa në përgatitjen e akteve administrative nga Drejtoria e Kabinetit nga momenti i dërgimit të ftesës nga organizatorët për pjesëmarrje në event/takim jashtë vendit dhe deri në momentin e miratimit të pjesëmarrësve si staf shoqërues i ministrit (përfshirë dhe procedurën e miratimit nga Kryeministrit për dalje jashtë vendit të ministrit) me qëllim fillimin e procedurave të prokurimit. Kjo ka sjellë që procedurat e tenderimit të fillojnë afërsisht 2-3 ditë para datës së zhvillimit të eventit/takimit dhe për pasojë blerja e biletave të jetë me kosto më të lartë.

Për sa sipër trajtuar janë mbajtur Aktkonstatimet nr.5, 5/1 dhe 5/2, datë 23.06.2023.

Titulli i gjetjes 1: Vonesa në hartimin e akteve për pjesëmarrje në evente jashtë vendit si staf shoqërues i ministrit për fillimin e procedurave të prokurimit “sistem dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar”.

Situata: Për vitin 2020 dhe 2021 në procedurat e kryera nëpërmjet “sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar” u konstatua se nga momenti i dërgimit të ftesës nga organizatorët për pjesëmarrje në event/takim jashtë vendit dhe deri në momentin e miratimit të pjesëmarrësve si staf shoqërues i ministrit (përfshirë dhe procedurën e miratimit nga Kryeministrit për dalje jashtë vendit të ministrit) me qëllim fillimin e procedurave të prokurimit, konstatohen vonesa në përgatitjen e akteve administrative nga Drejtoria e Kabinetit. Kjo ka bërë që procedurat e tenderimit të fillojnë afërsisht 2-3 ditë para datës së zhvillimit të eventit/takimit, duke sjellë si pasojë blerje të biletave me kosto më të lartë, pasi menaxhimi për hartimin e akteve administrative të sipërme është jo efektiv nga Drejtoria e Kabinetit.

Kriteri: Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Fillimi i procedurave të prokurimit me vonesë 1-2 para datës së udhëtimit.

Shkaku: Vonesa në hartimin e akteve për pjesëmarrje në evente jashtë vendit si staf shoqërues i ministrit.

Rëndësia: i ulët



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Rekomandimi 1.1: Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MD në bashkëpunim me Drejtorin e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në evente jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin si dhe konfirmimit nga Kryeministri në ato raste kur kërkohet për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në fillimin e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.

Rast pas rasti

Titulli i gjetjes 2: Vonesa në hartimin e akteve për pjesëmarrje në evente jashtë vendit si staf shoqërues i ministrit për fillimin e procedurave të prokurimit “sistem dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar”.

Situata: Në Ftesën për ofertë në tenderin “Blerje bileta avioni Tiranë- New York–Tiranë”, AK ka vendosur si kriter “operatori ekonomik të ketë 10 vite eksperiencë në treg, me certifikatën IATA”, kriter i cili nuk trajton në mënyrë të barabartë pjesëmarrësit pasi në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 i ndryshuar, pika 1, përcaktohet qartë se “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale.Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Gjithashtu dhe në Udhëzimin e APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar pika 6, germa “b” përcaktohet se: “Në raste specifike Komisioni i sistemit dinamik i biletave, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, mund të kërkojë plotësimin e një ose disa kriterëve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin provues si p.sh. Certifikatë akreditimi ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association”. Komisioni me Memo datë 27.05.2021 (nr. 2796/2 Prot) drejtuar ish Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK ka bërë oponencë mbi vendosjen e kriterit të sipërm trajtuar në kërkesën nr.2796/1 Prot, datë 27.05.2021 të Sektorit të Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse për miratimin e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi. Oponenca nuk është marrë në konsideratë nga ish Sekretari i përgjithshëm i cili në memo ka bërë shënimin “Të vendosen të gjithë kërkesat që janë paraqitur në memon e dt 26.05.2021”. Veprimi nuk është në përputhje me Ligjin nr.162/2020 i ndryshuar, neni 77, pika 1 dhe Udhëzimin e APP nr.4, datë 09.01.2018 i ndryshuar pika 6, germa “b”. AK në vendosjen e kriterëve ka ndjekur standarde dyfishe pasi Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në raste të tjera nuk ka përcaktuar këtë kriter për operatorët.

Kriteri: Ligji nr.162/2020 i ndryshuar, neni 77 pika 1; Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1.

Ndikimi/efekti: Fillimi i procedurave të prokurimit me vonesë 1-2 para datës së udhëtimit; Trajtim jo i barabartë i operatorëve në tender.

Shkaku: Vonesa në hartimin e akteve për pjesëmarrje në evente jashtë vendit si staf shoqërues i ministrit; Vendosja e kriterit kufizues për pjesëmarrësit.

Rëndësia: e ulët



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Rekomandimi 2.1: Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor/MD që në hartimin e dokumenteve të tenderit/vendosja e kriterëve të veçanta të jetë në përputhje me objektin e prokurimit në çdo rast, me qëllim shmangien e pabarazisë në tendera.

Rast pas rasti

Titulli i gjetjes 4: Mos argumentimi i çdo kriteri kualifikues të vënë.

Situata: Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin “*Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë*” zhvilluar më datë 16.12.2020, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përputhje me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë me ofertë më të mirë bazuar në Çmim dhe Propozim teknik. Kriteret e Vleresimit teknik me vlerësim me Pikë (i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10], (ii) Metodologjia e Propozuar [20-30], (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-60]. Ndërkohë, sipas kriterëve kualifikues të veçanta të Kapacitetit teknik, kërkohet që Operatori ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomik duhet të vërtetohet se disponon minimalisht stafin kryesor: Drejtues Projekti me Eksperiencë Pune *mbi 15 vite*. Drejtuesi i Projektit pranohet të jetë edhe njeri nga, Projektues Arkitekt ose Projektues Konstruktor. Projektues Arkitekt (2 persona), ekspertë me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Konstruktor (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Mekanik (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Elektrik (2 persona), ekspertë me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Gjeodet (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*. Inxhinier Gjeolog (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 5 vite*. Inxhinier Hidroteknik (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 5 vite*. Kërkesa e mësipërme referuar Vendimeve të KPP-së dhe nenit 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, ku gjykohet qartë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve*. Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të Arkitektëve dhe Inxhinierëve, trajton në mënyrë të pabarabartë ose diskriminues Arkitektët dhe Inxhinierët që nuk kanë eksperiencë mbi 10 vite. Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë. Gjithashtu referuar edhe vlerësimit me pikë mbi eksperiencat e stafit, punët e ngjashme etj, kërkesa e mësipërme nuk stimulon dhe nxit pjesëmarrjen e OE.

Kriteri: VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit; Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

Ndikimi/efekti: Mos argumentim i kriterëve kualifikues dhe mos stimulim të pjesëmarrjes në konkurrim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Shkaku: Kriteria kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 4.1: Ministria e Drejtësisë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vlerësimi duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 5: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstrukcion i Godinës së Ministrisë së Drejtësisë”.

Situata: Nga verifikimi i strukturës së preventivit, pagesës në situacionin përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:

1. Me kërkesën për propozim të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit Pa Prot., datë 07.12.2020, paraqitet analizë teknike e zërit të paparashikuar në preventiv me nr. Analize 2.334 “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”. Çmimi i këtij zëri është paraqitur sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Me procesverbalin e negociimit të zërit të ri datë 10.12.2020, mbas konsultimeve të realizuara nga palët u miratua çmimi prej 645 lekë /m² për zërin “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”. Me procesverbalin e palëve të datës 14.12.2020, gjatë verifikimeve në objekt u pa e nevojshme kryerja e disa ndryshimeve të volumeve të zërave të punimeve të paparashikuara në preventivin fillestar. Referuar situacionit përfundimtar në kapitullin e suvatime dhe veshje, konstatohet se fasada e jashtme prej 1,091 m², ka kryer 2 procese pune: a. “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”, me çmim 645 lekë /m², b. “Suvatim me grafiato h > 4m”, me çmim 750 lekë /m². Nga verifikimi i fasadës konstatohet se është realizuar vetëm zëri i “Suvatim me grafiato”, ku lartësia në fakt është mbi 8m. Nga verifikimi në disa pjesë të objektit, konstatohet se është realizuar vetëm mbushja me kollë, rrjeta dhe grafiato e gatshme. Pra nuk u konstatuan procese të suvatimit të jashtëm si kryerja e fashaturave, mbushja dhe realizimi me rerë të larë (ose Fino). Referuar situacionit përfundimtar dhe analizës së çmimit për suvatimin e jashtëm mbi 8 m, në kapitullin e punimeve të skelerisë dhe kallëpi, konstatohet se zëri nr. 2 me nr. Analize 2.431 “Skelë metalike me tubo fasade >12 m” në sasinë prej 1,608 m², me çmimin përkatës prej 90 lekë/m² është zë pune i mbivendosur zërit nr. 2.334 “Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m”, pasi përfshihet në strukturën e çmimit. Rrjedhimit vlera prej 144,720 lekë, e likuiduar në zërin “Skelë metalike me tubo fasade >12 m”, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Në kapitullin e punime shtresash, zëri nr. 9, me nr. Analize 2.276 “Shtresë parketi”. Sasia për "shtresë parketi" është paguar në situacion në sasinë 29.8 m², me çmimin prej 6,550 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 29.8 m², në ambientet e katit dytë zyra 8 dhe zyra 9. Nga verifikimi në këto ambinate konstatohet se këto sipërfaqe nuk janë realizuar me shtresë parketi por me shtresë parketi laminat, me çmimin përkatës prej 1,650 lekë/m². Pra konstatohet se sipërmarrësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ka përfituar diferencë cmimi prej 4,900 lekë/ m² (6,550 lekë/m² - 1,650 lekë/m²). Vlera e diferencë e përfituar më tepër rezulton 4,900 lekë/m² x sasinë 29.8 m² = 146,020 lekë.

3. Kapitulli i punimeve tavani, suvatimi dhe veshje, zëri nr. 1, me nr. Analize 2.3 “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*”. Sasia për “Suvatimit të tavanit” është paguar në situacion në sasinë 645 m², me cmimin prej 650 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 645 m², në nga ambientet e katit I deri të katit XI. Nga verifikimi në disa ambiente të MD zyra dhe shesh pushime, konstatohet se nuk janë realizuar suvatime të tavanit, por vetëm tavane të varur me pllaka gipsi 60x60 dhe tavane karton xhes. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin e punimit “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*” në vlerën 416,250 lekë.

Si përfundim, për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 706,990 lekë pa TVSH (416,250 + 146,020 + 144,720) ose **848,388 lekë me TVSH**, e përfituar nga sipërmarrësi “I.” shpk, për zëra të parealizuar.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Ndikimi/efekti: Përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve vlera prej 848,388 lekë.

Shkaku: Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 5.1: Ministria e Drejtësisë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 848,388 lekë nga kontraktori OE “I.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda 31.12.2023

6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT DHE AUDITIT TË BRENDSHËM

Në zbatim të pikës 6 “*Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm*” të programit të auditimit nr. 249/1 Prot., datë 05.04.2023, i ndryshuar”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Urdhrat për emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues;
2. Plani i veprimit;
3. Pyetësori i vetëvlerësimit;
4. Raporti i kontrollit të brendshëm;
5. Vendimet e GMS;
6. Draft rregullore e MD;
7. Plani Auditimit dhe realizimit për vitin 2020-2021-2022.
8. Raporti vjetor për vitin 2020-2021-2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

9. Plani strategjik 2020-2021-2022.
10. Plani strategjik i auditimit dhe ai vjetor 2020-2021-2022.

Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar

-Baza ligjore dhe nënligjore ku u bazua auditimi:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

I. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Referuar legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, “Mjedisi i kontrollit” është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Vlerësimi i Mjedisit të kontrollit bazohet në komponentët:

1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se ‘Kudri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje’. Në lidhje me këtë komponent MD ka të miratuar Kodin e Etikës me Urdhër të Titullarit nr.347, datë 02.09.2013 “Për miratimin e rregullores së Etikës”.

Ky detyrim ligjor gjen përcaktim dhe në Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” si dhe në Rregulloren e Brendshme nr.116 Prot., datë 30.03.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MD” kreu VIII, IX, X, ku trajtohen çështje lidhur me kodin e sjelljes dhe etiken profesionale të punonjësve.

a. Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe “b”, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 2.2.7 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a, është hartuar plani strategjik i cili përmban objektivat strategjike disa vjeçare, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, me njësitë përgjegjëse dhe afatet kohore, konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Në zbatim të nenit 8, pika 8/b të ligjit për MFK, në vitin 2020 me Urdhër nr. 205/2 datë 09.07.2019, të titullarit është ngritur grupi për menaxhimin strategjik të njësisë (GMS). Për vitin 2021 me Urdhër nr.2 datë 05.01.2021 të titullarit është ngritur grupi për menaxhimin strategjik të njësisë (GMS) dhe me Urdhër nr. 38 datë 31.01.2022 të titullarit për vitin 2022 është ngritur grupi për menaxhimin strategjik të njësisë(GMS) .

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se janë ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik për secilin vit, ato nuk kanë funksionuar pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e MFK, nuk gjenden proceverbalet e mbledhjeve të këtyre grupeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për vitin 2020 është miratuar plani strategjik 2022-2022 si dhe plani vjetor për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, me urdhërin nr 6048/1 Prot., datë 19.10.2020.

-Për vitin 2021 është miratuar plani strategjik 2022-2024 si dhe plani vjetor për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, me Vendimin nr.23, datë 07.10.2021.

-Për vitin 2022 është miratuar plani strategjik 2022-2024 si dhe plani vjetor për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, me shkresën nr 612/7 Prot., datë 12.10.2021.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:

-Për vitin **2020**, Ministria e Drejtësisë ka funksionuar në përputhje me strukturën e miratuar nga Kryeministri me Urdhërin nr. 114, datë 04.09.2019 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar ku numri i miratuar i punonjësve është 149.

-Për vitin **2021**, me urdhërin e Kryeministrit nr.128, datë 08.11.2021 është miratuar struktura e re ku numri i punonjësve është rritur në 181 veta.

-Per vitin **2022** nuk ka pasur ndryshime ne sturkturen e MD-së.

c. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore

Institucioni në draft rregulloren e përgatitur, Kreu XI “Detyra me Karakter të Përgjithshëm” ka të përcaktuar procedurat për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës, rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, procedurat e rekrutimit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës.

-Me memon nr. 3831 Prot., datë 23.06.2020 nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menxhimit Financiar, është hartuar manuali i proceve te punës.

Nga MD janë respektuar kërkesat ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm në lidhje me emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues.

-Me shkresën nr,1599 prot., datë 23.03.2022 është konfirmuar si Nëpunës Autorizues z.B. B..

-Me shkresën nr,5734 prot., datë 05.11.2021 është konfirmuar si Nëpunës Autorizues z.I. Sh..

-Me shkresën nr.12374/1 prot., datë 14.07.2021 është konfirmuar si Nëpunës Zbatues znj.B.Q..

- Me shkresën nr,13640/1 prot., datë 19.07.2019 është konfirmuar si Nëpunës Autorizues z.G. D..

- Me shkresën nr,19148/3 prot., datë 29.12.2017 është konfirmuar si Nëpunës Zbatues znj.M. Z..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

-Për vitin 2022 me shkresën nr.5504/3 Prot., datë 24.11.2022 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Mirëadministrimit të Shërbimeve Sektori i Burimeve Njerzore, janë dërguar pershkrimet e punës në Departamenti i Administratës Publike (DAP).

-Për periudhën objekt auditimi pershkrimi i proceseve të punës është pasqyruar në Rregulloren e brendshme hartuar nga institucioni miratuar me urdhër të ministrit nr.116, datë 30.03.2022.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Ministria e Drejtësisë, ka hartuar regjistër risku për vitin 2020, miratuar nga ish sekretari i përgjithshëm Z. G. D. me shkresë nr.5871 prot., datë 22.09.2020, sikurse parashikohet në nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ku përcaktohet se *‘Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë’*.

-Për vitin 2021-2022 nga MD nuk është hartuar Rregjistri i Riskut në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar pika d).

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj. Metoda e përgjithshme e rekomanduar për krijimin, vlerësimin dhe raportimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit përmbledhet në disa hapa kryesore.

Hapi IV- *Harta ose Lista e proceseve të punës.*

Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi është hartuar një listë mbi proceset e punës për Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar, ku përgjegjësitë janë ndarë në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin marrjen e vendimit, zbatimit, kontabilitetit dhe kontrollit.

4. Informim komunikimi

Shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në Rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikes janë pershkruar proceset e punës dhe sjellja e etike gjatë punës si dhe marrëdhëniet me njëri tjetrin. Komunikimi i informacionit realizohet përmes shkresave zyrtate me institucionet e tjera si dhe përmes postës elektronike/e-mail.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Informacion periodik sigurohet në mënyrë të ndërsjelltë, raportimet bëhen rast pas rasti mujore, katër mujore dhe vjetore.

Informacioni dhe komunikimi lidhen edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në Ministrinë e Drejtësisë. Rregullat e komunikimit elektronik të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen nga AKSHI.

5. Monitorimi

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “*monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur*”. Titullarët e njësisve publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë. Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet plotësisht të pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, për periudhën e audituar, MD ka përgatitur Deklaratën dhe Raportin vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin **2020** dhe i ka dërguar MFE me shkresën nr.1175 prot., datë 26.02.2021, Pyetsorin e vetëvlerësimit si dhe Deklaratën e cilësisë dhe raportin mbi vlersimin e sistemit të MFK – së, për vitin 2020.

-Për vitin 2021 MD ka dërguar me shkresën nr.1245/1 prot., datë 28.02.2022 Pyetsorin e vetëvlerësimit, Deklaratën e cilësinë dhe raportin mbi vlersimin e sistemit të MFK – së, për vitin 2021.

-Për vitin 2022 MD ka dërguar me shkresën nr.1405/1 prot., datë 27.02.2022 Pyetsorin e vetëvlerësimit, Deklaratën dhe Raportin vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2022, si dhe planin e veprimtari të MFK – së.

Mbi vlerësimin e veprimtari të auditit të brendshëm:

Viti 2020

Me urdhër të titullarit nr. 2165/8 prot., datë 11.10.2019 është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor, 2020-2022 në përputhje me afatet ligjore të përcakëtuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. MD me shkresën nr.6668/1 prot., datë 17.10.2019 ka dërguar në MFE planin strategjik 2020- 2022 dhe atë vjetor 2020 të veprimtari të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Sipas planit strategjik dhe vjetor të dërguar, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MD, për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 10 auditime, dhe të vlersuar në nivel të lartë risku, konkretisht:

Ministria e Drejtësisë (Aparati)
Agjensia e Trajtimit të Pronave,
Komiteti Shqipëtar i Birësimeve,
Arkivat gjyqësore Lundër,
Zyra e Përmbartimit Sarandë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Zyra e Përmbarrimit Dibër,
Zyra e Përmbarrimit Pogradec,
Zyra e Përmbarrimit Shkodër,
Zyra e Përmbarrimit Kukës,
Fondet e IPA.

Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2020 është miratuar nga Titullari me shkresën nr 284/1, datë 09.02.2021 dhe është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 284/2 prot, datë 09.02.2021. Në këtë raportim është përshkruar ecuria e angazhimeve të auditimeve ku janë planifikuar 10 auditime, nga të cilët 6 nuk janë zhvilluar, dy kanë qenë në proces në momentin e raportimit dhe dy janë përfunduar, konkretisht:

Tabela nr. 73

Instutusionet për tu adituar gjatë vitit 2020:	Realizimi
Ministria e Dtejtësisë (Aparati)	Në proces në momentin e raportimit
Agjensia e Trajtimit të pronave	Në proces në momentin e raportimit
Komiteti Shqipëtar i Birësimeve	Përfunduar
Arkivat gjyqësore Lundër	Nuk është realizuar
Zyra Përmbarrimore Sarandë	Nuk është realizuar
Zyra Përmbarrimore Dibër	Nuk është realizuar
Zyra Përmbarrimore Pogradec	Nuk është realizuar
Zyra Përmbarrimore Shkodër	Përfunduar
Zyra Përmbarrimore Kukës	Nuk është realizuar
Fondi IPA	Nuk është realizuar

Për sa më lart, rezulton se ka një nivel shumë të ulët të përmbushjes së planit vjetor të auditit të brendshëm, më një realizim vetëm në masën 40%., i cili për këtë vit ka ardhur edhe si pasojë e periudhës së pandemisë. Nga auditimet e përfunduara në vitin 2020 janë dhënë 45 rekomandime për përmirësimin e punës dhe rritjen e besueshmërisë tek Titullari. Gjatë ushtrimit të kontrollit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në subjektet e varësisë janë konstatuar problematika të cilat kanë pasqyruar situatën e qartë të mosfunksionimit të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Referuar gjetjeve kryesore të vitit 2020, ato lidhen kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me mangësitë në ushtrimin e kompetencave të organeve drejtuese të organizatës, si dhe në performancën jo të mirë për sa i përket realizimit të objektivave. Nga veprimtaria vjetore e AB janë lënë në total 25 rekomandime nga të cilat:
7 rekomandime në fushën e sistemit të prokurimeve, blerjve dhe investimeve dhe kryesisht: 6 për Insitutinin e Mjeksisë Ligjore dhe 2 për Komitetin Shqipëtar të Birësimit.
1 rekomandim në fushën e sistemit të tatimeve, taksave dhe doganave dhe konkretisht për Zyrën Përmbarrimore Shkodër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

15 rekomandime të tjera, nga të cilat 7 për Zyrën Përmbartimore Shkodër, 8 për Komitetin Shqipëtar të Birësimit.

Organizimi i kapaciteteve audituese në MD

Për periudhën 2020 në MD kanë qenë në fuqi strukturat e miratuara me Urdhrat e Kryeministrit nr. 114, datë 04.09.2019, i ndryshuar me urdhërin nr. 65, datë 11.05.2020, “Për miratimin e strukturës dhe Organizatës së Ministrisë së Drejtësisë”, ku njësia e auditimit të brendshëm është organizuar në Drejtorin Auditimi. Kjo drejtori sipas strukturës në fuqi për vitin 2020 ka qenë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm, me 5 punonjës në organikë, 1 Drejtor dhe 4 specialistë. Organika për periudhën e auditimit ka funksionuar e plotësuar.

Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", dhe zhvillohet bazuar në Programin e Angazhimit të Auditimit, të hartuar për çdo njësi shpenzuese, me qëllim për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin me efektivitet të fondeve publike dhe performancën e njësisë që auditohet. Auditorët i raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejt Titullarit Institucionit/Ministrit të Drejtësisë, nga i cili ka varësinë organizative dhe funksionale. Specialistët janë me arsim të lartë, 3 me shkenca ekonomike dhe 1 me shkenca juridike.

Tre nga specialistët, përfshirë Drejtorin e Komanduar, janë të pajisur me certifikatën "Auditues i Brendshëm në sektorin publik". Këta specialistë kanë ndjekur trajnimin vjetor prej 40 orësh, të organizuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Njëri nga specialistët znj.A. K. e punësuar në shtator të vitit 2019 është duke ndjekur trajnimin për certifikimin si Auditues e Brendshme pranë MFE.

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur struktura e Komitetit të Auditimit të Brendshëm me datë 15.03.2019 dhe ka vijuar veprimtarinë e tij si një strukturë mbështetëse për Drejtorinë e Auditimit, duke dhënë garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike. Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 4 mbledhje me Komitetin e Auditimit të Brendshëm, ku janë diskutuar problematikat e Drejtorisë së Auditimit, ecuria e planit vjetor 2020, gjetjet dhe rekomandimet sipas rastit.

Gjatë vitit 2020, i gjithë stafi i DAB ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vijueshëm të edukimit të përditësuar të organizuar dhe zhvilluar nga NJQH/AB. Nga ana e stafit të cilët kanë qënë të certifikuar janë ndjekur trajnimet e detyrueshme 40 orë në vit të organizuara nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, këto trajnime janë zhvilluar online dhe janë ndjekur me interes nga audituesit e drejtorisë. Po kështu janë ndjekur edhe trajnimet e organizuara nga ASPA, si dhe është marrë pjesë intensivisht në trajnimet e zhvilluara nga Euralius në periudhën Maj 2020 dhe Dhjetor 2020. Të gjitha orët e trajnimit kanë pasur në fokus metodologjinë audituese, menaxhimin e riskut, auditimin e performancës, raportimin dhe tema të tjera të lidhura ngushtësisht me fushën e auditimit.

Viti 2021

Me urdhër të titullarit nr. 353 prot., datë 19.10.2020 është miratuar plani strategjik 2021 – 2023 dhe ai vjetor, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, të cilat janë dërguar në MFE nëpërmjet postës elektronike nëpërmjet postës elektronike më datë 19.10.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Sipas planit strategjik dhe vjetor të dërguar, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MD, për vitin 2021 ka planifikuar gjithsej 15 auditime, të gjitha të kombinar dhe të vlersuar në nivel të lartë risku, konkretisht:

Ministria e Drejtësisë (Aparati),
Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
Zyra e Përmbarimit Sarandë,
Zyra e Përmbarimit Pogradec,
Zyra e Përmbarimit Elbasan,
Zyra e Përmbarimit Tiranë,
Zyra e Përmbarimit Kukës,
Zyra e Shërbimit të Provës Kukës,
Zyra e Shërbimit të Provës Korçë,
Zyra e Shërbimit të Provës Fier,
Zyra e Shërbimit të Provës Tiranë,
Zyra e Shërbimit të Provës Elbasan,
Agjensia Kombëtare e Falimentit.

Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Auditimit për vitin 2021 janë zhvilluar auditime të cilat nuk kanë qenë pjesë e planit vjetor por janë inicuar nga titullari (Ministri), krahas auditimit të ATP që ka filluar në vitin 2020 dhe ka qenë pjesë e planit të vitit 2020.

1. Auditimi në Drejtorinë e Përgjithëshme të Përmbarimit mbi problematikën e operacioneve financiare si dhe funksionimin e sistemit ALBIS.
2. Auditimi i ndjekjes së Rekomandimeve të KLSH në Drejtorinë e Përgjithëshme të Burgjeve.
3. Mbi zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.642, datë 22.11.2021 "Për verifikimin e zbatimit të urdhrin nr.9275/2, datë 10.10.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe efekteve financiare".
4. Mbi përfundimin e raportit të Inspektimit Financiar pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.
5. Mbi Urdhërin nr 565 dt 13.10.2021 të Ministrit të Drejtësisë mbi funksionimin e arkës të të dënuarve dhe pajisjen me karta debiti të tyre.
6. "Mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave në lidhje me kompensimin e ish pronarëve për periudhën nga data 01.07.2018 deri më datë 31.07.2020."

Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2021 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, me shkresën nr. 130/1 prot, datë 07.02.2022, në të cilin është përshkruar ecuria e angazhimeve të auditimit.

Nga auditimet e përfunduara në vitin 2021 janë dhënë 120 rekomandime për përmirësimin e punës dhe rritjen e besueshmërisë tek Titullari. Gjatë ushtrimit të kontrollit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në subjektet e varësisë janë konstatuar problematikat të cilat kanë pasqyruar situatën e qartë të mosfunksionimit të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Referuar gjetjeve kryesore të vitit 2021, ato lidhen kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me mangësitë në ushtrimin e kompetencave të organeve drejtuese të organizatës si dhe në performancën jo të mirë për sa i përket realizimit të objektivave.

Nga 120 rekomandimet konstatohen:

22 rekomandime në fushën e sistemit të prokurimeve, blerjeve dhe investimeve;

35 rekomandime në fushën organizative dhe probleme të hasura gjatë auditimit;

60 rekomandime të tjera, në kuadrin e përmirësimit ligjor rregulloreve dhe kryesisht në sistemin e Burgjeve.

3 rekomandime në fushën e arkëtimeve 11,063 (në/000) lekë për shuma të pa justifikuar, nga ana e njërive shpenzuese dhe kryesisht BPB Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit.

Organizimi i kapaciteteve audituese në MD :

Për periudhën 2021 në MD kanë qenë në fuqi strukturat e miratuara me Urdhrat e Kryeministrit nr. 114, datë 04.09.2019, i ndryshuar me urdhërin nr. 65, dt. 11.05.2020, urdhërin nr. 119, datë 25.09.2020. dhe me udhërin nr.08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, ku njësia e auditimit të brendshëm është organizuar në Drejtori Auditimi. Edhe për këtë vit, kjo drejtori ka qenë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm, me 5 punonjës në organikë, 1 Drejtor dhe 4 specialistë. Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", dhe është zhvilluar bazuar në Planin Vjetor të Auditimit për Vitin 2021, si dhe nëpërmjet Programeve të Angazhimit të Auditimit, të hartuar për çdo njësi shpenzuese, me qëllim për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin me efektivitet të fondeve publike dhe performancën e njësisë që auditohet.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 4 mbledhje me Komitetin e Auditimit të Brendshëm, ku janë diskutuar problematikat e Drejtorisë së Auditimit, ecuria e planit vjetor 2020, si dhe gjetjet dhe rekomandimet sipas rastit.

Edhe për këtë vit rezulton se kjo njësi ka funksionuar me titullar të komanduar.

Viti 2022

Me vendimit nr. 23, datë. 07.10.2021 të KAB, është miratuar plani vjetor 2020-2022 dhe plani strategjik 2022-2024. Titullari me urdhërin nr. 563 datë 12.10.2021 ka miratuar planin strategjik dhe vjetor, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Me shkresën nr. 5043/1 prot., dt. 12.10.2021 është dërguar në MFE kërkesa për miratimin e planit strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së NJAB për vitet 2022 – 2024.

MD me shkresën nr.451/4 prot., datë 06.02.2023 ka dërguar në MFE raportin vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm për vitin 2021.

Sipas planit strategjik dhe vjetor të dërguar, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në MD, për vitin 2022 ka planifikuar gjithsej 12 angazhime për auditim dhe 6 angazhime të Përputhshmërisë.

Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2022 është miratuar nga Titullari me shkresën nr. 370/17 Prot., datë 27.12.2022 dhe është dërguar në Drejtorinë së Harmonizimit e Adutimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 451/4 prot, datë 06.02.2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Për vitin 2022, rezulton se nga njësia e auditimit janë konstatuar ose zbuluar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit në shumën 3,471,000 lekë.

Rekomandimet e shprehura në numër janë 149 gjithsej, (shtuar edhe rekomandimet e dhëna për njësinë shpenzuese "IEVP Krujë Fushë Krujë, Lezhë Shkodër) përfunduar në Janar- Shkurt 2022.

- 1.Rekomandime për përmirësimin e sistemeve;
2. Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor;
3. Rekomandime të karakterit organizativ
4. Rekomandime për aktetime të vlerave me efekteve financiare, në fushën e pagesave, prokurimeve, administrim aktiveve, etj;
5. Rekomandime sistemi i menaxhimit buxhetor
6. Rekomandime në sistemin e Inventarizimit

Edhe për këtë vit, Njësia e Auditit të Brendshëm ka vijuar të funksionojë me titullar të komanduar.

Auditimi i dosjeve të audituara nga auditimi i Brendshëm.

U përzgjedhën për auditim nga plani vjetor i vitit 2020, dosjet e auditimit të ushtruara në Agjensin e Trajtimit të Pronave dhe Komuniteti Shqiptar i Birsimit. Përzgjedhja e tyre u bë nga studimi i analizës së riskut pasi janë vlersuar me risk të lartë nga, DAB në hartimin e planit vjetror të vitit 2020.

-Dosja e auditimit në subjektin “Agjensin e Trajtimit të Pronave”.

Referuar Manualit të “Auditimit të brëndshëm në sektori publik”, miratuar me urdhërin 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave nga drejtori i DAB-së:

është nxjerrë autorizim për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim në ATP me shkresën nr. 5598, datë 11.09.2020, në bazë të së cilës ka dal programi i angazhimit të auditimit nr 5598/1, datë 11.09.2020 si dhe programi shtesë nr. 5598/2, datë 20.10.2020.

Antarët e grupit të auditimit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit sipas formularit standad 2. Me subjektin është mbajtur takimi fillestar datë 11.09.2021, sipas formularit standard 7 si dhe është bërë ndarja e detyrave në zbatim të programit të auditimit.

Nga grupi i auditimit është bërë vlersimi i riskut për mjedisin e kontrollit duke u plotësuar pyetësoret përkatës si dhe janë mbajtur teste individuale të audituesëve konform standardit 9. Pas përfundimit të punës në terren me shkresën nr. 3295, datë 24.06.2021, është dërguar në subjekt projekt raport i auditimit

Nga ana e subjekti është bërë kërkesë për shtyrje të afatit 10 ditore të dërgimit të observacioneve me shkresën nr. 5377 datë 30.06.2021 dhe po me shkresën nr. 5377/1, datë 06.07.2021, ATP ka kërkuar përsëri shtyrje për observacionet mbi projekt raportin me pretendimin se punonjësit e atakuar në projekt raport kanë marrë lejen vjetore përfshirë dhe titullari i institucionit. Këto kërkesa për shtyrje të afatit të dorzimit të observacioneve janë marrë në konsideratë nga DAB.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Subjekti me shkresën nr.5242/2, datë 25.08.2021 dhe me shkresën nr.5242/3, datë 14.09.2021 ka dërguar pranë DAB observacionet përkatëse dhe më datë 20.11.2020 është mbajtur në subjektin ATP takimi përmblyllës mbi gjetjet dhe rekomandimet e lënë nga auditimi.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, ATP me shkresën nr.3370/1, datë 20.06.2022 drejtuar DAB-së dërgon informacionin dhe planin e masave.

-Dosja e auditimit në subjektin “Komiteti Shqiptar të Birësimit”

Referuar Manualit të “Auditimit të brëndshëm në sektori publik”, miratuar me urdhërin 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave nga drejtori i DAB, është nxjerrë autorizim për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim në njësinë e varësisë “Komiteti Shqipëtar i Birësimit”, me nr. 3539, datë 11.06.2020, në bazë të të cilit ka dal programi i angazhimit të auditimit nr 3539/1 prot, datë 11.06.2020. Antarët e grupit të auditimit kanë nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit sipas formularit standad 2. Me subjektin është mbajtur takimi fillestar datë 05.07.2020, sipas formularit standad 7, si dhe është bërë ndarja e detyrave në zbatim të programit të auditimit. Nga grupi i auditimit është bërë vlersimi i riskut për mjedisin e kontrollit duke u plotësuar pyetësoret përkatëse si dhe janë mbajtur teste individuale të audituesëve konform standardit 9. Pas përfundimit të punës në terren me shkresën nr. 3539/2 prot., datë 03.08.2020, është dërguar në subjekt projekt raport i auditimit. Subjekti me shkresën nr. 517/1, datë 14.08.2020 ka dërguar pranë DAB observacionet përkatëse brënda afatit të përcaktuar dhe me datë 03.07.2020 është mbajtur takimi përmblyllës mbi gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga auditimi.

Raporti përfundimtar i auditimit është dërguar në subjekt brenda afatit me shkresën nr. 3539/4 prot., datë 01.09.2020.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, KSHB me shkresën nr.352/1 prot., datë 16.06.2020 drejtuar DAB-së dërgon informacionin dhe planin e masave.

U përzgjedhën për auditim nga plani vjetor i vitit 2021, auditimet të cilat nga studimi i analizës së riskut nga DAB janë vlersuar me risk të lartë dhe konkretisht, Arkiva Shtetërore e Sistemit gjyqësor dhe Aparati i Ministrisë së Drejtësisë.

-Dosja e auditimit në subjektin “Arkiva Shtetërore e Sistemit gjyqësor”.

Referuar Manualit të “Auditimit të brëndshëm në sektori publik”, miratuar me urdhërin 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave është nxjerrë autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim në “Arkivën Shtetërore të Sistemit gjyqësor”, me nr. 453, datë 26.01.2021, në bazë të së cilës ka dal programi i angazhimit të auditimit. Antarët e grupit të auditimit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit sipas formularit standad 2. Me subjektin është mbajtur takimi fillestar datë 26.01.2021, sipas formularit standard 7 si dhe është bërë ndarja e detyrave në zbatim të programit të auditimit. Nga grupi i auditimit është bërë vlersimi i riskut për mjedisin e kontrollit duke u plotësuar pyetësorët përkatës, si dhe janë mbajtur teste individuale të audituesëve konform standadit 9.

Pas përfundimit të punës në terren është mbajtur takimi përmblyllës me subjektin më datë 28.02.2021. me shkresën nr. 61/3, datë 30.03.2021 subjekti ka dërguar pranë DAB observacionet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

përkatese dhe me shkresën nr. 453/5 prot., datë 15.04.2021, është dërguar në subjekt projekt raport i auditimit.

Me shkresën nr.709/1, datë 12.12.2021, ASHSGJ ka dërguar në DAB ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

-Dosja e auditimit në subjektin “Aparati i Ministrisë së Drejtësisë”.

Referuar Manualit të “Auditimit të brëndshëm në sektori publik”, miratuar me urdhërin 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave nga drejtori i DAB-së, është nxjerrë autorizim për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim në “Aparati i Ministrisë së Drejtësisë”, me shkresën nr. 123, datë 08.01.2021, në bazë të së cilës ka dal programi i angazhimit të auditimit nr. 123/1, datë 08.01.2021 si dhe programi shtes nr.123/2, datë 23.02.2021. Antarët e grupit të auditimit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit sipas formularit standad 1. Me subjektin është mbajtur takimi fillestar datë 08.01.2021, sipas formularit standad 8 si dhe është bërë ndarja e detyrave në zbatim të programit të auditimit. Nga grupi i auditimit është bërë vlersimi i riskut për mjedisin e kontrollit duke u plotësuar pyetësoret përkatëse si dhe janë mbajtur teste individuale të audituesëve konform standadit 9. Pas përfundimit të punës në terren me shkresën nr. 123/3, datë 24.06.2021, është dërguar në subjekt projekt raport i auditimit. Me shkresën nr. 123/5, datë 12.07.2021 janë dërguar pranë DAB observacionet përkatëse.

DAB me shkresën nr.3222 Prot, datë 03.06.2022, ka nxjerr programin për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve në “Aparati i Ministrisë së Drejtësisë”.

U përzgjedh për auditim nga plani vjetor i vitit 2022, referuar studimit të analizës së riskut nga DAB, auditimi pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë.

-Dosja e auditimit në subjektin “Qendra e Botimeve Zyrtare Tiranë”.

Referuar Manualit të “Auditimit të brëndshëm në sektori publik”, miratuar me urdhërin 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave nga drejtori i DAB është nxjerrë autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim në “Qendra e Botimeve Zyrtare Tiranë”, me nr. 4602/1, datë 25.08.2022, në baze të së cilës ka dal programi i angazhimit të auditimit. Antarët e grupit të auditimit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit sipas formularit standard 2. Me subjektin është mbajtur takimi fillestar datë 25.08.2022, sipas formularit si dhe është bërë ndarja e detyrave në zbatim të programit të auditimit. Nga grupi i auditimit është bërë vlersimi i riskut për mjedisin e kontrollit duke u plotësuar pyetësoret përkatëse si dhe janë mbajtur teste individuale të audituesëve konform standadit 4.

Pas përfundimit të punës në terren me shkresën nr. 4602/3 prot., datë 20.10.2022, është dërguar në subjekt projekt raport i auditimit .Me shkresën nr 4602/5, datë 11.11.2022 është dërguar raporti përfundimtar brënda afatit ligjor.

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në plotësimin e strukturës

Situata: Nga të dhënat konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi struktura e MD ka qenë e pa plotësuar dhe konkretisht në shkurt 2020 me 26 punonjës më pak, në tetor 2020 me 28 punonjës më pak, në mars 2021 me 18 punonjës më pak, në shtator 2021 me 22 punonjës më pak, në prill 2022 me 41 punonjës më pak dhe në nëntor 2022 me 37 punonjës më pak, duke funksionuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

me një përqindje të lartë të vendeve vakante, veçanërisht përgjatë vitit 2022 ku vihet re se ka mangësi në rreth 23% të strukturës. Pavarësisht vendeve të lira/vakante dhe strukturës së miratuar, janë kontraktuar punonjës me kontrate të përkohshme pune. Në varësi të nevojave për rekrutim në shërbimin civil u konstatua se, MD ka dërguar shkresat përkatëse pranë DAP, konkretisht me shkresë nr. 8365/1, datë 24.12.2019 për vitin 2020 me 26 punonjës, me shkresë nr. 7528/1, datë 18.12.2020 për vitin 2021 me 7 punonjës dhe me shkresë nr. 6598, datë 21.12.2021 për vitin 2022 me 56 punonjës. Nga auditimi rezulton se nevojat për rekrutim janë dërguar në shkelje të afateve të parashikuara.

Kriteri: Urdhër i Kryeministrit nr. 114, datë 04.09.2019 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MD”, i ndryshuar; Urdhër nr. 128, datë 08.11.2021 dhe VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetortë pranimit në shërbimin civil”, pika 7.

Shkaku: Mos marrja e masave të nevojshme të rekrutimit.

Efekti: Rritje e riskut operacional që shoqëron veprimtarinë e MD.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 1.1: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe sektori përkatës i burimeve njerëzore të marrin masa për planifikimin e saktë dhe dërgimin në kohë të nevojave për rekrutime pranë Departamentit të Administratës Publike, si dhe të mbajë me këtë të fundit një bashkëpunim më koherent sa i takon plotësimin të vendeve vakante.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 2: Mos realizimi i mbledhjeve të GMS

Situata: Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se janë ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik për secilin vit, ato nuk kanë funksionuar rregullisht pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e MFK, nuk rezulton të ketë proceverbale të mbledhjeve të këtyre grupeve, si dhe vendime rast pas rasti.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Ndikimi/efekti: Mungesë vendimarrje dhe këshillimi mbi funksionimin e komponentëve të MFK.

Shkaku: Neglizhencë në mbledhjet e grupit.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 2.1: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ngaj grupeve të menaxhimit strategjik të ngritura, mbi nivelin e realizimit të objektivave të MFK, problematikat e hasura dhe vendimarrjen përkatëse për çdo rast.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 3: Vonesa nga DAB në përgatitjen e raportit përfundimtar për subjektin ATP.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të angazhimit të auditimitë brendshëm, rezulton se në një rast DAB nuk ka marrë masat e nevojshme për dërgimin në kohë të raportit përfundimtar të auditimit ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, duke shkelur afatet e dërgimit të raportit.

Kriteri: Manuali i auditimit të brendshëm në sektori publik miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Vonesa në përgatitjen dhe dërgimin e raportit përfundimtar të auditimit.

Shkaku: Mos planifikimi i saktë i afateve.

Rëndësia: e ulët



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Rekomandimi 3.1: Në të ardhmen Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për mirëplanifikimin e auditimeve që do të realizojë sa i takon përbushjes së afateve të mbylljes dhe dërgimit të raporteve, duke marrë parasysh çdo risk që mund të çënojë shkeljen e këtyre afateve.

Në vijimësi

7. PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT.

Referuar pikës së mësipërme, gjatë auditimit u shqyrtua gjithashtu, zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, si dhe ankesa e mbërritur në KLSH me nr. 327, datë 24.03.2022.

A. Ndjekia e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Auditimi i fundit nga KLSH pranë Ministrisë së Drejtësisë, është kryer referuar Raportit përfundimtar të auditimit dërguar me shkresën nr. 813/9, datë 31.12.2019. Me shkresën nr. 7036/17, datë 24.02.2020, Ministria e Drejtësisë ka dërguar planin e punës për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të lëna, plan i cili referuar nenit 15/j, të Ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, është dërguar jashtë afatit prej 20 ditë nga marrja e shkresës. Po kështu, është dërguar me vonesë edhe informacioni mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, i cili është dërguar me shkresë nr. 1199/2, datë 24.07.2020, një muaj më vonë se përcaktimet e nenit 30 të Ligjit për KLSH. Në vijim, në Ministrinë e Drejtësisë, është ushtruar auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna, me Autorizim të Kryetarit të KLSH nr. 675/15, datë 14.07.2020. Në përfundim të këtij auditimi është dërguar Raporti përfundimtar me shkresë nr. 675/27, datë 06.10.2020, sipas të cilit nga 14 rekomandime gjithsej është ri kërkuar zbatim për 8 prej tyre. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është ri kërkuar zbatim i rekomandimeve të mëposhtme, për të cilat ka rezultuar si vijon:

- **Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi**

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për plotësimin e kuadrit ligjor “Përkthyesin zyrtar”, për të garantuar profesionistë mbi bazën e meritokracisë, shërbime përkthimin sa më cilësore dhe një veprimtari të rregulluar nga akte ligjore të mirë përcaktuara.

Koment: Nga auditimi rezultoi se në kuadër të masave të marra, është arritur miratimi i Ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” dhe gjatë vitit 2022 janë miratuar dhe një sërë aktesh nënligjore në zbatim të tij. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

1.2 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të plotësojë gjithashtu bazën ligjore mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të përkthyesve të jashtëm, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë, si dhe duke treguar vëmendje të veçantë në reduktimin e riskut të mundshëm të rrjedhjes së informacionit të klasifikuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Koment: Nga auditimi rezulton se në kuadrin e ri ligjor të cituar më lart, parashikohet krijimi i regjistrit kombëtar të përkthyesve, miratimi i listave vjetore të përkthyesve zyrtar nga Ministri, ndarja e përkthyesve në përkthyes të pajisur me certifikatë sigurie dhe ata pa certifikatë, në varësi të klasifikimit të materialeve që përkthehen, etj. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

- **Masa organizative**

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të dërgojë një kopje të raportit të auditimit të mbajtur pranë Drejtorisë së Përmbarimit Tiranë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe të kërkoj ndjekjen nga ana e saj të problematikës së degëve nëpërmjet nxjerrjes së shkresave njoftuese lidhur me “Llogarinë përmbarimore”, me theks të veçantë derdhjen në buxhet të të ardhurave përmbarimore si dhe sistemimin e zërit “Të tjera” në këtë llogari.

Koment: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka dërguar raportin përfundimtar të auditimit pranë DPP me njoftimin përkatës nëpërmjet shkresës nr. 5677/8, datë 17.02.2020. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

3.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të përkohshëm, referuar shkresës së IML nr. 1616, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855, datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z. B. Xh. në pozicionin e nëpunësit autorizues.

Koment: Nga auditimi rezulton se në rolin e Nëpunësit autorizues është emëruar Sekretari i Përgjithshëm i MD, z. I. Sh.. Për sa më lart rekomandimi rezulton **i zbatuar**.

- **Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike**

1.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e shërbimeve të marra nga përkthyes të pa regjistruar në organet fiskale, kjo në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit buxhetor, taksat dhe tatimet, si dhe për të shmangur diskriminimin e operatorëve ekonomik kundrejt konkurrencës së pa ndershme.

Koment: Nga auditimi rezulton se për periudhën në vazhdim, Ministria e Drejtësisë ka operuar me shërbimin e përkthimit me përkthyes zyrtar të regjistruar në organet tatimore, ose me përkthyes zyrtar të cilët janë të punësuar pranë subjekteve private dhe ofrojnë fatura të rregullta tatimore elektronike. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

1.2 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë të merren masa për hartimin e një baze rregullatore mbi përkthimin e dokumentacioneve të klasifikuara, me qëllim eliminimin e risqeve të mundshëm gjatë kësaj veprimtarie.

Koment: Nga auditimi rezulton se MD miraton dhe operon me dy kategori përkthyesish zyrtarë, ata të pajisur me certifikatë sigurie dhe ata pa certifikatë sigurie. Po kështu, në bashkëpunim me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

AKSHI, është hartuar “Rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve të subjekteve që kanë të drejtë akses në data bazën qendrore për bashkëpunimin ndër gjyqësor me jashtë”. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

2.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masat e nevojshme për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël, si dhe eliminimin e kostove të pa nevojshme nga buxheti i institucionit për mirëmbajtjen e tyre.

Koment: Nga auditimi rezulton se MD po ndërmer masa për ndryshimin e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, pasi duke marrë parasysh që këto sisteme përmbajnë informacion dhe të dhëna sensitive e konfidenciale, gjykojnë se ato nuk duhet të administrohen nga AKSHI, por nga vetë MD. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pa zbatuar**, pasi deri në miratimin ose jo të ndryshimeve të kërkuara për VKM, kjo e fundit duhet të zbatohet me përpikmëri.

Observacionet e subjektit: Me shkresën nr. 4277/7, datë 01.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 249/11, datë 01.08.2023, janë paraqitur observacione mbi mos zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH dhe konkretisht mbi masat disiplinore si vijon:

Referuar Raportit përfundimtar të Auditimit të mëparshëm të KLSH, grupi i auditimit të asaj kohe ka pasqyruar në raport vetëm shkeljet dhe nuk ka përcaktuar nominalisht nëse ka apo jo nëpunës civil përgjegjës për to. Në këtë raport, i lihet në kompetencë Ministrit të Drejtësisë ngritja e një grupi pune për vlerësime të mëtejshme. Më Urdhrin nr. 72, datë 20.02.2020 të Ministrit të Drejtësisë është ngritur grupi i punës i cili do të trajtonte gjetjet e pasqyruara në raport. Nëpërmjet Memos nr. 1199/1, datë 27.04.2020, grupi i punës ka dalë në përfundimin se është i pamundur identifikimi në mënyrë nominale i përgjegjësve për shkeljet e konstatuara me argumentimin se në gjykimin e tyre mban përgjegjësi e gjithë struktura për veprimtarinë funksionale. Në memo janë identifikuar të gjitha strukturat përgjegjëse për konstatimet, si dhe janë propozuar rishikime të rregullave të punës me qëllim shmangien e shkeljeve në të ardhmen. Memo e mësipërme është miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili me Urdhërat përkatës ka caktuar detyra shtesë dhe prioritetet për çdo strukturë përgjegjëse.

Qendrimi i grupit të auditimit: Nisur nga fakti se në raportin e auditimit të kaluar nuk evidentohen përgjegjësi dhe vlerësimi i shkeljeve për dhënien e masave disiplinore është lënë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë, si dhe duke marrë parasysh se rekomandimi për ngritjen e grupit të punës dhe dhënien e një gjykimi mbi shkeljet është përmbushur, observacioni merret në konsideratë.

B. Ankesë e mbërritur në KLSH

Me ankesën administruar në KLSH me nr. 327, datë 24.03.2022, parashtrohet problematika lidhur me emërimin e z. Z. Z. në pozicionin e Drejtuesit të Arkivit Shtetëror të Sistemit gjyqësor (institucion në varësi të MD). Referuar pretendimeve të ankimesit, z.Z. ka qenë specialist pranë këtij institucioni deri në momentin e ngritjes në detyrë nga DAP me Vendimin nr. 2752, datë 27.04.2021, në pozicionin e titullarit, i cili është bërë në shkelje me kuadrin ligjor pasi sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ankimuesit z. Z. nuk plotëson kriterin e arsimit. Pas verifikimeve, në këtë konkluzion ka rezultuar edhe vetë DAP, i cili me Vendimin nr. 5293/7, datë 18.02.2022, ka shfuqizuar vendimin për ngritjen në detyrë të z. Z. dhe ka vendosur shkarkimin e tij nga ky pozicion. Për sa më lart, ankimuesi pretendon mos ekzekutimin e këtij vendimi nga Ministria e Drejtësisë. Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se me shkresën nr. 132/1, datë 02.02.2022, Ministria e Drejtësisë, ka propozuar pranë DAP sistemimin e z. Z. në pozicionin e specialistit pranë Sektorit të Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun. Nga auditimi rezulton se për rastin në fjalë, z. Z. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në të cilën ka ngritur padi ndaj Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe ndaj Departamentit të Administratës Publike. Në këtë proces, Ministria e Drejtësisë është vetëm në rolin e personit të tretë. Me Vendim nr. 3190, datë 30.11.2022 të kësaj Gjykate, është kërkuar shfuqizimi i vendimit të DAP për shkarkimin e z. Z. dhe kthimin e tij në pozicionin e Drejtuesit të Arkivit Shtetëror të Sistemit gjyqësor. Kundër vendimit të mësipërm, DAP ka bërë ankimim me shkresën nr. 1403/1, datë 17.03.2023 pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe deri në momentin e auditimit nuk ka ende një vendim të kësaj të fundit.

Për sa trajtuar më lart, grupi i auditimit vëren:

- Nuk rezulton që MD të mos ketë marrë asnjë masë për ekzekutimin e vendimit të DAP mbi shkarkimin e z. Z., pasi siç cituar më lart është propozuar sistemimi i tij në një pozicion specialisti;
- Padia e z. Z. mbi vendimin e shkarkimit është ngritur ndaj Departamentit të Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë është vetëm palë e tretë;
- Për rastin në fjalë duhet të pritet vetëm Vendimi i formës së prerë të Gjykatës së Apelit.

Për sa më lart është mbajtur akt verifikimi me I. Sh. dhe E. M..

Konkluzion: Nga auditimi i ndjekies së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezulton se në Ministrinë e Drejtësisë, është ushtruar auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna, me Autorizim të Kryetarit të KLSH nr. 675/15, datë 14.07.2020. Në përfundim të këtij auditimi është dërguar Raporti përfundimtar me shkresë nr. 675/27, datë 06.10.2020, sipas të cilit nga 14 rekomandime gjithsej është ri kërkuar zbatimi për 8 prej tyre. Nga auditimi i kryer nga ana jonë rezultoi se nga këto 8 rekomandime të ri kërkuara, janë zbatuar 7 prej tyre dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim si vijon:

- **Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike**

1.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masat e nevojshme për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël, si dhe eliminimin e kostove të pa nevojshme nga buxheti i institucionit për mirëmbajtjen e tyre.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Për sa më lart ri kërkojmë nga titullari i MD marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

III. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi rezulton se në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të MD janë listuar në mënyrë të përgjithshme detyrat e Drejtuesve dhe specialistëve dhe më tej vetëm përshkrimet e Drejtorive, por pa detajime të përshkrimeve konkrete të punës të përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve, sipas drejtorive ku bëjnë pjesë dhe sipas detyrimeve dhe angazhimeve të veprimtarisë së tyre ditore, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e DAP, nr. 01, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil” dhe nenin 9 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marra masa për ngritjen e grupit të punës përkatës për përmirësimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit, duke e plotësuar atë me rregulla dhe përshkrime të hollësishme mbi detyrat, përgjegjësitë dhe rolet në administrimin e veprimtarisë së përditshme për përgjegjësit e sektorëve dhe specialistëve.

Brenda 31.12.2023

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar konstatohet se, referuar llogarisë përkatëse në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime nga buxheti i aparatit për vendime gjyqësore, në një vlerë prej **45,613,569** lekë të cilat përfshijnë paga, kontribute dhe tarifa përmbarimi dhe konkretisht për vitin 2020, në total 22,982,329 lekë nga të cilat 971,665 janë tarifa përmbarimi; për vitin 2021 në total 1,869,390 lekë nga të cilat 52,446 lekë tarifa përmbarimi dhe për vitin 2022, në total 20,761,850 lekë nga të cilat 78,000 lekë tarifa përmbarimi. Nga auditimi rezulton se deri në vitin 2019, sektori i financës ka operuar me pagesat ndaj gjyq fituesve vetëm në pagën neto, duke mos derdhur kontribute për sigurime për gjyq fituesit pothuajse që në vitin 2011. Pas konstatimit të këtij fakti, sektori i financës ka kryer përlllogaritjen dhe ka filluar kryerjen e pagesave për kontributet e pa shlyera ndaj këtyre gjyq fituesve, ku pjesa më e madhe e pagesave janë kryer në vitin 2020 dhe konkretisht rreth 3,731,037 lekë. Për sa më lart, krahas pagesave të 11 gjyq fituesve për periudhën objekt auditimi, mos kryerja e pagesave të plota në vlerën bruto për periudhat e mëparshme, ka bërë që kosto e këtyre pagesave të rëndojë buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën objekt auditimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe Vendimet gjyqësore përkatëse.

2.1 Rekomandimi: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse disiplinore të marrin masa që në të ardhmen vendimet për shkarkimet nga puna të jenë të argumentuara saktë, në mënyrë të dokumentuar dhe të justifikuar, si dhe të garantohet ndjekjen e të gjitha hapave të nevojshme të njoftimit apo vlerësimit të arësyes së largimit, në mënyrë që të shmangen efektet financiare negative në buxhet.

Në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Titullari i MD dhe Komisionet përkatëse, të marrin masa për vlerësimin dhe sistemimin e gjyq fituesve në listë pritje, në pozicionet vakante të cilat MD i ka në një nivel të lartë aktualisht, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, duke qenë se kjo mundësi parashikohet nga aktet ligjore përkatëse mbi shërbimin civil.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetje nga auditimi 3: Për periudhën objekt auditimi, një peshë të konsiderueshme në zërin “Shpenzime operative” e zë “Shërbimi i përkthimeve zyrtare”, për të cilin rezulton se MD ka shpenzuar në total për të tre vitet vlerën prej 104,267,661 lekë dhe përkatësisht 43% të shpenzimeve operative të vitit 2020, 21% të shpenzimeve të vitit 2021 dhe 46% të shpenzimeve të vitit 2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura për marrjen në dorëzim të përkthimeve të kryera, vihet re se në të gjitha rastet, MD shprehet se materialet i jepen përkthyesve zyrtarë të jashtëm për shkak të pamundësisë aktuale të realizimit të përkthimit nga Sektori i Përkthimit Zyrtar, ose për shkak të materialit voluminoz në fjalë. Nga auditimi rezulton se ky arsytim përdoret edhe në rastet e përkthimit të materialeve me përmbajtje nga 1 deri në 3 faqe, për të cilat jepet një afat kohor deri në 7 ditë, periudhë e cila është e mjaftueshme për tu përballuar nga Sektori i Përkthimit Zyrtar në MD, sektor i cili përbëhet nga 1 përgjegjës dhe 5 specialistë. Gjithashtu konstatohet se brenda një viti nuk bëhet një shpërndarje e drejtë mes përkthyesve zyrtarë të autorizuar. Nga sa më lart, rezulton se për shërbimin e përkthimeve, MD nuk operon sipas një rregulloreje apo udhëzimi të brendshëm të miratuar, sipas të cilit të bëhen transparente mënyra e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve, mënyra e dokumentimit të ngarkesave në punë të sektorit të përkthimeve pranë MD, për shkak të të cilës ky sektor e ka të pamundur të realizojë qoftë edhe përkthimet prej 1 apo 2 faqesh, etj. Me Urdhër nr. 162, datë 09.06.2020 të Ministrit të MD, është miratuar lista e përkthyesve të autorizuar për përkthimin zyrtar për vitin 2020 dhe me Urdhër nr. 421, datë 15.12.2020 është miratuar kjo listë për vitin 2021. Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 nuk është miratuar kjo listë, duke bërë që të vijohet automatikisht me përkthyesit e vitit të mëparshëm. Veprimet e mësipërme bien ndesh me Udhëzimin nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar.

3.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për përkthimet zyrtare të marrë masa për plotësimin e mëtejshëm të Udhëzimit nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, ose për hartimin e një rregullore të funksionimit të këtij shërbimi, duke pasqyruar qartë dhe në mënyrë transparente mënyrën e shpërndarjes së përkthimeve, normat e lejueshme dhe afatet përkatëse të përkthimit në varësi të numrit të faqeve., si dhe të vijojë me miratimin e listës së përkthyesve zyrtar deri në momentin e vënies në funksion të plotë të regjistrit kombëtar të përkthyesve.

Menjëherë

3.2 Rekomandimi: Duke marrë shkak nga volumi tepër i lartë i përkthimeve zyrtare në MD, si dhe vlera tepër e lartë e fondeve që zë në buxhet ky shërbim, sektori përkatës për përkthimet zyrtare dhe titullari i MD të marrin masa për studimin dhe analizimin nga pikëpamja financiare, të mundësisë së shtimit, sipas nevojës, të numrit të punonjësve në strukturën e Sektorit të Përkthimeve, në mënyrë që të shmangen sa më tepër të jetë e mundur shpenzimet e larta për këtë shërbim, por edhe risqet e shpërndarjes së materialeve konfidenciale jashtë institucionit.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetje nga auditimi 4: Nga auditimi i veprimeve me bankën rezultoi se, në tërësi, sa i takon procedurave të blerjeve nëpërmjet prokurimit me vlerë nën 100.000 lekë, grupet e marrjes në dorëzim të shërbimit apo mallit hartojnë procesverbale formale për marrjen në dorëzim, në të cilat deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika. Në shumë raste, kryesisht për procedurat e blerjeve të dekoreve apo dhuratave për pritje përcjellje, rezulton se nuk hartohen as specifikime të natyrës së dekorit, apo dizenjove të dhuratave të kërkuara, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre, veprime në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për prokurimet dhe komisionet e prokurimeve të blerjeve me vlerë të vogël, të marrin masa për garantimin e një procesi sa më transparent të prokurimit të fondeve publike, duke hartuar specifikime konkrete dhe të matshme për objektet që prokurojnë dhe në këtë mënyrë edhe procesi i marrjes në dorëzim të ketë një bazë krahasimi dhe të dokumentohet me detaje se objekti i prokuruar që po pranohet, përputhet me nevojat e AK.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 5: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në mënyrë të përsëritur në vitin 2022, për likuidimin e dietave për shërbimet e kryera brenda vendit, personat udhëtues kanë paraqitur foto të printuar të faturave tatimore, të cilat referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të jenë origjinale dhe gjithashtu në këtë format nuk është i mundur as skanimi i kodit të fiskalizimit, për garantimin e rregullshmërisë së faturës tatimore, veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor tatimor dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në MD të marrë masa për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin dhe të mbaje parasysh që dokumenti financiar të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, si dhe të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Në këtë kuadër, Sektori i Financës të marrë masa për mos likuidimin e faturave tatimore jo origjinale për të cilat nuk mund të verifikohen elementët e rregullshmërisë.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 6: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, mungonin akt-rakordimet për tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, të cilat në përputhje me pikën 50, të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, “duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

6.1 Rekomandimi: Nga ana e MD të merren masa që pasqyrat financiare të shoqërohen me akt-rakordimet për tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

mjete në ruajtje”, në përputhje me Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, duke plotësuar elementet e gjurmës së auditimit mbi zërat e posteve të bilancit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 7: Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Ministria e Drejtësisë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, ka evidentuar detyrime të krijuara nga viti 1996 – 2012, të cilat referuar nenit 203, të Kodit të Punës ose Kreut IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 - vjeçar. Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022 Ministria e Drejtësisë mbart në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, detyrime të cilat referuar Kreut IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 – vjeçar. Nga auditimi rezultoi se Ministria e Drejtësisë mbart në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, detyrime të pagueshme të cilat datojnë që nga viti 2000 dhe një pjesë prej tyre, në përputhje me Kreun IV “Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave” të Kodit Civil, rezultojnë të kenë tejkaluar afatin 10 – vjeçar.

Veprimet e mësipërme bien ndesh me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

7.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të ri-verifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 8: a) Nga auditimi rezultoi se regjistrimi i zërave të aktiveve në Ministrinë e Drejtësisë është kryer me çmimin e blerjes, dhe periudha e hyrjes së tyre i përket viteve shumë më parë. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për kryerjen e rivlersimit të aseteve me qëllim sjelljen e tyre në vlerën e drejtë në kontabilitet.

b) Nga auditimi rezultoi se MD disponon certifikatë pronësie vetëm për Godinën e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa për godinën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe godinën e Kolegji të Posaçëm të Apelit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të MD-së në zbatim të VKM, nr. 518, datë 20.9.2017 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Ligji nr. 84/2016”, i ndryshuar me VKM-në nr. 767, datë 20.12.2017 dhe VKM-në nr. 230, datë 26.04.2018, kanë filluar procedurat për hartimin e planit të rilevimit dhe planimetricave të zyrave, por aktualisht nuk disponohet certifikata e pronësisë.

c) Nga auditimi rezultoi se për periudhën e auditimit MD në llogaritjen e amortizimit për kategorinë e aktiveve “Inventar ekonomik” ka operuar me metodën e amortizimit mbi vlerën e mbetur, në kundërshtim me paragrafin nr. 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

8.1 Rekomandimi: Nga ana e institucionit të merren masa për kryerjen e procesit të rivlersimit të asetëve, me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

8.2 Rekomandimi: Nga ana e institucionit, të merren masa për përmbylljen e procedurave dhe pajisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, me qëllim formalizimin e marrëdhënies së MD dhe objekteve në pronësi dhe rrjedhimisht pasqyrimin e vlerave përkatëse të trojeve në funksion tyre në llogarinë 210.

8.3 Rekomandimi: Nga ana e institucionit, për kategoritë e aktiveve a) kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (software) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave për aktivet e kategorisë, të procedohet me përlllogaritjen e amortizimit në mënyrë individuale sipas paragrafit nr. 36 të Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 9: Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 3,415,035 lekë për vitin 2020; në vlerën 1,323,782 lekë për vitin 2021 përfaqëson diferencën absolute mes totalit të operacioneve të të ardhurave me totalin e operacioneve të shpenzimeve. Për këtë llogari nuk janë dhënë sqarime në shënimet shpjeguese.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e institucionit të merren masa për plotësimin e relacioneve shoqëruese të pasqyrave financiare dhe dhënin e sqarimeve për Llogarinë 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni".

Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 10: Për vitin 2020 dhe 2021 në procedurat e kryera nëpërmjet “sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar” u konstatua se nga momenti i dërgimit të ftesës nga organizatorët për pjesëmarrje në event/takim jashtë vendit dhe deri në momentin e miratimit të pjesëmarrësve si staf shoqërues i ministrit (përfshirë dhe procedurën e miratimit nga Kryeministri për dalje jashtë vendit të ministrit) me qëllim fillimin e procedurave të prokurimit, konstatohen vonesa në përgatitjen e akteve administrative nga Drejtoria e Kabinetit. Kjo ka bërë që procedurat e tenderimit të fillojnë afërsisht 2-3 ditë para datës së zhvillimit të eventit/takimit, duke sjellë si pasojë blerje të biletave me kosto më të lartë, pasi menaxhimi për hartimin e akteve administrative të sipërme është jo efektiv nga Drejtoria e Kabinetit dhe jo referuar kërkesave të Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1.

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MD në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në evente jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin si dhe konfirmimit nga Kryeministri në ato raste kur kërkohet për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në fillimin e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.

Rast pas rasti



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetje nga auditimi 11: Në Ftesën për ofertë në tenderin “Blerje bileta avioni Tiranë- New York–Tiranë”, AK ka vendosur si kriter “operatori ekonomik të ketë 10 vite eksperiencë në treg, me certifikatën IATA”, kriter i cili nuk trajton në mënyrë të barabartë pjesëmarrësit pasi në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 i ndryshuar, pika 1, përcaktohet qartë se “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale.Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Gjithashtu dhe në Udhëzimin e APP nr.4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar pika 6, germa “b” përcaktohet se: “Në raste specifike Komisioni i sistemit dinamik i biletave, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, mund të kërkojë plotësimin e një ose disa kriterëve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin provues si p.sh. Certifikatë akreditimi ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association”. Komisioni me Memo datë 27.05.2021 (nr. 2796/2 Prot) drejtuar ish Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK ka bërë oponentë mbi vendosjen e kriterit të sipërm trajtuar në kërkesën nr.2796/1 Prot, datë 27.05.2021 të Sektorit të Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse për miratimin e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi. Oponenca nuk është marrë në konsideratë nga ish Sekretari i Përgjithshëm i cili në memo ka bërë shënimin “*Të vendosen të gjithë kërkesat që janë paraqitur në memon e dt 26.05.2021*”. Veprimi nuk është në përputhje me Ligjin nr.162/2020 i ndryshuar, neni 77, pika 1 dhe Udhëzimin e APP nr.4, datë 09.01.2018 i ndryshuar pika 6, germa “b”. AK në vendosjen e kriterëve ka ndjekur standarde dyfishe pasi Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në raste të tjera nuk ka përcaktuar këtë kriter për operatorët.

11.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor /MD që në hartimin e dokumenteve të tenderit/vendosja e kriterëve të veçanta të jetë në përputhje me objektin e prokurimit në çdo rast, me qëllim shmangien e pabarazisë në tendera.

Rast pas rasti

Gjetje nga auditimi 12: Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin “*Hartim projekti për ndërtimin e Institucionit për Edukimi dhe Rehabilitim i të Miturve në Mëzes, Tiranë*” zhvilluar më datë 16.12.2020, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjestim me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë me ofertë më të mirë bazuar në Çmim dhe Propozim teknik. Kriteret e Vlerësimit teknik me vlerësim me Pikë (i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10], (ii) Metodologjia e Propozuar [20-30], (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-60]. Ndërkohë, sipas kriterëve kualifikuese të veçanta të Kapacitetit teknik, kërkohet që Operatori ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht stafin kryesor: Drejtues Projekti me Eksperiencë Pune *mbi 15 vite*. Drejtuesi i Projektit pranohet të jetë edhe njeri nga, Projektues Arkitekt ose Projektues Konstruktor. Projektues Arkitekt (2 persona), ekspertë me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Konstruktor (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Mekanik (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Elektrik (2 persona), ekspertë me përvojë pune *mbi 10 vite*. Projektues Gjeodet (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 10 vite*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Inxhinier Gjeolog (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 5 vite*. Inxhinier Hidroteknik (1 person), ekspert me përvojë pune *mbi 5 vite*. Kërkesa e mësipërme referuar Vendimeve të KPP-së dhe nenit 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, ku gjykohet qartë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve*. Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të Arkitektëve dhe Inxhinierëve, trajton në mënyrë të pabarabartë ose diskriminues Arkitektët dhe Inxhinierët që nuk kanë eksperiencën mbi 10 vite. Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë. Gjithashtu referuar edhe vlerësimit me pikë mbi eksperiencat e stafit, punët e ngjashme etj, kërkesa e mësipërme nuk stimulon dhe nxit pjesëmarrjen e OE.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vlerësimi duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 13: Nga të dhënat konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi struktura e MD ka qenë e pa plotësuar dhe konkretisht në shkurt 2020 me 26 punonjës më pak, në tetor 2020 me 28 punonjës më pak, në mars 2021 me 18 punonjës më pak, në shtator 2021 me 22 punonjës më pak, në prill 2022 me 41 punonjës më pak dhe në nëntor 2022 me 37 punonjës më pak, duke funksionuar me një përqindje të lartë të vendeve vakante, veçanërisht përgjatë vitit 2022 ku vihet re se ka mangësi në rreth 23% të strukturës. Pavarësisht vendeve të lira/vakante dhe strukturës së miratuar, janë kontraktuar punonjës me kontrate të përkohshme pune. Në varësi të nevojave për rekrutim në shërbimin civil u konstatua se, MD ka dërguar shkresat përkatëse pranë DAP, konkretisht me shkresë nr. 8365/1, datë 24.12.2019 për vitin 2020 me 26 punonjës, me shkresë nr. 7528/1, datë 18.12.2020 për vitin 2021 me 7 punonjës dhe me shkresë nr. 6598, datë 21.12.2021 për vitin 2022 me 56 punonjës. Nga auditimi rezulton se nevojat për rekrutim janë dërguar në shkelje të afateve të parashikuara.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë dhe sektori përkatës i burimeve njerëzore të marrin masa për planifikimin e saktë dhe dërgimin në kohë të nevojave për rekrutime pranë Departamentit të Administratës Publike, si dhe të mbajë me këtë të fundit një bashkëpunim më koherent sa i takon plotësimin të vendeve vakante.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetje nga auditimi 14: Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se janë ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik për secilin vit, ato nuk kanë funksionuar rregullisht pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e MFK, nuk rezultojn të ketë proceverbale të mbledhjeve të këtyre grupeve, si dhe vendime rast pas rasti, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

14.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Drejtësisë të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ngaj grupeve të menaxhimit strategjik të ngritura, duke kërkuar vazhdimisht raportime nga mbledhjet e tyre, mbi nivelin e realizimit të objektivave të MFK, problematikat e hasura dhe vendimmarrjen përkatëse për çdo rast.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 15: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të angazhimit të auditimit të brendshëm, rezultojn se në një rast DAB nuk ka marrë masat e nevojshme për dërgimin në kohë të raportit përfundimtar të auditimit ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, duke shkelur afatet e dërgimit të raportit, në kundërshtim me Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave.

15.1 Rekomandimi: Në të ardhmen Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për mirë planifikimin e auditimeve që do të realizojë sa i takon përmbushjes së afateve të mbylljes dhe dërgimit të raporteve, duke marrë parasysh çdo risk që mund të cenojë shkeljen e këtyre afateve.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 16: Nga auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezultojn se në Ministrinë e Drejtësisë, është ushtruar auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna, me Autorizim të Kryetarit të KLSH nr. 675/15, datë 14.07.2020. Në përfundim të këtij auditimi është dërguar Raporti përfundimtar me shkresë nr. 675/27, datë 06.10.2020, sipas të cilit nga 14 rekomandime gjithsej është ri kërkuar zbatimi për 8 prej tyre. Nga auditimi i kryer nga ana jonë rezultoi se nga këto 8 rekomandime të ri kërkuara, janë zbatuar 7 prej tyre dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim.

16.1 Rekomandimi: Për sa trajtuar më lart ri kërkojmë nga titullari i MD zbatimin e rekomandimit të pa zbatuar nga auditimi i mëparshëm si vijon:

Institucioni të marrë masat e nevojshme për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël, si dhe eliminimin e kostove të pa nevojshme nga buxheti i institucionit për mirëmbajtjen e tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje nga auditimi 1: Nga verifikimi i strukturës së preventivit, pagesës në situacionin përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren u konstatua pasaktësi në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i godinës së MD” si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

1. Me kërkesën për propozim të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit Pa Prot., datë 07.12.2020, paraqitet analizë teknike e zërit të paparashikuar në preventiv me nr. Analize 2.334 “*Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m*”. Çmimi i këtij zëri është paraqitur sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Me procesverbalin e negocimit të zërit të ri datë 10.12.2020, mbas konsultimeve të realizuara nga palët u miratua çmimi prej 645 lekë /m² për zërin “*Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m*”. Me procesverbalin e palëve të datës 14.12.2020, gjatë verifikimeve në objekt u pa e nevojshme kryerja e disa ndryshimeve të volumeve të zërave të punimeve të paparashikuara në preventivin fillestar. Referuar situacionit përfundimtar në kapitullin e suvatime dhe veshje, konstatohet se fasada e jashtme prej 1,091 m², ka kryer 2 procese pune: a. “*Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m*”, me çmim 645 lekë /m², b. “*Suvatim me grafiato h > 4m*”, me çmim 750 lekë /m². Nga verifikimi i fasadës konstatohet se është realizuar vetëm zëri i “*Suvatim me grafiato*”, ku lartësia në fakt është mbi 8m. Nga verifikimi në disa pjesë të objektit, konstatohet se është realizuar vetëm mbushja me kollë, rrjeta dhe grafiato e gatshme. Pra nuk u konstatuan procese të suvatimit të jashtëm si kryerja e fashaturave, mbushja dhe realizimi me rerë të larë (ose Fino). Referuar situacionit përfundimtar dhe analizës së çmimit për suvatimin e jashtëm mbi 8 m, në kapitullin e punimeve të skelerisë dhe kallëpi, konstatohet se zëri nr. 2 me nr. Analize 2.431 “*Skelë metalike me tubo fasade >12 m*” në sasinë prej 1,608 m², me çmimin përkatës prej 90 lekë/m² është zë pune i mbivendosur zërit nr. 2.334 “*Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8m*”, pasi përfshihet në strukturën e çmimit. Rrjedhimit vlera prej 144,720 lekë, e likuiduar në zërin “*Skelë metalike me tubo fasade >12 m*”, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Në kapitullin e punime shtresash, zëri nr. 9, me nr. Analize 2.276 “*Shtresë parketi*”. Sasia për “shtresë parketi” është paguar në situacion në sasinë 29.8 m², me çmimin prej 6,550 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 29.8 m², në ambientet e katit dytë zyra 8 dhe zyra 9. Nga verifikimi në këto ambiente konstatohet se këto sipërfaqe nuk janë realizuar me shtresë parketi por me shtresë parketi laminat, me çmimin përkatës prej 1,650 lekë/m². Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar diferencë çmimi prej 4,900 lekë/m² (6,550 lekë/m² - 1,650 lekë/m²). Vlera e diferencës e përfituar më tepër rezulton 4,900 lekë/m² x sasinë 29.8 m² = 146,020 lekë.

3. Kapitulli i punimeve tavani, suvatimi dhe veshje, zëri nr. 1, me nr. Analize 2.3 “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*”. Sasia për “Suvatimit të tavanit” është paguar në situacion në sasinë 645 m², me çmimin prej 650 lekë/m². Në librezën e masave sasia është pasqyruar 645 m², në nga ambientet e katit I deri të katit XI. Nga verifikimi në disa ambiente të MD zyra dhe shesh pushime, konstatohet se nuk janë realizuar suvatime të tavanit, por vetëm tavane të varur me pllaka gipsi 60x60 dhe tavane kartonxhes. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin e punimit “*Suva solete h-4 m me drejtues, me krah*” në vlerën 416,250 lekë.

Si përfundim, për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 706,990 lekë pa TVSH (416,250 + 146,020 + 144,720) ose **848,388 lekë me TVSH**, e përfituar nga sipërmarrësi “I.” shpk, për zëra të porealizuar.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të njësisë publike (Ministrisë së Drejtësisë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“MINISTRINË E DREJTËSISË”

kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësive, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 848,388 lekë.

Brenda 31.12.2023

IV. ANEKSE

Aneksi 1: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”

Nr	Pershkrimi	Çelja 01.01.2021				Teprica me 31.12.2021	
		Fatura/dok.fin.	Date	llog.231	llog.602-605	llog.230-231	llog.602-605
	Detyrime Para vitit 2000						
1	Reparti ushtarak				3,511	-	3,511
2	Shtypshkronja T.				150,089	-	150,089
3	D. F.Tirana				7,030	-	7,030
4	Firma A.				7,200	-	7,200
5	Firma E.				23,500	-	23,500
6	B. K.				29,760	-	29,760
7	Ministria e Rendit				2,208	-	2,208
8	Axhensia Kombetare				3,200	-	3,200
9	Oficina A.				3,565	-	3,565
10	Reparti ushtarak				1,424	-	1,424
11	Reparti ushtarak nr.5011				9,714	-	9,714
12	O.				45,000	-	45,000
13	Petrol Impeks				15,192	-	15,192
14	L. Q.				8,000	-	8,000
15	Tipografia Ushtarake				49,800	-	49,800
16	M. Sh.p.k				98,400	-	98,400
	Detyrime te viteve 2009-2010					-	-
1	Gazeta P.	Fat.711	30.06.2010		16,500	-	16,500
2	Gazeta P.	Fat.897	23.08.2010		46,000	-	46,000
3	Gazeta S.	Fat.728	25.06.2010		12,000	-	12,000
4	Gazeta S.	Fat.793	16.08.2010		50,000	-	50,000
5	Gazeta K	Fat.150	30.06.2010		17,010	-	17,010
6	Gazeta Sh.	Fat.277	29.06.2010		12,000	-	12,000
7	Gazeta M.	Fat.1307	20.06.2010		15,000	-	15,000
	Detyrime te viteve 2011-2012					-	-
	I Sh.p.k				33,558	-	33,558
	P.				128,844	-	128,844
	Detyrime te vitit 2017					-	-
1	R.	Fature nr.31 - Detyrim pjesor	21.03.2017	68,472,000	3,480,000	68,472,000	3,480,000
2	S.	Fature nr.224	06.06.2017	28,800,000		28,800,000	-
	TOTAL			97,272,000	4,268,505	97,272,000	4,268,505

Aneks 2: **Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “MINISTRINË E DREJTËSISË”

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- *Aktivet ekzistojnë fizikisht;*
- *ato i përkasin subjektit;*
- *janë të vlerësuara në mënyrë korrekte;*
- *janë regjistruar në mënyrë korrekte;*
- *është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;*
- *informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- *U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;*
- *U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;*
- *U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;*
- *U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.*
- *U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;*
- *U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.*

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- *Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);*
- *Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.*
- *Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;*
- *Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.*

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- *Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;*
- *Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);*
- *Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“MINISTRINË E DREJTËSISË”

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT